



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 422 Akti

Nr. 547 Vendimi
Tiranë, më 6.7.2022

V E N D I M

Trupi gjykses i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Olsi Komici	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqsore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 4.7.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Çlirim Sino**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Çlirim Sino, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 4.7.2022 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur, në datën 16.12.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo), më tej të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:

a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;

b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;

c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

5. Gjatë hetimit administrativ dhe, konkretisht, në datën 10.5.2022, Komisioni, me vendimin nr. ***, datë 10.5.2022, mori vendimin “Për rishpërndarjen me short të çështjeve të komisioneres Alma Faskaj me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të caktuar me procedurat e shortit të muajit dhjetor 2019”, duke vendosur rishpërndarjen me short të të gjitha çështjeve ku komisionere Alma Faskaj ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues dhe pas procedurës së shortit rezultoi se anëtari zëvendësues për këtë çështje u vendos komisioner Olsi Komici, i cili gjithashtu deklaroi edhe mospasjen e konfliktit të interesit. Me anë të postës elektronike në datën 12.5.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua për zëvendësimin e anëtarit të

trupës, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konflikti të interesit me anëtarin e ri ose me dy anëtarët e tjerë. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 16.5.2022, konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.

Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit të rivlerësimi Çlirim Sino, me vendimin nr. 2, datë 8.6.2022, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

6. Komisioni, në datën 8.6.2022, e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 23.6.2022.

7. Subjekti i rivlerësimit, për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik dhe në formë elektronike, kishte autorizuar av. A. S. të pajisur me prokurë të posaçme, e cila u paraqiti në ambientet e Komisionit në datën 16.6.2022. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë paraqiti shpjegimet e tij dhe provat bashkëlidhur mbi rezultatet e hetimit kryesisht në datën 23.6.2022.

8. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 29.6.2022, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 4.7.2022 duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.7.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të tij të përzgjedhur me prokurë.

10. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, subjekti Çlirim Sino parashtroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 4.7.2022 u mbyll për të rifilluar më 6.7.2022 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat

shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet dhe dokumentacionin e paraqitur në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament banimi dhe bodrum në lagjen “**”, Fier**

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 pasuritë e llojit apartament dhe garazh të ndodhura në lagjen “****”, Fier, të përfituara me anë të kontratës së sipërmarrjes nr.***, datë 13.11.2008. Ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pronësinë e një apartamenti me sip. 126.4 m², me vlerë 7.200.000 lekë¹ dhe një bodrum me sip. 18.2 m², me vlerë 750.000 lekë, të përfituara me anë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 10.6.2011. Për të provuar burimin e krijimit të pasurive ai ka vënë në dispozicion kontratën e dhurimit të sipërpërmendur, me palë dhuruese prindërit e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar ka rezultuar se këto pasuri ishin përfituar më herët prej prindërve të subjektit nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes dhe më pas asaj të shkëmbimit të pasurisë së llojit truall në pronësi të babait, mbi të cilën shoqëria sipërmarrëse “****” sh.p.k. ka ndërtuar një objekt shumëkatësh.
2. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të shkëmbimit, Komisionit i ka rezultuar një mospërputhje e apartamenteve, të cilët do të përfitoheshin në të ardhmen nga prindërit e subjektit të rivlerësimit. Me qëllim qartësimin e kësaj situatë, Komisioni iu drejtua

¹Referuar raportit të vlerësimit datë 29.6.2011, vlera e apartamentit është 7.200.000 lekë.

subjektit me pyetësorin nr. 3, në përgjigje të të cilit, ndër të tjera², ka bërë me dije se apartamenti i katit të gjashtë i është dhënë nga prindërit e tij shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. për t’u shitur për llogari të tyre, nëpërmjet nënshkrimit të prokurës së posaçme nr. ***, datë 15.3.2010, kundrejt shumës totale 46.800 euro, nga të cilat i ishin dorëzuar fillimisht 20.000 euro babait të tij dhe se shoqëria e ndërtimit iu detyrohej edhe vlerën prej 26.800 euro, e cila do të shlyhej kur të realizohej shitja përfundimtare e kësaj pasurie.

3. Nëpërmjet një deklarate noteriale³ të datës 7.2.2011, shtetasit K. S. dhe P. N.⁴ kanë deklaruar se në datën e nënshkrimit të deklaratës, z. P. N. i ka dorëzuar babait të subjektit shumën prej 20.000 euro dhe se shuma tjetër prej 20.000 euro ia kishte dorëzuar më herët më 15.3.2010 dhe se diferenca e mbetur pa shlyer do të paguhej kur pasuria të pajisej me certifikatë pronësie. Më pas, në datën 11.2.2011, shtetasit K. dhe z. Çlirim Sino kanë nënshkruar një kontratë dhurimi⁵ të shumës 20.000 euro, shumë e cila i ishte dhuruar subjektit në datën 7.2.2011.
4. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2011, rezulton se shuma prej 20.000 euro është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si dhurim, në rubrikën përkatëse. Nisur nga burimi i krijimit të kësaj shume nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor me anë të të cilit është kryer shitja e apartamentit të ndodhur në katin e gjashtë, si dhe mënyra e kryerjes së pagesave prej 20.000 euro/secila. Subjekti, së bashku me përgjigjet e pyetësorit, ka depozituar një deklaratë noteriale⁶ të datës 5.10.2021, të nënshkruar nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe z. K. S. në të cilën kanë deklaruar se: *“Gjatë ndërtimit të pallatit deri në kontratën e shkëmbimit të vitit 2011, ramë dakord që apartamenti me sipërfaqe 104 m² do t’u shitej palëve të treta dhe Kujtim Sino mori paradhënie 46.800 euro. Gjithashtu, djali i pronarit të truallit do të merrte të njëjtën sipërfaqe banimi, por në katin e ***-të. Meqenëse pala pronare e truallit kërkonte një sipërfaqe dyqani më të madhe nga ajo e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, si dhe punimet ekstra kërkonin shpenzime më të larta nga ato të zakonshme, u ra dakord që pala pronare e truallit të hiqte dorë nga apartamenti në katin e 7-të dhe të përfitonte 10 m² më tepër dyqan. Marrëveshja e mësipërme u materializua në kontratën e shkëmbimit”*.
5. Për të provuar shitblerjen e pasurisë së sipërcituar apartament në katin e 6-të, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes të datës 18.11.2011 të lidhur mes palës shitëse “****” sh.p.k. dhe palës blerëse V., L. dhe E. Dh., kundrejt çmimit total 6.000.000 lekë, pasuri e cila rezulton të jetë e regjistruar edhe në ZVRPP-në Fier⁷. Nisur nga fakti se kjo pasuri është regjistruar pranë ZVRPP-së, si rrjedhojë edhe pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga shitja e apartamentit në fjalë është kryer nga ana e shoqërisë/palës shitëse në momentin e shitjes së kësaj pasurie duke mos ndikuar kështu në ligjshmërinë në origjinë të burimit të shumës së dhuruar prej 20.000 euro subjektit të rivlerësimit.
6. Nga dokumentacioni i administruar lidhur me pasuritë në pronësi të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se nga ASHK-ja Fier⁸, me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2020, është konfirmuar se

²Në përgjigjet e tij, subjekti është shprehur se apartamentin në katin e 3-të e kanë marrë prindërit; apartamenti i katit të 6-të, i është dhënë shoqërisë për t’u shitur për llogari të tyre, me anë të prokurës së posaçme nr. ***, datë 15.3.2010; si dhe apartamenti i katit të 7-të i është lënë shoqërisë së ndërtimit për shkak të punimeve shtesë të kryera nga shoqëria dhe shtesës prej 10 m², në njësinë që do të përfitohej nga nëna e subjektit, znj. H. S.

³Deklaratë noteriale nr. ***.

⁴Përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k.

⁵Nr. ***.

⁶Deklaratë noteriale nr. ***.

⁷Nga kontrolli në sistemin multifunksional të ASHK-së.

⁸Nga dokumentacioni i disponuar nga ASHK-ja Fier rezulton se subjekti i rivlerësimit, përveç pasurive të sipërcituara, ka realizuar blerjen e disa pasurive në vitin 2018 e përkatësisht pasurisë së llojit “arë” me sipërfaqe prej 600 m² në z. k. ***,

në emër të subjektit janë të regjistruara pasuritë e llojit apartament banimi me nr. pasurie ***, si dhe pasuria e llojit bodrum, regjistruar me nr. pasurie ***, të ndodhura në z. k. **. UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2020, ka bërë me dije se në emër të subjektit dhe personave të lidhur nuk rezultojnë kontrata, ndërsa FSHU-ja me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2020, ka konfirmuar se në emër të subjektit figurojnë dy kontrata furnizimi me nr. *** dhe nr. ***, në qytetin e Fierit.

7. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit me shoqërinë e ndërtimit, administratorin dhe ortakët e saj, Komisioni i drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, në përgjigje të së cilës, kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2021, ka bërë me dije se me shtetasit apo personat juridikë të listuar në shkresën përkatëse nuk rezulton asnjë çështje penale e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino.
8. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ për sa i takon këtyre pasurive, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika për sa i takon burimit të krijimit të pasurive në fjalë nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe të shumës së dhuruar prej 20.000 euro, për sa kohë këto pasuri janë përfituar nëpërmjet dhurimit të bërë nga prindërit e tij, të cilët i kishin përfituar ato më parë në mënyrë të ligjshme.

2. Automjeti tip “Mercedes-Benz”

9. Automjeti tip “Mercedes-Benz” me targa *** është deklaruar për herë të parë nga subjekti në DIPP-në e vitit 2015, si pasuri e përfituar me anë të kontratës së shitblerjes së datës 27.10.2015, kundrejt çmimit 14.000 euro dhe 397.079 lekë të paguara për detyrimin doganor, nga ku në total për këtë automjet shuma e paguar ka qenë në vlerën 2.324.179 lekë. Si burim të krijimit të kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar kursimet ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi si vijon:
 - a. shumën 400.000 lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***;
 - b. shumën 1.000.000 lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa ***;
 - c. shumën 1.000.000 lekë nga shitja e një tjetër automjeti tip BMW.
10. Referuar dokumentacionit të administruar, Komisionit i ka rezultuar se automjeti me targa *** është përfituar me anë të një kontrate/fature blerjeje në shtetin gjerman të datës 27.10.2015, kundrejt çmimit 14.000 euro, për të cilin ka kryer edhe zhdoganimin në datën 18.11.2015, në vlerën 397.079 lekë. Nga informacioni i disponuar nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2020, si dhe nga AMF-ja me shkresën nr. ***prot., datë 3.3.2020, institucionet kanë konfirmuar informacionin e sipërcituar, si dhe kanë vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe policat e sigurimit për automjetin e lartpërmendur⁹.

Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë në analizë

a. Të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***

11. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2003 subjekti ka deklaruar pronësinë e automjetit me targa ***¹⁰ me vlerë 300.000 lekë, ndërkohë nga dokumentacioni i zotëruar nga Komisioni ka

nr.pasurie ***, pasurisë me sipërfaqe 600 m², të regjistruar në z. k. ***, pasuri ***, pasurisë së llojit “arë” me sipërfaqe totale 1.100 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. pasurie ***.

⁹Nga informacioni i ardhur nga DPSHTRR-ja dhe AMF-ja, duket se automjeti fillimisht ka pasur targën *** dhe më pas të ketë marrë targën ***.

¹⁰Ky automjet ka vit prodhimi 1983.

rezultuar se automjeti është blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 28.12.2001¹¹, kundrejt çmimit 50.000 lekë. I pyetur në lidhje me mospërputhjen e konstatuar midis vlerës së deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 dhe asaj të përshkruar në kontratën e shitblerjes, subjekti është shprehur se përveç çmimit të blerjes i ka kryer riparime mjetit në vlerën 250.000 lekë.

12. Më pas ky automjet është shitur me anë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 6.6.2015, kundrejt çmimit 400.000 lekë. I pyetur nga Komisioni lidhur me arsyet e shitjes së automjetit në një vlerë më të lartë se çmimi i blerjes, pas një periudhe prej 14 vjetësh përdorimi dhe amortizimi, subjekti është shprehur se automjeti kishte marrë vlerë si relike për shkak të vitit të prodhimit të tij në vitin 1983 dhe se ishte mbajtur në gjendje shumë të mirë nga ana e tij.
13. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin që të provonte pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti është shprehur se ligji për tatimin në burim ka ekzistuar, por jo për individët e paregjistruar në organet tatimore, pasi çdo veprim për ndryshimin e pronësisë kryhet në institucionet shtetërore, të cilat janë të detyruara në bazë të ligjit të nxjerrin një urdhër pagese për tatimin që duhet paguar dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokument për kryerjen e kësaj pagese.
14. Në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të kryer pagesën e tatimit mbi të ardhurën e realizuar në këtë rast, prej 350.000 lekësh dhe, për rrjedhojë, duket se kjo e ardhur nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Nga sa më sipër, Komisioni i ka njohur në analizën financiare, në këtë rast, të ardhurat në masën prej 50.000 lekësh të barabartë me çmimin e blerjes së automjetit.

b. Të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***

15. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se automjeti tip “Mercedes-Benz”, i vitit të prodhimit 2000, ishte blerë nga subjekti me anë të faturës nr. ***, datë 25.9.2008, nga shoqëria e huaj “****”, kundrejt çmimit 4.000 euro, për të cilin subjekti ka kryer zhdoganimin në datën 1.10.2008, në vlerën 339.511 lekë, ku në total vlera e investimit për këtë automjet ka qenë 832.251 lekë. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2008 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë e automjetit, por pa deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. I pyetur nga Komisioni, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se si burim për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes.
16. Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësitë e subjektit, për kryerjen e pagesave të mësipërme gjatë vitit 2008. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, Komisionit nuk i ka rezultuar deklarimi i ndonjë kursimi të disponuar *cash* në banesë, së paku deri në vitin 2008. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij ka rezultuar se deri në datën 25.9.2008, prej tyre janë tërhequr fondet nga llogaritë e pagave në shumën 725.000 lekë, të cilat janë përfshirë në analizë së bashku me të ardhurat e prindërve¹² të subjektit nga pensionet, për një periudhë 9-mujore, prej 190.652 lekësh. Gjithashtu, nga dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 20.5.2020, ka rezultuar se aktiviteti i nënës së subjektit H. S. person fizik, gjatë vitit 2008, ka realizuar një

¹¹Pala shitëse, sipas dokumentacionit të deklaratës doganore të datës 17.4.2000, e kishte blerë në çmimin 2.500 marka gjermane (konvertuar në 172.300 lekë), paguar taksë doganore në masën 128.607 lekë, nga ku vetë pala shitëse ka paguar një vlerë prej 300.907 lekësh, e pas 1 viti i është shitur subjektit me çmimin 50.000 lekë.

¹²Për sa kohë subjekti ka deklaruar se ka banuar së bashku me prindërit e tij deri në vitin 2011.

fitim *neto* prej 1.016.412 lekësh¹³. Pas përfshirjes së shpenzimeve të familjes për të njëjtën periudhë ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e blerjes dhe pagesës së zhdoganimit të mjetit në analizë, sipas detajimit në tabelën në vijim.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për blerjen e automjetit me targa ***

Të tërhequra nga llogaria e pagës së subjektit 1.1.2008-25.9.2008	638 000
Të tërhequra nga llogaria e pagës së b/shortes 1.1.2008-25.9.2008	87 000
Të ardhura nga pensioni i nënës janar-shtator	97 583
Të ardhura nga pensioni i babait janar-shtator	93 069
Të ardhura nga aktiviteti i nënës janar-shtator	762 309
Shpenzime jetese (5 persona) janar-shtator	(512 325)
Shpenzime udhëtimi 1.1.2008 - 25.9.2008	(252 947)
Shpenzim për blerje automjeti	(492 730)
Shpenzim për zhdoganim automjeti	(339 521)
Rezultati në datë 25.9.2008	80 437

17. Ka rezultuar se më tej automjeti i sipërcituar është shitur me anë të kontratës së shitjes nr.***, datë 9.6.2015, kundrejt çmimit 1.000.000 lekë. I pyetur nga Komisioni lidhur me arsyet e shitjes së këtij automjeti në një vlerë më të lartë se çmimi i blerjes, pas një periudhe prej 7 vjetësh përdorimi dhe amortizimi, subjekti është shprehur se automjeti është mirëmbajtur nga ana e tij dhe se janë kryer riparime, por pagesat janë kryer *cash* dhe nuk janë mbajtur faturat.
18. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga kjo shitje. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si më lart dhe në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Komisioni arrin në përfundimin se ai ka pasur detyrimin për të kryer pagesën e tatimit mbi të ardhurën e realizuar në këtë rast, prej 167.749 lekësh dhe, për rrjedhojë, kjo e ardhur nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Nisur nga sa më sipër, Komisioni ka njohur në analizën financiare të ardhurat në masën 832.251 lekë, të barabartë me çmimin e blerjes dhe pagesën e zhdoganimit të automjetit.

c. Të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***

19. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se automjeti tip BMW, i vitit të prodhimit 2006, ishte blerë fillimisht nga subjekti me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 9.6.2015, kundrejt çmimit 500.000 lekë¹⁴. Në të njëjtën datë me blerjen e këtij automjeti, subjekti ka shitur automjetin me targa *** dhe, për rrjedhojë, Komisioni ka konkluduar se ai ka pasur burime të ligjshme financiare për kryerjen e këtij investimi.
20. Pas 4 muajsh, ky automjet është shitur me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***9, datë 20.10.2015, kundrejt çmimit 1.000.000 lekë. I pyetur nga Komisioni lidhur me arsyet e shitjes së automjetit në një vlerë dyfish më të lartë se çmimi i blerjes vetëm pas 4 muajve, subjekti

¹³Komisioni ka përlogaritur fitimin për një periudhë 9-mujore, në mënyrë përpjesëtimore me të ardhurat *neto* nga aktiviteti të gjithë vitit.

¹⁴Ky automjeti rezulton të ketë hyrë për herë të parë në tetor të vitit 2011 dhe blerë me vlerën 10.000 euro për të cilin është paguar detyrim doganor në vlerën 347.809 lekë, nga ku duket se investimi prej palës shitëse ka qenë 1.730.809 lekë dhe duket se i është shitur subjektit pas 4 vitesh në më pak se 1/3 e vlerës.

është shprehur se në momentin e blerjes automjeti nuk ishte në gjendje të rregullt teknike dhe se nga ana e tij janë kryer disa shërbime në vlerën 283.200 lekë, për të cilat ka paraqitur faturën¹⁵ përkatëse. Nga analizimi i zërave të shërbimeve të përshkruara në faturën e shërbimit vërehet se ato janë kryesisht shërbime rutinë të mirëmbajtjes së një automjeti dhe jo të natyrës funksionale, të tilla që të mund të rrisnin vlerën e kësaj pasurie dhe, për rrjedhojë, Komisioni këtë shumë/vlerë e ka përfshirë si shpenzim në analizën financiare. Gjithashtu, i pyetur lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga kjo shitje, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka dhënë të njëjtën përgjigje si për dy automjetet e tjera të lartpërmendura, për rrjedhojë Komisioni ka njohur në analizën financiare në këtë rast të ardhurat në masën 500.000 lekë, të barabartë me çmimin e blerjes së automjetit.

21. Gjithashtu, Komisioni ka hetuar mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit me palët¹⁶ e përfshira në këto transaksione duke iu drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2021, ka bërë me dije se nuk ka rezultuar asnjë çështje penale të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino.

d. Të ardhura nga pagat dhe aktiviteti i bashkëshortes

22. Përveç të ardhurave nga shitjet e automjeteve të sipëranalizuara, Komisioni ka përfshirë në analizë edhe të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe nga aktiviteti tregtar si person fizik¹⁷ i bashkëshortes së tij për harkun kohor janar 2015 – 18.11.2015, për të përcaktuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e investimit në fjalë, me burime të ligjshme financiare.
23. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2015, Komisionit nuk i ka rezultuar ndonjë pakësim apo ndryshim i deklaruar i kursimeve të disponuara *cash* në banesë dhe, për pasojë, ato nuk janë konsideruar si një ndër burimet për blerjen e këtij mjeti. Në përfundim të analizimit të të gjitha burimeve të të ardhurave të familjes së subjektit për këtë periudhë, ka rezultuar se për blerjen e automjetit dhe përballimin e shpenzimeve dhe investimeve në llogaritë bankare, ata kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 2.047.318 lekë¹⁸, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

¹⁵Faturë shitjeje lëshuar nga shtetasi E. L., në datën 15.9.2015, për riparimet e automjetit me targa *** në shumën totale 283.200 lekë, në këtë faturë janë përshkruar riparimet e kryera automjetit, konkretisht: kambio, vaj kambio, filtër vaj kambio, vaj motori, filtër vaj motori, filtër ajri, filtër naftë, filtër kabine, diferencial, gomat e përparme dhe të pasme, si dhe punëtorja.

¹⁶Shtetasit K. K., B. B., E. M., A. B. dhe E. M.

¹⁷Nga dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Fier ka rezultuar se personi fizik A. S. rezulton të jetë regjistruar në DRT Fier me aktivitet privat: përmbarues gjyqësor deri në datën 29.7.2013 dhe pas kësaj date “noter”. Subjekti ka realizuar të ardhura si vijon: (i) në vitin 2012 fitimi pas tatimit 2.104.864 lekë; (ii) në vitin 2013 fitimi pas tatimit 2.332.834 lekë; (iii) në vitin 2014 fitimi pas tatimit 2.025.737 lekë; (iv) në vitin 2015 fitimi pas tatimit 2.918.714 lekë; dhe (v) në vitin 2016 fitimi pas tatimit 2.649.239 lekë. Personi fizik i bashkëshortes së subjektit nuk ka pasur detyrim ligjor për shpërndarje dividendi.

¹⁸Balanca e vitit 2015 është më e ulët për shkak të konsiderimit në të, të të ardhurave e shpenzimeve të të gjithë vitit si dhe, ndër të tjera, të një investimi në depozitë me afat të shumës 1.000.000 lekë nga bashkëshortja e subjektit, shumë kjo e cila është tërhequr prej saj në dhjetor të vitit 2015, duke mos ndikuar në analizën e vitit.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për blerjen e automjetit me targa ***

Të ardhura nga shitja e automjetit ***	50,000
Të ardhura nga shitja e automjetit ***	832,251
Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2015-18.11.2015	1,126,056
Të ardhura nga aktiviteti b/shortes janar - nëntor 2015	1,957,716
Gjendjet në llogaritë bankare 01.01.2015	5,683,162
Gjendjet në llogaritë bankare 18.11.2015	(7,940,938)
Shpenzim për blerjen e automjetit ***	(500,000)
Të ardhura nga shitja e automjetit ***	500,000
Shpenzime jetese (3 persona) janar - nëntor 2015	(616,759)
Shpenzime udhëtimi 1.1.2015 - 18.11.2015	(516,076)
Shpenzim për siguracion automjeti	(15,350)
Shpenzim për riparim automjeti	(283,200)
Shpenzim për blerjen e mjetit ***	(1,927,100)
Shpenzim për zhdoganim automjeti	(397,079)
Rezultati në datë 18.11.2015	(2,047,318)

24. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, sa i takon pasurisë në analizë, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve si në vijim:

- *Duket se ka mospërputhje midis vlerës së deklaruar të automjetit në DIPP-në e vitit 2003, krahasuar me çmimin e përshkruar në kontratën e shitblerjes së mjetit.*
- *Duket se për investimin e kryer në vitin 2008, për blerjen e automjetit me targa ***, subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.*
- *Duket se të ardhurat, si fitim i shtuar (blerje - shitje) nga shitjet e 3 automjeteve të analizuara, në masën prej 1.017.749 lekësh (350.000 lekë për mjetin e parë; 167.749 lekë për mjetin e dytë; dhe 500.000 lekë për mjetin e tretë), nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë prej subjektit nuk janë paguar detyrimet përkatëse tatimore për të ardhurat e realizuara nga shitja e tyre.*
- *Duket se për investimin e kryer në vitin 2015, për blerjen e mjetit me targa ***, si dhe për të përballuar shpenzimet dhe investimet e kryera në llogaritë bankare, deri në datën 18.11.2015, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën **2.047.318 lekë**.*
- *Duket se nuk ka logjikë ekonomike në transaksionet e kryera nga subjekti i rivlerësimit përgjatë vitit 2015, duke shitur 3 automjete me çmime më të larta krahasuar me çmimet e blerjes së tyre, pas vitesh të tëra përdorimi dhe amortizimi (apo në një rast dyfishimi të çmimit pas 4 muajsh), të cilat duket se ngrenë dyshime për veprime fiktive të kryera posaçërisht me qëllim për të rritur në mënyrë artificiale të ardhurat dhe për të justifikuar më pas blerjen e automjetit të ri.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

25. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ në prapësimet e tij, ka shpjeguar se fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nuk është një e ardhur e

tatueshme, bazuar në udhëzimin nr. ***, datë 30.1.2006, të Ministrisë së Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku në pikën 2 përcaktohet se “Tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara nga ligji”, si dhe në nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: *“Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”*. Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton qartë se taksat dhe tatimet vendosen vetëm me ligj dhe asnjë organ shtetëror apo publik nuk mund të përcaktojë se cilat janë të ardhurat e tatueshme.

26. Për sa i takon automjetit të blerë në vitin 2015, subjekti ka pretenduar se ndonëse nuk është shprehur qartësisht në DIPP- në e vitit 2015, ai ka pasur për qëllim të deklarojë se, ndër të tjera, ka pakësuar kursimet e realizuara ndër vite, përkatësisht me shumën 500.000 lekë për blerjen e automjetit dhe rreth 400.000 lekë për zhdoganimin e mjetit, pra në total me 900.000 lekë.
27. Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për automjetin, duke pretenduar se: (i) fitimi i aktivitetit të bashkëshortes si person fizik nuk mund të përlllogaritet në mënyrë përpjesëtimore, në raport me të ardhurat e vitit, pasi nuk mund të përcaktohet se sa kanë qenë në një datë të caktuar të gjithë zërat e një bilanci, duke e bërë të pamundur përlllogaritjen e saktë të fitimit, por ai nuk ka pretenduar ndonjë vlerë konkrete të fitimit për periudhën e analizuar; (ii) shpenzimet për riparimet e automjeteve, përkatësisht 250.000 lekë në vitin 2001 dhe 283.200 lekë në vitin 2015, duhet të shtohen si të ardhura, për shkak se kanë qenë investime të kryera në këto automjete¹⁹; dhe (iii) subjekti ka pretenduar se edhe nëse gjendja *cash* në fund të vitit nuk do të kishte ndryshuar, për sa kohë deklaratimet janë në bazë vjetore - kjo gjendje gjatë vitit ka ndryshuar dhe është riplotësuar më pas me shumën e tërhequr nga bashkëshortja në dhjetor të vitit 2015. Në përfundim të sa më sipër, subjekti ka paraqitur një analizë financiare të kryer për blerjen e automjetit, në të cilën ka shtuar shumat e shpenzuara për riparimet e automjeteve në rubrikën e të ardhurave, si dhe ka zvogëluar gjendjen *cash* me 900.000 lekë, duke rezultuar kështu me një balancë pozitive.

Vlerësimi i trupit gjykues

28. Në analizë të rrethanave në të cilat janë kryer transaksionet e tre automjeteve të lartpërmendura, të cilat subjekti i rivlerësimi i ka shitur në vitin 2015 me çmime më të larta se ai i blerjes së tyre, si dhe duke mbajtur në vëmendje faktin se çdo mjet me kalimin e kohës amortizohet dhe humb vlerën e tij në treg, ndërsa riparimet që kryhen në mënyrë të vazhdueshme nevojiten për të mirëmbajtur gjendjen e tyre funksionale, përgjithësisht nuk mund të justifikojnë rritjen e vlerës së tyre, kështu nuk ka logjikë ekonomike shitja e tyre me një çmim ndjeshëm më të lartë nga sa janë blerë – ndonëse palët në marrëdhëniet e tyre juridiko-civile mund të përcaktojnë lirisht çmimet e shitblerjeve që kryejnë, të cilat jo gjithmonë dhe detyrimisht pasqyrojnë vlerën e tyre reale.
29. Gjithashtu, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimi për sa i takon mospasjes së detyrimit për të paguar tatimin mbi të ardhurat e realizuara nga shitjet me fitim të automjeteve të mëparshme, trupi gjykues – duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit²⁰, si dhe duke analizuar dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar – vlerëson se për sa kohë nuk rezultoi i paguar tatimi mbi fitimin e realizuar, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ato nuk mund të konsiderohen

¹⁹Në këtë pikë, subjekti ka pretenduar gjithashtu se shpenzimi prej 283.200 lekësh i është përlllogaritur nga Komisioni gabimisht dy herë, edhe te blerja e automjetit edhe si shpenzim më vete, por nga riverifikimi i analizës financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor, ka rezultuar se ajo është përlllogaritur vetëm një herë.

²⁰Vendimi nr. 34(JR), datë 2.12.2019.

si një e ardhur financiare me burim të ligjshëm dhe, për rrjedhojë, nuk janë përfshirë në analizën përkatëse financiare si një burim financiar i ligjshëm.

30. Lidhur me pretendimin e subjektit për sa i përket shtimit të vlerës së automjeteve si pasojë e kryerjes së shërbimeve të tyre, veç sa u argumentua më sipër (paragrafi 28), trupi gjykues vëren se: (i) nga shqyrtimi i kontratave të shitblerjeve të automjeteve nuk rezulton të jetë përshkruar ndonjë defekt apo e metë e automjeteve kur janë blerë nga subjekti, apo ndonjë pretendim/rezervë nga palët në momentin e nënshkrimit të kontratave të shitblerjes, për sa i takon gjendjes së tyre teknike; (ii) subjekti ka paraqitur vetëm një faturë për riparimin e njërit prej mjeteve për një vlerë më të vogël se diferenca e rritjes së çmimit, ndërkohë që riparimet e pretenduara lidhur me automjetin tjetër mbeten në nivel deklarativ; (iii) nisur nga natyra e riparimeve të kryera për mirëmbajtje – këto shuma nuk mund të përfshihen në çmimin e blerjes së mjeteve, në mënyrë që të ishin të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat. Edhe nëse shpenzimet e dokumentuara do të konsideroheshin hipotetikusht si një vlerë e shtuar e mjetit në fjalë, gjithsesi nuk do të kishte një impakt mbi rezultatin dhe vlerësimin final, pasi në çdo rast nuk do të justifikoheshin diferenca e të ardhurave të realizuara nga shitja e tre automjeteve në raport me vlerat me të cilat këto automjete ishin blerë nga subjekti.
31. Lidhur me pretendimin për pakësimin e gjendjes *cash* me vlerën e pretenduar prej 900.000 lekësh, nisur nga orientimi i Kolegjit²¹ mbi raste të ngjashme, Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk është deklaruar pakësimi i gjendjes së disponuar *cash* në banesë nga subjekti në vitin përkatës, ky pretendim nuk mund të konsiderohet. Ndërsa, sa i përket përdorimit të mundshëm të këtyre kursimeve të disponuara *cash* në banesë, përgjatë vitit 2015 për blerjen e automjetit dhe mundësisë financiare për t'i rikrijuar/zëvendësuar ato deri në fund të vitit – ndonëse përdorimi i tyre nuk është deklaruar konkretisht në DIPP-në përkatëse të vitit 2015, si një ndër burimet për blerjen e kësaj pasurie – trupi gjykues vlerëson se duhet të pranohet nisur nga fakti që kjo mundësi nuk mund të përjashtohet, për sa kohë subjekti i rivlerësimit atë vit ka pasur të deklaruara kursime të disponuara në banesë, të cilat ishin krijuar më herët me burime të ligjshme financiare dhe kësajsoj ato mund të jenë përdorur përkohësisht nga subjekti. Ndërkohë që mundësitë financiare me burime të ligjshme për të riplotësuar brenda vitit gjendjen *cash*, pasqyrohen në analizën financiare të vitit përkatës, që po specifikohen në vijim.
32. Bazuar në deklaratimet e subjektit mbi kursimet e disponuara *cash* në banesë dhe ndryshimet e deklaruara prej tij në deklaratat periodike të dorëzuara, Komisionit i ka rezultuar se deri në fund të vitit 2014, subjekti ka pasur kursime në masën 3.666.000 lekë, të cilat duke u shtuar si një ndër burimet në analizën e kryer, do të ishin të mjaftueshme për të mundësuar blerjen e automjetit në fjalë, me burime të ligjshme financiare. Por, nga analiza financiare e vitit 2015, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej 834.039 lekësh, për të riplotësuar kursimet *cash*, deri në fund të vitit 2015.
33. Në përfundim të sa më sipër, duke pranuar këtë pretendim të subjektit – në kushtet që shuhet/zerohet mangësitë e konstatuara më herët në rezultatet e hetimit lidhur me burimin financiar për krijimin e pasurisë automjet, ndonëse pjesërisht krijohet një pamundësi e subjektit për të riplotësuar kursimet e tij – trupi gjykues çmon se në vetvete kjo pamjaftueshmëri financiare e rezultuar në analizën financiare të vitit 2015, në vetvete nuk është e mjaftueshme që të justifikojë aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të z. Çlirim Sino.

3. Depozitë bankare në masën 15.500 euro dhe gjendje *cash* në masën 10.000 euro

²¹Vendimi nr. 7(JR), datë 5.4.2019.

34. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar një depozitë kursimi në masën 15.500²² euro pranë “Intesa Sanpaolo Bank” dhe ka përshkruar si burim krijimi kontratën e dhurimit të vitit 2011, prokurën e posaçme të vitit 2010 dhe deklaratën noteriale të vitit 2011²³. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2011, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në rubrikën e dhuratave dhe trajtimeve preferenciale “mjete monetare dhuruar nga babai”, shumën 20.000 euro, por nuk e ka deklaruar këtë shumë specifikisht të mbartur në gjendje *cash* në banesë, në fund të vitit 2011.
35. I pyetur nga Komisioni lidhur me destinacionin e shumës së dhuruar prej 20.000 euro si pasojë e mosdeklarimit ndër vite të mbartjes apo pakësimit/shpenzimit të kësaj shume, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti është shprehur se shumën 15.500 euro e ka depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank”, ndërsa pjesën tjetër e ka shpenzuar gjatë viteve, por pa specifikuar momentin/vitin e shpenzimit të saj. Nga sa më sipër – përpos problematikave dhe pasaktësive në deklaram – Komisioni nuk ka konstatuar problematika mbi ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për të kryer depozitim të shumës 15.500 euro në janar të vitit 2017.
36. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të dorëzuara nga subjekti, ndër vite, rezulton se ky i fundit ka deklaruar kursime me përshkrimet përkatëse si vijon:
- në DIPP/2009 – mjete monetare 500.000 lekë;
 - në DIPP/2011 – kursime nga paga 300.000 lekë;
 - në DIPP/2012 – kursime nga paga 100.000 lekë;
 - në DIPP/2016 – gjendje *cash* në banesë 10.000 euro kursime të bashkëshortes si notere nga fitimi i gjithë vitit 2016.
37. Referuar deklarimeve ndër vite dhe kërkesave ligjore për deklaram, duket se në fund të vitit 2016 subjekti duhet të kishte një gjendje të disponuar *cash* në banesë, në vlerën 5.018.700 lekë përfshirë këtu edhe shumën prej 20.000 euro të dhuruar nga babai. Ndërkohë nga shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, Komisioni konstaton se as subjekti dhe as bashkëshortja nuk kanë deklaruar ndonjë gjendje të disponuar *cash*. Lidhur me mospërputhjen e sipërcituar Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegimet e tij nëpërmjet pyetësorit nr. 5, duke i kërkuar të saktësonte gjendjen e disponuar *cash* në datat 31.12.2016 dhe 25.1.2017. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se gjendja e disponuar në banesë në datën 31.12.2016 ka qenë 10.000 euro, si dhe në datën 25.1.2017 ka qenë po 10.000 euro, por mosdeklarimi në deklaratën *Vetting* të kësaj gjendjeje ka qenë një harresë dhe se ai nuk ka pasur për qëllim fshehjen e tyre.
38. Për sa i takon gjendjes së pretenduar si të kursyer gjatë vitit 2016, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se për të mbuluar shpenzimet e familjes, për të krijuar shtesat e rezultuara në llogaritë bankare, si dhe për të krijuar kursimet e pretenduara në gjendje *cash*, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin e tyre me burime të ligjshme financiare.

²²Referuar dokumentacionit bankar ka rezultuar se subjekti ka depozituar në llogarinë e tij në euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, përkatësisht shumën 12.000 euro në datën 20.1.2017 dhe shumën 3.500 euro në datën 23.1.2017 me përshkrimin “*kursime familjare*”.

²³Këto dokumente të trajtuara në pasurinë nr. 1 kanë të bëjnë me dhurimin e shumës 20.000 euro nga babai i subjektit.

Tabela nr. 3 – Analiza financiare për vitin 2016

Të ardhura të vitit 2016	4 141 849
Shpenzime të vitit 2016	(2 029 836)
Shtesë në gjendjen cash në fund të vitit	(1 352 700)
Shtesë në gjendjet e llogarive bankare	(492 773)
Rezultati i vitit 2016	266 540

39. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, i ka kërkuar shpjegime për sa vijon:

- *Duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit në DIPP-të ndër vite, sa i përket kursimeve në gjendje cash në banesë dhe atyre të pretenduara në përgjigje të pyetësorëve.*
- *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting gjendjen e disponuar cash në banesë prej së paku 10.000 euro, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016.*
- *Duket se për të mbuluar shpenzimet e familjes, për të krijuar shtesat e rezultuara në llogaritë bankare, si dhe për të krijuar kursimet e pretenduara në gjendje cash, në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, në prapësimet e tij ka shpjeguar se nga kursimet e deklaruara prej tij ndër vite, në vitin 2015 gjendja *cash* është pakësuar me 900.000 lekë, siç u trajtua më lart në analizën e pasurisë nr. 2 të këtij vendimi. Po ashtu, ai ka bërë me dije se ndonëse prej tij nuk ishte deklaruar saktësisht në vitin 2011, nga shuma 20.000 euro që i kishte dhuruar babai, në fund të vitit ka pasur të kursyer vetëm shumën 15.500 euro, e cila më pas është depozituar në janar të vitit 2017. Nga sa më sipër, subjekti është shprehur se në fund të vitit 2016, ka pasur në banesë gjendje *cash* 15.500 euro nga paratë e dhuruara nga babai dhe 10.000 euro nga aktiviteti i bashkëshortes.
41. Subjekti është shprehur gjithashtu se këto pasaktësi që lidhen me mosdeklarimin e gjendjes *cash* në shumën 10.000 euro në deklaratën *Vetting*, si dhe mospasqyrimi me saktësi të plotë i pakësimit të kursimeve në vitet 2011 dhe 2015, janë pasaktësi të karakterit formal, për sa kohë ato nuk shoqërohen me pamjaftueshmëri financiare, duke cituar qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimin nr. 10, datë 14.4.2022²⁴.

Vlerësimi i trupit gjykues

42. Trupi gjykues, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pakësimin e gjendjes *cash* në vitet 2011 dhe 2015, për sa kohë ato nuk janë deklaruar si pakësim në deklaratat periodike të viteve përkatëse, as nuk mund të konsiderohen si disponibilitet i mjeteve financiare të ligjshme, por vetëm në masën e një mjaftueshmërie për zëvendësimin brenda vitit të shumave të pretenduara si të

²⁴Kolegji arsyeton se: “Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *Vetting* nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të llogarisë së përbashkët bankare me vëllain e saj, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet përpara deklarimit të pasaktë, jo në përputhje me nenin 33, pika 5, germa ‘a’ e ligjit nr. 84/2016, por kjo pasaktësi nuk shoqërohet me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për shumat e depozituara prej saj në këtë llogari, sipas analizës financiare të kryer në Komision dhe në Kolegji dhe, për këtë shkak, për subjektin e rivlerësimit nuk mund të aplikohet pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.

përdorura nga gjendja *cash*. Ndërsa, lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të kursimeve prej 10.000 euro, të deklaruara në DIPP-në e vitit 2016, trupi gjykues vlerëson se kjo pasaktësi në vetvete nuk mund të përbëjë shkak për aplikimin e ndonjë mase rënduese ndaj subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk lidhet me pamundësinë financiare të krijimit të shumave në fjalë.

4. Llogari e pagës dhe llogari plan kursimi në “Intesa Sanpaolo Bank”

43. Nga shqyrtimi i deklaratës *Vetting* ka rezultuar se subjekti ka deklaruar gjendjen në llogarinë e tij të pagës në “Intesa Sanpaolo Bank”, shumën prej 355.487 lekësh. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se kjo gjendje është krijuar nga kreditimi i pagave të tij dhe shuma e deklaruar përputhet me gjendjen në datën 24.1.2017. Po ashtu, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendje në llogarinë e tij të kursimit në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 31.222 lekë. Në përfundim të sa më sipër, gjendjet e deklaruara përputhen me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të këtyre llogarive.

5. Pasuri të deklaruara veçmas nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit

5.1 Apartament banimi në lagjen “**”, Vlorë**

44. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit²⁵ ka deklaruar pasurinë e llojit apartament me sip. 49 m², të blerë kundrejt vlerës 2.800.000 lekë, të përfutur me anë të kontratës së porosisë së vitit 2005, me burim krijimi të ardhurat personale nga puna dhe nga prindërit e saj në emigracion. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se apartamenti ishte porositur fillimisht me anë të kontratës së porosisë²⁶ së datës 2.9.2005, nënshkruar kjo mes bashkëshortes së subjektit A. L. dhe shoqërive ndërtuese “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. Në datën 12.2.2007, palët e lartpërmendura kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes kundrejt çmimit 2.857.500 lekë²⁷ dhe, më tej, pasuria është regjistruar në z. k. ***, me nr. pasurie ***.
45. Nga shqyrtimi i DIPP-ve ndër vite të subjektit dhe të bashkëshortes ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë prej të dyve, në vitin 2008, me vlerën 3.100.000 lekë, me burim krijimi të dhuruar nga prindërit e bashkëshortes. I pyetur nga Komisioni lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie përgjatë viteve 2005 - 2007 nga bashkëshortja dhe në DIPP-në e vitit 2007 nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, është shprehur se pasuria nuk është deklaruar prej tij, pasi ata janë martuar në datën 28.9.2007. Ndërsa, lidhur me mospërputhjen midis çmimit të deklaruar prej tyre dhe çmimit të përshkruar në kontratën e shitblerjes, subjekti ka shpjeguar se përveç shlyerjes së çmimit bashkëshortja e tij ka kryer edhe pagesat për regjistrimin²⁸ e kësaj pasurie, si dhe pagesa të tjera²⁹, të cilat e kanë çuar vlerën totale të shpenzuar në 3.100.000 lekë.

²⁵Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues për shkak të funksionit të saj publik, si përmbaruese gjyqësore (Zyra e Përmbarimit Vlorë – Fier) për periudhën 2002 – 2012.

²⁶Jo e nënshkruar në prani të noterit publik.

²⁷Referuar udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit ‘K’ për vitin 2005”, të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për qytetin e Vlorës, kostoja e shitjes për sipërfaqe shfrytëzimi ka qenë me vlerën 48.716 lekë/m², ku do të rezultonte për këtë apartament një çmim prej 2.387.084 lekësh.

²⁸Bashkëlidhur mandatarëtimi paguar shoqërisë “****” sh.p.k. vlera 105.000 lekë, datë 15.10.2006 dhe mandatarëtimi i datës 15.9.2006, në shumën 160.000 lekë.

²⁹Nga administrimi i dokumentacionit të ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2017, kjo e fundit ka konfirmuar pasurinë e sipërcituar.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

46. Nga shqyrtimi dhe analizimi i deklaratës *Vetting* ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar burimin e kësaj pasurie nga të ardhurat e saj nga puna dhe nga prindërit në emigracion, ndërsa në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin e banimit në Vlorë, të dhuruar nga prindërit e bashkëshortes. I pyetur nga Komisioni lidhur me mospërputhjen midis burimit të krijimit të deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 dhe atij të përshkruar në deklaratën *Vetting*, subjekti është shprehur se: *“Kjo pasuri është blerë nga prindërit e bashkëshortes dhe fondet janë 100% të tyre, mospërputhja në DIPP-në e vitit 2008 me deklaratën Vetting, ka ardhur si pasojë e një lapsusi dhe pa asnjë qëllim fshehjeje”*.
47. Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni i është drejtuar subjektit për të paraqitur mandatpagesat e kryera nga bashkëshortja për këtë apartament, me qëllim që të qartësohej periudha kohore e kryerjes së këtyre pagesave, si dhe përfshirja e mundshme e ndonjë kontributi financiar të subjektit në këtë investim. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, ai ka paraqitur dy mandatet³⁰ e kryerjes së pagesave të çmimit të shitblerjes nga bashkëshortja e tij, konkretisht pagesën e shumës prej 1.160.000 lekësh në datën 2.9.2005 dhe të shumës 1.640.000 lekë në datën 20.12.2005, duke shpjeguar se bashkëshortja e tij ka jetuar në këtë apartament në periudhën shkurt 2005 – 2007 dhe se ky apartament përdoret nga familja e tij për pushime dhe se nuk është dhënë asnjëherë në përdorim apo me qira.
48. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqiste dokumentacionin provues të burimit të ligjshëm të shumës 3.100.000 lekë të dhuruar bashkëshortes së tij, nga prindërit e saj. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se pasuria në fjalë është blerë nga ana e tyre, për arsye se vajza e tyre në atë kohë punonte në qytetin e Vlorës, duke bërë me dije se si burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e tyre nga emigracioni në Greqi prej vitit 1991.
49. Së bashku me përgjigjet e mësipërme subjekti ka paraqitur një deklaratë³¹ noteriale të lëshuar nga nëna dhe vëllai i bashkëshortes në ***, Greqi, datë 23.11.2020, në të cilën kanë deklaruar se këstet për likuidimin e vlerës monetare për apartamentin në Vlorë i kanë paguar ata, pasi kanë punuar në Greqi pa ndërprerje. Gjithashtu, në mbështetje të sa më sipër, pjesë e dokumentacionit të disponuar është edhe një deklaratë noteriale me nr. ***, e datës 1.4.2010, e lëshuar nga babai i bashkëshortes së subjektit, në të cilën është deklaruar se pagesa për apartamentin është përballuar nga ana e tij dhe bashkëshortes së tij, të cilët kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në emigracion dhe se kjo ka qenë një dhuratë që i është bërë vajzës së tyre përpara martesës.
50. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë dokumentacion ligjor që të provonte mënyrën e dhurimit/kalimit të shumave nga familja e origjinës së bashkëshortes te kjo e fundit apo ndonjë dokumentacion që të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre. Referuar ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është pikërisht kontrolli i pasurisë, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Për pasojë, sa i përket verifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të të ardhurave të përdorura prej familjes së origjinës së bashkëshortes së subjektit, të cilat kanë shërbyer/kontribuar në blerjen e apartamentit në

³⁰Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka vënë në dispozicion edhe një deklaratë noteriale me nr. ***, datë 3.7.2021, të shtetasit Gj. B., i cili ka konfirmuar deklaratimet e bashkëshortes së subjektit për lidhjet e kontratave të viteve 2005 dhe 2007, me çmimet e rena dakord.

³¹Në këtë deklaratë palët kanë deklaruar gjithashtu se nga momenti i martesës së vajzës A. L. me z. Çlirim Sino e në vijim, për të gjitha udhëtimet e tyre në Greqi me ftesë të deklaruesve, i kanë mbuluar të gjitha shpenzimet e qëndrimit.

analizë, Komisioni, nisur edhe nga jurisprudenca e deritanishme³² ka kryer një hetim të hollësishëm administrativ në kuadër të provueshmërisë dhe kënaqjes së kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

51. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu një verifikim dhe një vlerësim ligjor për investime të tjera të mundshme të kryera nga familja e origjinës së bashkëshortes së subjektit deri në fund të vitit 2005, nga ku rezultoi se në emër të shtetasve E. L., M. L., L. L., E. L. nuk rezultoi të ketë pasuri³³ të regjistruara apo të jenë kryer aplikime për legalizimin e objekteve informale. Gjithashtu, nga informacioni i përcjellë nga bankat e nivelit të dytë nuk ka rezultuar ndonjë investim në llogari apo depozita me afat, të kryera nga shtetasit e mësipërm, deri në fund të vitit 2005. Nisur nga sa është administruar si dhe në mungesë të paraqitjes nga subjekti të ndonjë dokumentacioni për të provuar të ardhurat e anëtarëve të familjes së origjinës së bashkëshortes për të blerë apartamentin dhe për të mbuluar shpenzimet e jetesës, duke rezultuar kështu me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën totale të tyre³⁴.
52. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, sa i takon kësaj pasurie Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit për këtë pasuri:
- *Duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar në DIPP-në e vitit 2007, apartamentin në fjalë.*
 - *Duket se deri në këtë fazë të hetimeve, në mungesë të ndonjë dokumentacioni lidhur me të ardhura të mundshme të anëtarëve të familjes së origjinës së bashkëshortes së subjektit, në shtetin grek, familja e bashkëshortes së subjektit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë në analizë për çmimin total të tij prej 2.800.000 lekësh.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

53. Pas u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është shprehur se mosdeklarimi i pasurisë apartament në Vlorë, në vitin 2007, ka qenë një harresë e cila është ndrequr nga prej tyre në DIPP-në e vitit 2008, në një kohë që nuk ishte duke u zhvilluar procesi *Vetting*, duke pretenduar se për këtë çështje janë mbajtur qëndrime në praktikën e Kolegjit, referuar vendimit nr. 37, datë 24.11.2021. Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar se pasuria ishte porositur fillimisht nga e shoqja me anë të kontratës së porosisë së vitit 2005, si dhe nga ana e saj është shlyer vlera e këtij apartamenti, në po këtë vit, dy vite përpara martesës me subjektin.
54. Lidhur me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e apartamentit, ai ka shpjeguar se kanë shërbyer të ardhurat e familjarëve të bashkëshortes nga emigracioni në Greqi prej vitit 1991 dhe se për shkak të lidhjes së ngushtë prindër – fëmijë, bashkëshortja nuk ka ruajtur dokumentacion mbi mënyrën e dhurimit/kalimit të të hollave nga familja e saj e origjinës.
55. Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të bashkëshortes, së bashku me prapësimet, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacionin në gjuhën greke³⁵ të përkthyer

³²Vendim nr. 15/2021 (JR), datë 18.6.2021, K. S.

³³ASHK-ja Fier me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2021.

³⁴Familja e origjinës së bashkëshortes së subjektit ka pasur edhe shpenzime për jetesën në shtetin grek, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Eurostat në web, linku: <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>.

³⁵Vërtetime nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale e-EFKA Greke për të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së tij.

në gjuhën shqipe, që provon të ardhurat e prindërve nga viti 2002, si vit i parë i deklarimit *online*, pasi më parë, ka shpjeguar ai, nuk ka të dhëna për të ardhurat, pasi merreshin me pulla të cilat prindërit e bashkëshortes nuk i kanë ruajtur duke mos pasur asnjë interes për to. Vjehrra ka realizuar paga shumë herë më të larta nga ato të deklaruara, pasi ka punuar në kategorinë e punësimit “personel shtëpie të punëdhënës të ndryshëm”, duke deklaruar vetëm kontributet minimale për këtë kategori punësimi. Ndërkohë, vjehrra ka realizuar të ardhura gjatë kësaj periudhe sipas vërtetimit të lëshuar, rreth 43.798 euro. Për vitet 2004 dhe 2005 nuk është deklaruar për të gjitha ditët e punës dhe këtu nuk përfshihet edhe bonusi i marrë nga paga. Megjithatë, subjekti ka pretenduar se të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes si për periudhën që kanë mundur të sigurojnë dokumentacionin ashtu edhe për periudhat e tjera paraardhëse, për të cilat nuk është e mundur, kanë qenë të mjaftueshme për të blerë këtë pasuri, duke kërkuar që nga Komisioni të vlerësohet se ai është në kushtet e parashikuara nga pika 2, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

56. Përpos sa më sipër, subjekti ka kërkuar që nga Komisioni të merret në konsideratë edhe vendimi nr. 19, datë 10.6.2022, i Kolegjit, ku nga shkurtimi i tij arrihet në konkluzionin se mungesa e burimeve të ligjshme financiare nga personat e tjerë të lidhur për pasuri të krijuar nga bashkëshortët, përpara martesë, nuk përbëjnë shkaqe për marrjen e masës disiplinore³⁶.

Vlerësimi i trupit gjykues

57. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur së bashku me prapësimet ka rezultuar se përgjatë periudhës 2002 – 2005, prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë realizuar të ardhura nga punësimet përkatëse në masën totale 43.798 euro, të konvertuara këto në vlerën 5.699.514 lekë, të cilat referuar të dhënave të Eurostat janë të përafërta me shpenzimet e jetesës në Greqi për të njëjtën periudhë, prej 5.578.402 lekësh. Nga sa më sipër, për prindërit e bashkëshortes së subjektit do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej 2.678.889 lekësh, për blerjen e këtij apartamenti.
58. Lidhur me pretendimin e subjektit se ai gjendet në kushtet e pamundësisë për të paraqitur një pjesë të dokumentacionit për të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes, përpara vitit 2002, trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje praktikën e mëparshme dhe për sa kohë: (i) nga subjekti nuk u paraqit ndonjë dokumentacion që të provojë se autoritetet greke janë në pamundësi për të provuar/dokumentuar të ardhurat/kontributet e realizuara/paguara nga familjarët e bashkëshortes përpara vitit 2002 apo se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri apo nuk mund të merret në rrugë tjetër; (ii) nga subjekti nuk u paraqit ndonjë dokumentacion që të provonte, së paku, ekzistencën e ndonjë marrëdhënieje punësimi të familjarëve të bashkëshortes dhe shumat e pretenduara si të fituara, përpara vitit 2002 – vlerëson se nuk janë provuar mjaftueshëm elemente që të provojnë se subjekti (apo prindërit e bashkëshortes së tij) të jenë në kushtet e pamundësisë objektive, të parashikuara në nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016.
59. Nisur nga sa më sipër, duke analizuar situatën faktiko-ligjore, për sa i takon pasurisë në analizë, trupi gjykues, për një vlerësim përfundimtar lidhur me këtë marrëdhënie juridike, mban në vëmendje këto fakte: (i) kontrata e porosisë është nënshkruar në vitin 2005 dhe pagesat ndaj palës shitëse janë kryer prej znj. L. në po këtë vit, periudhë në të cilën ajo ende nuk e gëzonte statusin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; (ii) ka ekzistuar së paku një deklaratë noteriale e mëhershme, në një periudhë përpara procesit të rivlerësimit, e lëshuar nga babai i bashkëshortes së subjektit, në vitin 2010, sipas së cilës apartamenti në analizë ka qenë një dhuratë që i është bërë vajzës së tyre, përpara martesës; (iii) nuk ka rezultuar ndonjë

³⁶Gjithashtu, subjekti, përveç vendimit nr.19/2022, përmend si referencë edhe vendimet nr. 15/2021.

kontribut financiar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie. Në këto kushte, Komisioni nuk e vlerëson proporcional penalizimin e subjektit për shkak të kësaj pasurie. Në këto kushte, Komisioni nuk e vlerëson proporcional penalizimin e subjektit për shkak të kësaj pasurie, por situata financiare në lidhje me të do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor në lidhje me kriterin e pasurisë.

60. Në konkluzion, trupi gjykues – duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e fundit të Kolegjit, (vendimi nr. 19, datë 10.6.2022, i cili ka vlerësuar se *problematikat e konstatuara lidhur me pasurinë banesë, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejtë me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit*) – arrin në përfundimin se problematikat e konstatuara lidhur me këtë pasuri në vetvete nuk janë të mjaftueshme që të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe pavarësisht kësaj situata financiare në lidhje me këtë pasuri do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor në lidhje me kriterin e pasurisë.

5.2 Automjet tip “Volkswagen Golf 5”

61. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* nga bashkëshortja e subjektit si pasuri e përfitur sipas faturës së blerjes së datës 5.3.2014, me burim nga të ardhurat personale dhe kursime ndër vite. Nga shqyrtimi i DIPP-ve të viteve 2014 e në vijim ka rezultuar se kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga bashkëshortja sa më sipër. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të bënte me dije shkakun e mosdeklarimit të kësaj pasurie, i cili në përgjigje është shprehur se: *“Mosdeklarimi ka qenë harresë dhe nuk ka pasur qëllim fshehjen e pasurisë, të ardhurat e përdorura për blerjen e saj kanë qenë me burim nga të ardhurat nga puna e bashkëshortes si notere”*.
62. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2020, ka konfirmuar pronësinë e automjetit në fjalë në emër të bashkëshortes së subjektit, si dhe ka vënë në dispozicion dosjen e automjetit, nga ku ka rezultuar se automjeti tip “Volkswagen Golf 5” është blerë nga me anë të faturës gjermane të datës 5.3.2014, kundrejt çmimit 2.000 euro, zhdoganuar kundrejt tarifës 132.155 lekë, nga ku duket se investimi total për këtë pasuri ka qenë në masën 412.375 lekë.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

63. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar burimin e kësaj pasurie nga të ardhurat personale, kursimet ndër vite, ashtu sikurse është trajtuar edhe më lart. Subjekti apo bashkëshortja nuk kanë deklaruar në ndonjë prej DIPP-ve pakësim të kursimeve të deklaruara më herët dhe referuar orientimeve të Kolegjit³⁷, si pasojë e mosdeklarimit të vetë pasurisë por edhe të burimit financiar të përdorur në DIPP-në e vitit përkatës të kryerjes së këtij investimi, Komisioni nuk ka konsideruar përdorimin e kursimeve si burim për këtë pasuri. Në këto kushte, nga Njësia e Shërbimit Ligjor është përlllogaritur për këtë pasuri mundësia e krijimit të shumës së shpenzuar deri në datën e blerjes së automjetit 5.3.2014.
64. Gjatë analizimit të kësaj periudhe ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka ushtruar aktivitetin si notere, A. S. person fizik³⁸, regjistruar në organet tatimore në datën 15.5.2012. Komisioni ka konsideruar të ardhurat e personit fizik, në mënyrë përpjesëtimore, në raport me

³⁷Vendim nr. 7/2019(JR), datë 5.4.2019.

³⁸Personi fizik A. S., me NIPT ***, ka ndryshuar objektin e aktivitetit të saj nga “ushtrim i veprimtarisë si përmbaues gjyqësor privat” në “notere”, në datën 29.7.2013.

të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2014, të cilat rezultuan në masën 491.656 lekë. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij ka rezultuar se nga llogaria e pagës së subjektit, deri në datën 13.3.2014, janë tërhequr gjithsej fondet në shumën 155.000 lekë. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve të familjes, përgjatë të njëjtës periudhë, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej 90.768 lekësh, sipas tabelës në vijim.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare për blerjen e automjetit me targa ***

Të tërhequra nga llogaria e pagës së subjektit 1.1.2014 - 13.3.2014	155,000
Të ardhura nga aktiviteti b/shortes janar - 13.3.2014	491,656
Shpenzime jetese (2 persona) janar - 13.3.2014	(133,099)
Shpenzime udhëtimi 1.1.2014 - 13.3.2014	(191,951)
Shpenzim për blerjen e mjetit ***	(280,220)
Shpenzim për zhdoganim automjeti	(132,155)
Rezultati në datë 13.3.2014	(90,768)

65. Nga sa më sipër ka rezultuar, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura për këtë pasuri:

- *Duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk e kanë deklaruar pasurinë e llojit automjet, duke mos deklaruar kështu as burimin e krijimit të pasurisë, nga DIPP-ja e vitit 2014 e në vijim deri në deklaratën Vetting.*
- *Duket se për blerjen e pasurisë në fjalë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 90.768 lekësh.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

66. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij, duke bërë me dije se mosdeklarimi në vitin 2014, të këtij automjeti ka qenë një harresë dhe nuk ka pasur qëllim fshehjen e pasurisë, si dhe të ardhurat e përdorura për blerjen e saj kanë qenë me burim nga të ardhurat nga puna e bashkëshortes si notere, me anë të të cilave ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme. Subjekti vijon se kjo pasaktësi është në fakt e pashoqëruar me pamjaftueshmëri financiare, siç do të shpjegohet më poshtë dhe, për pasojë, nuk mund të jetë shkak për marrjen e masës disiplinore.

67. Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare, fillimisht për sa i përket përlllogaritjes në mënyrë përpjesëtimore nga Komisioni, të fitimit të personit fizik të bashkëshortes së tij, por pa dhënë ndonjë vlerë konkrete. Subjekti është shprehur se mes të tjerash ka deklaruar si burim në deklaratën *Vetting* edhe kursimet ndër vite, për rrjedhojë pamundësia financiare nga analiza e kryer nga Komisioni është e pasaktë, pasi sikurse është përmendur edhe më lart, kursimet *cash* mund të pakësohen përkohësisht gjatë vitit dhe të riplotësohen deri në fund të vitit.

Vlerësimi i trupit gjykues

68. Trupi gjykues, referuar dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit, por edhe shpjegimeve të subjektit, duke mbajtur në konsideratë se: (i) përdorimi i kursimeve ishte deklaruar prej subjektit si një ndër burimet për këtë pasuri; (ii) vlera e kursimeve të deklaruara më herët prej subjektit ndër vite ishin mëse të mjaftueshme për të mbuluar vlerën e këtij automjeti; si dhe (iii) përlllogaritja e kryer nga Komisioni mbi të ardhurat e aktivitetit të

bashkëshortes së subjektit, në mënyrë përpjesëtimore nuk mund të jetë plotësisht e saktë, vlerëson se në të gjitha rastet kjo mungesë financiare relativisht e papërfillshme nuk do të impaktonte në vlerësimin final të rastit.

5.3 Depozitë në emër të personit fizik A. S., në vlerën 43.000 euro

69. Kjo depozitë është deklaruar në deklaratën *Vetting* nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit si depozitë e personit fizik, por pa përkrahur burimin e krijimit të saj. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2016, subjekti ka deklaruar çeljen e kësaj depozite në llogarinë në BKT, të krijuar nga 37.371 euro të transferuara nga llogaria personale e bashkëshortes në BKT dhe 5.197 euro, të transferuara nga llogaria e personit fizik, po në BKT. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se kjo depozitë është çelur në datën 23.12.2016, në shumën 43.000 euro.
70. Shuma prej 37.371 euro ka ardhur si pasojë e konvertimit të shumës 5.125.158 lekë, të gjendjes së disponuar më herët në llogarinë bankare në BKT të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në datën 21.12.2015. Kjo shumë prej 5.125.158 lekësh, nga shqyrtimi i llogarisë bankare, ka rezultuar të jetë formuar nga depozitimet si vijon:
- a. shuma prej 300.000 lekësh në datën 2.8.2013;
 - b. shuma prej 400.000 lekësh në datën 5.8.2013;
 - c. shuma prej 3.300.000 lekësh në datën 9.8.2013;
 - d. shuma prej 500.000 lekësh në datën 23.6.2015 (transferuar nga personi fizik);
 - e. shuma prej 865.500 lekësh në datën 26.6.2015.
71. Shuma prej 5.197 euro ka ardhur si pasojë e konvertimit të shumës 699.999 lekë, të gjendjes së disponuar në llogarinë bankare në BKT të personit fizik të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në datën 23.12.2016.

a. Analiza e burimit të krijimit të depozitimeve të vitit 2013

72. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2013 ka rezultuar se shumën 4.000.000 lekë, të depozituar në vitin 2013, subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën vjetore, por e ka deklaruar këtë shumë në DIPP-në e vitit 2015, me burim nga transferimi i llogarisë së biznesit të bashkëshortes nga veprimtaria si përmbaruese gjyqësore private dhe po në këtë vit ka deklaruar shtesat e ndodhura gjatë vitit 2015.
73. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije shkakun e mosdeklarimit të depozitës në emër të bashkëshortes në vitet 2013 dhe 2014, duke i kërkuar gjithashtu të paraqesë dokumentacionin për burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *“Depozita e ka burimin nga të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja nga aktiviteti privat si përmbaruese gjyqësore nga data 5.5.2012 deri më 26.7.2013, kur ka filluar aktivitetin si notere, ku sipas pasqyrave financiare të vitit 2012 fitimi neto është 2.104.746 lekë dhe në vitin 2013 është 2.332.834 lekë. Në datën 9.8.2013 bashkëshortja ka tërhequr shumën dhe po në datën 9.8.2013 ka derdhur në llogarinë personale duke e kaluar në depozitë me afat”*. Lidhur më arsyen e mosdeklarimit subjekti ka shpjeguar se ka qenë një harresë dhe se këtë llogari e ka deklaruar në ILDKPKI kur është pyetur në mars të vitit 2016.
74. Komisionit, nga shqyrtimi i llogarive bankare të personit fizik, i ka rezultuar se në datën 9.8.2013, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 3.300.000 lekë nga llogaria në BKT, të cilat janë depozituar në po këtë datë në llogarinë personale. Po ashtu, nga llogaria e personit fizik në “Credins Bank” ajo ka tërhequr në datën 2.8.2013 shumën 116.000 lekë, ndërsa nga

Ilogaria e personit fizik në “Tirana Bank”, ajo ka tërhequr në datën 5.8.2013, shumën 506.885 lekë dhe në këtë datë është depozituar shuma 400.000 lekë në llogarinë personale në BKT.

75. Nga sa më sipër, Komisioni vëren se së paku shuma prej 3.816.000 lekësh rrjedh nga shumat e tërhequra nga llogaritë e personit fizik, ndërkohë që për shumën e mbetur prej 184.000 lekësh nuk ka rezultuar ndonjë tërheqje tjetër. Ndonëse duket se kjo shumë rrjedh nga shumat e tërhequra nga llogaritë e personit fizik të bashkëshortes së subjektit, nga analizimi i pasqyrave financiare të depozituara pranë organeve tatimore nga personi fizik A. S., gjatë vitit 2013, shuma e të ardhurave të tërhequra nga ky aktivitet dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe që duket të kenë kaluar në ekonominë familjare, kanë qenë në masën totale 2.104.764 lekë³⁹.

Për çeljen e depozitës në analizë, bashkëshortja e subjektit ka përdorur gjithashtu edhe një shumë prej 1.895.236 lekësh nga fondet e aktivitetit, ndërkohë që nga analizimi i zërave të bilancit të viteve 2013 dhe 2014, duket se edhe fitimi i vitit 2013 është shpërndarë/tërhequr nga pronari në vitin pasardhës. Kjo shumë ka vijuar të qëndrojë në llogarinë e bashkëshortes së subjektit edhe pas këtij viti, duke mos pasur kështu mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, së paku në masën 1.895.236 lekë.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare për depozitim të shumës 4.000.000 lekë

Të ardhura nga aktiviteti b/shortes 2013	2 104 764
Investuar në depozitë me afat	(4 000 000)
Rezultati	(1 895 236)

b. Analiza e burimit të krijimit të depozitimeve të vitit 2015

76. Siç është evidentuar dhe më lart, shuma prej 4.000.000 lekësh ka qëndruar e investuar në depozitë me afat deri më 27.8.2015, si dhe është kryer depozitimi në datën 26.6.2015 i shumës 865.500 lekë dhe transferimi në datën 23.6.2015 i shumës 500.000 lekë nga llogaria e personit fizik të bashkëshortes së subjektit. Nga shqyrtimi i llogarive bankare ka rezultuar se shuma prej 865.500 lekësh është tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në po të njëjtën datë nga llogaria e kursimit në “Tirana Bank”.
77. Kjo llogari kursimi në “Tirana Bank” është çelur prej bashkëshortes së subjektit në vitin 2003 nga depozitimet përgjatë këtij viti të shumës totale prej 173.000 lekësh. Më pas, ajo është shtuar me të ardhurat nga interesat ndër vite dhe deri në fund të vitit 2010 vlera e saj ka arritur në 244.503 lekë. Në vijim, në vitin 2011, bashkëshortja e subjektit ka shtuar këtë depozitë me shumat, përkatësisht:
- 210.000 lekë në datën 1.4.2011;
 - 86.500 lekë në datën 24.6.2011;
 - 200.000 lekë në datën 29.7.2011.

³⁹Referuar pasqyrave financiare të dorëzuara pranë organeve tatimore, të ardhurat *neto* të disponueshme për t’u kaluar në ekonominë familjare gjatë vitit 2013, janë përlllogaritur duke konsideruar edhe ndryshimin në llogaritë e pagueshme, ndryshimin në llogaritë e arkëtueshme, ndryshimet në gjendjet e llogarive bankare të personit fizik, si dhe ndryshimet në makineritë dhe pajisjet/apo inventarin, nga viti 2012 deri në vitin 2013. Në përfundim të kësaj analize, duket se gjatë vitit 2013, ky aktivitet ka shpërndarë fitimin e vitit të mëparshëm. Nëpërmjet pyetësorit nr. 7, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimin të bënte me dije në lidhje me mënyrën dhe kohën kur janë arkëtuar të ardhurat e deklaruar si të paarkëtuar dhe kur janë shlyer detyrimet e deklaruar si të papaguara. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur të dhënat e përshkruara në shënimet shpjeguese të çdo bilanci të dorëzuar, duke u shprehur se këto të dhëna janë interpretuar në bazë të të dhënave dhe dokumenteve zyrtare të vetëdeklaruar pranë organeve tatimore, sipas ligjeve në fuqi.

78. Komisioni ka përllogaritur të ardhurat⁴⁰ e familjes së subjektit deri në datë 29.7.2011⁴¹, si dhe shpenzimet e kryera prej tyre përgjatë së njëjtës periudhë. Nga analiza e kryer lidhur me këto depozitime të vitit 2011 ka rezultuar se për kryerjen e tyre subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 119.794 lekësh, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare për depozitimet në llogari në vitin 2011

Të ardhura nga pagat 1.1.2011 - 29.7.2011	719 800
Të ardhura nga kthimi i garancise pasurore	200 000
Të ardhura nga pensionet janar - korrik	178 420
Të ardhura nga aktiviteti nënës janar - korrik 2011	(142 200)
Shpenzime të familjes janar - korrik 2011	(536 154)
Shtuar depozita në emër të vajzës 24.6.2011	(43 160)
Depozituar në llogarinë e kursimit TB	(496 500)
Rezultati në datë 29.7.2011	(119 794)

79. Nga sa më sipër, ka rezultuar se Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura për këtë pasuri.

- *Duket se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e viteve 2013 dhe 2014 depozitën me vlerë 4.000.000 lekë të çelur në llogarinë e saj personale në BKT dhe as burimin e krijimit të saj.*
- *Duket se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 2.015.030 lekësh, për depozitimet e kryera prej saj, të cilat më pas kanë kontribuar në krijimin e depozitës prej 43.000 euro (përkatesisht 1.895.236 lekë në vitin 2014 dhe 119.794 lekë në vitin 2011).*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

80. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në prapësimet e depozituara se mosdeklarimi i kësaj depozite në vitet 2013 dhe 2014 është një pasaktësi e ndrequr prej tij në vitin 2015 dhe gjendja e kësaj llogarie është lehtësisht e evidentueshme në bankë, duke e bërë këtë një gabim njerëzor dhe pa asnjë qëllim për t'iu shmangur kontrollit të organeve ligjzbatuese.

⁴⁰Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit, me të cilët ai ka bashkëjetuar deri në vitin 2011 dhe kanë pasur një ekonomi të përbashkët familjare. Referuar pasqyrave financiare të vitit 2011 të aktivitetit të nënës së subjektit, H. S., person fizik, ka rezultuar se gjatë këtij viti aktiviteti ka pasur fitim *neto* 59.713 lekë, detyrime 83.564 lekë e të drejta 393.058 lekë. Gjithashtu, në fund të vitit 2011, ky aktivitet ka pasur gjendje në arkën e biznesit 10.948 lekë, si dhe shpenzime amortizimi 16.958 lekë, të cilat u përfshinë në llogaritje, duke rezultuar me një humbje *neto* prej 243.771 lekësh. Komisioni ka përllogaritur pjesën takuese, në mënyrë përpjesëtimore për një periudhë 7-mujore, në raport me vlerën totale. Nisur nga fakti që personi fizik, referuar ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij, humbjet e rezultuara nga veprimtaria e mësipërme janë konsideruar të mbuluara nga ekonomia familjare.

⁴¹Brenda këtij intervali, përveç shumave të konsideruara nga Komisioni nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij, ka rezultuar edhe një tërheqje e kryer nga kjo e fundit, në shumën 200.000 lekë, në muajin qershor 2011, por burimi i tyre rrjedh nga një transferim i kryer nga Prokuroria e Rrethit Fierit në favor të bashkëshortes së subjektit, 300.000 lekë, për të cilin ishte i paqartë qëllimi. Për të qartësuar sa më sipër, Komisioni i është drejtuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4. Në përgjigje të tij, subjekti ka bërë me dije se shuma prej 300.000 lekësh i është transferuar bashkëshortes, pasi ajo e kishte vendosur si garanci pasurore për dajën e saj, z. K. B. dhe pas përfundimit të gjyqimit i është kthyer pas.

81. Ndërsa, sa i përket analizës financiare dhe konkluzioneve të Komisionit mbi të ardhurat e tërhequra nga aktiviteti i bashkëshortes gjatë vitit 2013 dhe, si rrjedhojë, edhe të pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare, subjekti është shprehur se nga lëvizjet e llogarive bankare duket qartë që depozita e kursimit në BKT, e krijuar prej bashkëshortes, ka si burim të ardhurat nga aktiviteti dhe këto të ardhura që kanë kaluar në ekonominë familjare kanë qenë më të larta, si pasojë e tërheqjes në vitin 2013, si të fitimit të vitit të mëparshëm, ashtu edhe atë të vitit 2013.
82. Konkretisht, subjekti ka bërë me dije se shumat e tërhequra nga llogaritë bankare të personit fizik gjatë vitit 2013 kanë si burim fitimin e vitit paraardhës, por edhe shumat që janë krijuar si rezultat i parapagimeve për kryerjen e veprimeve përmbarimore gjatë vitit 2013, duke bërë të disponueshme edhe këto shuma. Në mënyrë të detajuar, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2013 është tërhequr fitimi i vitit 2012, por gjatë këtij viti janë kryer gjithashtu tërheqje të fondeve që i përkasin fitimit të vitit 2013, të cilat në aktiv janë regjistruar gabimisht në zërin “kërkesa të arkëtueshme”, ndërkohë që nga analiza e pasqyrave financiare të viteve në vijim rezultoi se në këtë shumë janë përfshirë si klientët ashtu edhe tërheqjet e kryera nga bashkëshortja, që në fakt janë fitimet e vitit 2013. Më pas, në pasqyrat financiare të vitit 2014, këto tërheqje janë pasqyruar në zërin “debitorë të tjerë” duke riklasifikuar këtë zë bilanci në raport me pasqyrat financiare të vitit 2013, ku ishte paraqitur e gjithë vlera në zërin “kërkesa të arkëtueshme”. Përveç kësaj, leximit të pasqyrave financiare që tregojnë se gjatë vitit 2013 bashkëshortja nuk ka tërhequr vetëm fitimin e vitit 2012, subjekti thekson se këtë fakt e tregojnë edhe vetë tërheqjet në llogaritë bankare, çka provon dhe saktësinë e shpjegimeve të tij.
83. Subjekti ka vijuar duke shpjeguar se nga llogaritë bankare të personit fizik bashkëshortja ka tërhequr nga BKT-ja deri në datën 9.8.2013 shumën 3.991.000 lekë dhe nga llogaria pranë “Credins Bank” është tërhequr shuma 734.500 lekë, çka tregon se nga personi fizik gjatë vitit 2013 nuk është tërhequr vetëm fitimi i vitit 2012. Duke analizuar këto tërheqje dhe duke i krahasuar me pasqyrat financiare të vitit 2013, rezultoi se shuma 2.839.516 lekë e shënuar në zërin “kërkesa të arkëtueshme”, faktikisht përmban si të drejtat e personit fizik nga tërheqjet e kryera prej bashkëshortes si e vetëpunësuar ashtu edhe të drejtat nga klientët. Për rrjedhojë, subjekti ka kërkuar që në vitin 2013, të ardhurat nga aktiviteti duhet të njihen në masën 4.751.000 lekë, sa fitimi i vitit 2012 në shumën prej 2.104.764 lekësh dhe shuma e tërhequr gjatë vitit 2013 në vlerën 2.646.331 lekë, e cila është riklasifikuar si zë në bilancin e vitit 2014. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, për depozitimin e shumës 4.000.000 lekë, bashkëshortja e subjektit do të rezultonte me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.
84. Lidhur me mungesën prej 119.794 lekësh të burimeve financiare të ligjshme për depozitimet e kryera nga bashkëshortja e tij në vitin 2011, subjekti ka kundërshtuar analizën e Komisionit, duke kërkuar që të konsiderohet se ai ka pasur edhe gjendje *cash* nga viti i mëparshëm prej 500.000 lekësh me shpjegimin se deklarimi mbi shtimin/pakësimin e gjendjes *cash* bëhet për datën 31 dhjetor dhe kursimet *cash* të japin mundësinë e përdorimit gjatë vitit në një datë të caktuar.

Vlerësimi i trupit gjykues

85. Trupi gjykues, pasi administroi dhe shqyrtoi shpjegimet e subjektit, të paraqitura në Komision dhe ato të shprehura prej tij në seancën dëgjimore, vlerësoi të pranojë kërkesën e subjektit lidhur me të ardhurat e vitit 2013 dhe, rrjedhimisht, ripërlllogariti shumat e arkëtuara nga bashkëshortja e subjektit përgjatë vitit 2013, si dhe ato të tërhequra prej saj, bazuar në këtë herë në lëvizjet bankare, për sa kohë në këto të fundit ishin pasqyruar të gjitha transaksionet e

kryera nga personi fizik, në mënyrë të detajuar, të cilat rezultuan me të dhëna të ndryshme nga ato të raportuara nëpërmjet pasqyrave financiare (bilancit) të aktivitetit në fjalë – ndonëse një variant/pretendim i tillë nuk ishte dhënë/ngritur më herët në deklaratimet e subjektit dhe as në përgjigjet e tij të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

86. Nga përpunimi i të dhënave të pasqyruara në lëvizjet e llogarive bankare ka rezultuar se vetëm nga parapagimet e përfituara për shërbimet përmbartimore, gjatë vitit 2013, bashkëshortja e subjektit ka arkëtuar së paku një shumë rreth 2.400.000 lekë, e cila së bashku me fitimin e vitit të mëparshëm rreth 2.100.000 lekë, arrijnë vlerën e tërhequr nga bashkëshortja prej 4.000.000 lekësh për çeljen e depozitës bankare në analizë.
87. Nga sa më sipër, ndryshe nga sa i ishte njoftuar subjektit në rezultatet e dërguara nga Komisioni – në vijim të pranimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, si më sipër detajuar, për sa kohë ky pretendim gjen mbështetje në dokumentacionin bankar të lartpërmendur – trupi gjykues konkludon se për çeljen e depozitës në fjalë bashkëshortja e subjektit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare nga aktiviteti i vet.
88. Gjithashtu, nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të viteve të mëpasshme, ka rezultuar se në vitin 2016, zëri “debitorë të tjerë”, në të cilin subjekti ka shpjeguar e pretenduar se ishin të përfshira dhe të drejtat financiare (të pritshme) që kishte aktiviteti nga vetë pronari (bashkëshortja e subjektit), zerohet. Ky fakt tregon se në këtë vit (2016) shuma e marrë nga aktiviteti dhe e përdorur në vitin 2013 prej bashkëshortes, i është kthyer pas aktivitetit, nga bashkëshortja/familja e subjektit. Si pasojë e këtij veprimi, në vitin 2016, shuma e tërhequr prej bashkëshortes së subjektit nga të ardhurat e aktivitetit që ishte llogaritur më herët në masën 2.930.227 lekë, do të pakësohej me shumën e kthyer pas tek aktiviteti, duke zvogëluar disponibilitetin e shumës së kaluar në ekonominë familjare nga këto të ardhura, për vitin 2016, në masën 619.488 lekë – duke afektuar kështu analizën financiare të vitit 2016, i cili tashmë do të rezultonte me një balancë negative prej 2.044.199 lekësh.
89. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të theksojë se – ndryshe nga viti 2013, për të cilin u morën në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit pasi gjetën mbështetje mbi një provë alternative, konkretisht të të dhënat e detajuara, të përshkruara në lëvizjet bankare – për vitet e mëpasshme 2014 – 2016⁴², për shkak të ndryshimit të tipologjisë së aktivitetit të bashkëshortes së subjektit (nga përmbartuese në notere), transaksionet e aktivitetit nuk janë të evidentuara qartësisht dhe totalisht në lëvizjet bankare dhe, për rrjedhojë, pasqyrat financiare (bilancet e viteve përkatëse) mbeten i vetmi dokumentacion zyrtar, mbi të cilin mund të analizohet dhe konkludohet për të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortes së subjektit.
90. Për sa më lart, në konkluzion për vitin 2016 ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit në masën 2.044.199 lekë. Trupi gjykues vlerëson se pamjaftueshmëria e konstatuar më lart e burimeve të ligjshme financiare çon në deklaratim të pamjaftueshëm që kualifikohet sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke pasqyruar aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

5.4 Llogari në “ProCredit Bank” në emër të vajzës V. S.

91. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar, mes të tjerash, tri llogari të çelura në emër të vajzës së saj, V. S., në “ProCredit Bank”, përkatësisht, në shumat 353 USD, 45.761 lekë dhe 2.909 euro, me burim të deklaruar nga dhuratat *cash* për lindjen e saj. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se këto llogari janë çelur

⁴²Si pasojë e ndryshimit të llojit të aktivitetit nga “shërbimi përmbartimor” në “noteri”.

përkatësisht, në euro në vitin 2008, në lekë në vitin 2010, ndërsa në dollar amerikan në vitin 2011. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të dorëzuara ndër vite nga subjekti ka rezultuar se jo vetëm që nuk janë deklaruar llogaritë e sipërcituara, por nuk janë deklaruar as dhurimet përkatëse të përfituara në rubrikën përkatëse. Për pasojë, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë dhurimet e pretenduara, për sa kohë nuk ka ndonjë dokumentacion provues të kohës për përfitimin e tyre, si dhe nuk janë deklaruar prej subjektit në asnjë nga DIPP-të ndër vite.

92. Nga sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve për këtë pasuri për sa vijon më poshtë:

- *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e tij, ndër vite, çeljen e depozitave bankare në emër të vajzës së tij dhe as dhurimet e pretenduara, deri në deklaratën Vetting, për pasojë ato nuk janë përfshirë në analizën financiare.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

93. Subjekti është shprehur se edhe nëse nuk përfshihen shumatat e dhuruara, analiza financiare në vitet kur janë krijuar këto depozita është pozitive. Pra, në kushtet kur depozitat janë të pasqyruara dhe të evidentueshme në çdo kohë në bankë, pasaktësitë në fjalë janë të karakterit formal, për sa kohë janë deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe për krijimin e tyre nuk konstatohen pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.

Vlerësimi i trupit gjykues

94. Trupi gjykues – referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe duke analizuar dinamikën e krijimit të këtyre depozitave bankare, përfshirë këtu edhe faktin se për krijimin e tyre gjithsesi nuk kanë rezultuar pamjaftueshmëri financiare në vitin e krijimit – arrin në përfundimin se pasaktësia e konstatuar në deklaratimet vjetore në vetvete dhe për shkak të peshës relativisht të ulët që zënë këto shuma, nuk mund të përbëjë një shkak penalizues për subjektin e rivlerësimit.

5.5 Llogari të bashkëshortes si person fizik – notere

95. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar llogaritë e saj si person fizik⁴³, të ndodhura në BKT, përkatësisht në shumatat 1.503 euro dhe 187.603 lekë, ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se përveç sa më sipër, ajo ka disponuar llogari si person fizik për tjetërsimin e pasurive, në BKT, me vlerat 8.267.377 lekë dhe 25.500 euro, të cilat nuk janë deklaruar prej saj – ndonëse këto nuk përbëjnë fonde të aktivitetit në vetvete, pasi mbahen për llogari të palëve referuar ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, të ndryshuar. Këto llogari, edhe pse nuk janë deklaruar, subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëngjitur deklaratën *Vetting* lëvizjet bankare të tyre.

96. Bashkëshortja e subjektit ka pasur një llogari bankare⁴⁴ si person fizik në “Union Bank”, me gjendje në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, 50.003 lekë, e cila gjithashtu nuk është

⁴³Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka marrë më qira ambientin njësi në lagjen “***”, Fier, me sip. 35.5 m², në emër të shtetasit D. G., me afat 3 vjet, kundrejt shumës 20.000 lekë/muaj.

⁴⁴Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të personit fizik të bashkëshortes së subjektit, për vitin 2016, ka rezultuar deklarimi pranë organeve tatimore, i gjendjes së llogarive bankare në fund të vitit 2016, në shumën 2.138.830 lekë, nga ku duket se përveç llogarive të evidentuara nuk është deklaruar dhe një gjendje bankare në shumën rreth 1.607.897 lekë. Komisioni, me qëllim qartësimin e situatës së mësipërme, i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije se cilat llogari dhe cilat gjendje bankare janë përfshirë në zërin e llogarive bankare në bilancin e dorëzuar pranë organeve tatimore, që kanë përbërë gjendjen e deklaruar prej 2.138.830 lekësh. Në përgjigjet e tij në pyetësorët nr. 5 dhe 6, subjekti është shprehur se kjo është gjendja e llogarive bankare të subjektit tatimor dhe jo e individit, duke mos specifikuar, ndryshe nga sa ishte kërkuar, llogaritë konkrete të

deklaruar në këtë të fundit. Po ashtu, nga krahasimi mes llogarive individuale të rezultuara nga hetimi administrativ dhe atyre të deklaruara në deklaratën *Vetting*, nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se kjo e fundit nuk ka deklaruar ndër të tjera, edhe dy llogari personale të sajat, përkatësisht llogarinë e depozitës në shumën 750.000 lekë (çelur fillimisht në vitin 2015, e cila vazhdon të jetë ende e investuar) dhe një llogari rrjedhëse ndonëse në vlerë minimale 2.152 lekë. Këto llogari, edhe pse nuk janë deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ajo ka depozituar bashkëngjitur deklaratën *Vetting* lëvizjet bankare të tyre.

97. Lidhur me depozitën me afat prej 750.000 lekësh, të depozituar prej bashkëshortes së subjektit në datën 18.6.2015, nga analiza financiare duket se për krijimin e saj familja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare. Gjithashtu, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar në asnjë prej DIPP-ve, ndër vite, llogaritë bankare të personit fizik dhe gjendjet e tyre.

Tabela nr. 7 – Analiza financiare për depozitimin e shumës 750.000 lekë në datën 18.6.2015

Të ardhura nga shitja e automjetit ***	50,000
Të ardhura nga shitja e automjetit ***	832,251
Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2015-18.6.2015	530,000
Të ardhura nga aktiviteti b/shortes janar - qershor 2015	1,067,845
Gjendjet në llogaritë bankare 01.01.2015	5,683,162
Gjendjet në llogaritë bankare 18.6.2015 (përfshirë 750,000 Lekë)	(6,527,993)
Shpenzim për blerjen e automjetit ***	(500,000)
Shpenzime jetese (3 persona) janar - qershor 2015	(336,414)
Shpenzime udhëtimi 1.1.2015 - 18.6.2015	(93,491)
Shpenzim për siguracion automjeti	(15,350)
Rezultati në datë 18.6.2015	690,010

98. Nga sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve për këtë pasuri si vijon:

- *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2015 e në vijim, çeljen e depozitës bankare në emër të bashkëshortes së tij në shumën 750.000 lekë, depozitë kjo e cila nuk është deklaruar as në deklaratën *Vetting* – ndonëse ka qenë ende gjendje – në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016.*
- *Për depozitimin e shumës 750.000 lekë, duket se bashkëshortja e subjektit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.*
- *Duket se bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar në DIPP-të ndër vite llogaritë e personit fizik.*

Qëndrimi i subjekti të rivlerësimit

99. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dërguara, ka shpjeguar se bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar në DIPP-të ndër vite llogaritë e personit fizik, pasi ato deklarohen në pasqyrat financiare të çdo viti pranë organeve tatimore. Subjekti ka theksuar se ndonëse në deklaratën *Vetting* ka harruar deklarimin e ndonjë llogarie, i ka bashkëlidhur kësaj deklaratë lëvizjet e të

përfshira. Komisioni, në mungesë të informacionit të saktë, i ka konsideruar gjendjet e llogarive bankare në masën e deklaruar pranë organeve tatimore.

gjitha llogarive bankare, fakt i cili vërteton tej çdo dyshimi se nuk ka pasur asnjë qëllim fshehje apo mosdeklarimi të tyre.

Vlerësimi i trupit gjykues

100. Trupi gjykues, duke analizuar dhe vlerësuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit i gjen ato bindëse, ndonëse Komisioni nuk ishte shprehur për fshehje por për mosdeklarim. Gjithsesi, duke mbajtur në konsideratë faktin se: (i) nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se nuk janë deklaruar këto llogari bankare, kopje të lëvizjeve të këtyre llogarive bankare janë depozituar së bashku me deklaratën *Vetting* dhe rrethanën lehtësuese; (ii) për krijimin e tyre nuk janë konstatuar mungesa të burimeve të ligjshme financiare – nuk e çmon penalizues mosdeklarimin e këtyre llogarive.

6. Apartament banimi në Vlorë, me vlerë 40.416 euro

101. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka blerë një apartament në qytetin e Vlorës, brenda kompleksit “***”, me sip. 78.24 m² me anë të kontratës së shitblerjes⁴⁵ nr. ***, datë 18.5.2018⁴⁶, kundrejt çmimit 40.416 euro. Për këtë pasuri, nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2018, subjekti ka deklaruar si burim të krijimit përkatësisht, shumën 40.000 euro, të tërhequr nga llogaria e bashkëshortes.

102. Komisioni ka verifikuar ekzistencën e mundshme të ndonjë konflikti interesi me shoqërinë ndërtuese dhe palën shitëse, nga ku nuk ka rezultuar një gjë e tillë⁴⁷. Ndërkohë, Komisioni duke pasur parasysh specifikën e vendndodhjes gjeografike të kësaj pasurie si dhe kërkesat e tregut për banesa në vijën bregdetare, nisur edhe nga informacioni mbi vlerat aktuale të apartamenteve në atë kompleks⁴⁸, ka ngritur dyshime se çmimi i blerjes prej 40.000 euro, mund të mos përputhet me çmimin real të tregut, pasi, çmimet aktuale të tregut për apartamente në këtë zonë, arrijnë vlerën rreth 1.900 euro/m², rreth 4 herë më i lartë se ai i paguar nga subjekti.

103. Nga sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të japi shpjegime bindëse mbi sa vijon:

- *Duket se për blerjen e kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme, pasi burimi nga depozita e krijuar në vitet 2013 dhe 2014, ka rezultuar pjesërisht e pajustificuar me burime të ligjshme, në masën –2.015.030 lekë.*
- *Ngrihen dyshime se çmimi i blerjes së kësaj pasurie në vlerën 40.000 euro, mund të mos përputhet me çmimin real të tregut dhe për këtë shkak ftohet subjekti që të paraqesë disa kontrata të ngjashme të shitjeve të kryera nga e njëjta shoqëri ndërtuese, në vitin 2018, lidhur me apartamente në të njëjtin kompleks ***, Vlorë.*

⁴⁵Nga dokumentacioni i administruar, RNSH ka konfirmuar nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së apartamentit në fjalë.

⁴⁶Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se në vitin 2018, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë kryer tre investime të tjera në pasuri të paluajtshme, konkretisht: (i) pasuri e llojit “tokë arë” me sip. 1.000 m², kundrejt çmimit 209.000 lekë; (ii) pasuri e llojit “tokë arë” me sip. 1.100 m², kundrejt çmimit 400.000 lekë; dhe (iii) pasuri e llojit “tokë arë” me sip. 600 m², kundrejt çmimit 100.000 lekë. Për të tria këto pasuri subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar si burim kursimet nga paga, të ardhurat e bashkëshortes si notere për vitin 2018 si dhe 5.000 euro nga fitimi i deklaruar një vit më parë, të cilat ishin 10.000 euro *cash* në shtëpi. Referuar jurisprudencës së Kolegjtit, vendimit nr. 8/2020 (JR), duket se pasuritë në fjalë janë përfituar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* me të ardhura të realizuara e akumuluar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* dhe, për pasojë, nuk shihen arsye për kryerjen e veprimeve hetimore mbi burimin e krijimit të tyre.

⁴⁷Pala shitëse është shtetasi L. Gj., i cili si pronar trulli ka lidhur kontratën me shoqërinë ndërtuese “***”. Me shkresën nr. ***, datë 6.10.2021, Prokuroria e Rrethit Fier ka bërë me dije se subjekti nuk ka pasur çështje me asnjë prej tyre.

⁴⁸*Apartment for sale Castle - *** (invest1group.com); *** in Vlora. Furnished one bedroom for sale -Albania Real Estate – (albrealtor.com)*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

104. Subjekti i rivlerësimit, përveç shpjegimeve të dhëna, ka depozituar dy kontrata të ngjashme⁴⁹ të shitjeve të kryera nga e njëjta shoqëri ndërtuese në vitin 2018, lidhur me apartamente në të njëjtin kompleks, nga të cilat rezultojnë se çmimet e apartamenteve të shitura janë të përafërta me vlerën për metër katror të blerë dhe prej tij.

Vlerësimi i trupit gjykues

105. Trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri, vlerëson të vërë në dukje dhe të qartësojë disa rrethana faktike konkrete duke nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, shqyrtimi i kontratave të ngjashme⁵⁰, si dhe duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në analizë të rrethanave faktiko-ligjore – konkretisht: (i) edhe pse ngrihen dyshime lidhur me çmimin real të blerjes së kësaj pasurie nga subjekti, për aq kohë sa referuar kontratave të ngjashme të paraqitura çmimi i blerjes është së paku i përafërt⁵¹; (ii) për sa kohë nga hetimi administrativ nuk u provua ekzistenca e ndonjë konflikti interesi, që, veç të tjerash, mund të lidhej me ndonjë trajtim preferencial të aplikuar në favor të subjektit të rivlerësimit; (iii) duke pasur parasysh se ndryshimet e mundshme të dinamikës së tregut të lirë për shitblerjen e pasurive të paluajtshme në këtë zonë, mund të shpjegojnë diferencën aktuale me atë të vitit 2018; që kjo pasuri është realizuar në vitin 2018, pas deklarimit të deklaratës *Vetting* dhe burimet e përdorura janë analizuar më sipër (për sa kohë janë përdorur depozitat bankare), duke i prodhuar në raport me to efektet pasuese – arrin në përfundimin se nuk janë gjetur elemente të mjaftueshme, të cilat mund të çojnë në prova mbi aplikimin e ndonjë trajtimi preferencial në favor të subjektit të rivlerësimit apo çmimi fiktiv.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

106. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në tabelën që i bashkëngjitet këtij vendimi, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

107. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2005, vit në të cilin fillon edhe puna si prokuror, si dhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, në ILDKPKI, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën 2.992.305 lekë, për të cilën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve për kriterin e pasurisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

108. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendimet e tij mbi analizën financiare, të analizuara edhe në trajtimet e pasurive përkatëse, si në vijim:

- a. duhet të konsiderohen pakësimet e gjendjes *cash* në vitet 2011 dhe 2015, përkatësisht me 5.000 euro në vitin 2011 dhe 900.000 lekë në vitin 2015;

⁴⁹Kontrata e premtim shitjes nr. ***, datë 25.7.2018, për apartamentin me sipërfaqe totale 57.3 m², me vlerë 3.500.000 lekë, si dhe kontrata nr. ***, datë 25.7.2018, për apartamentin me sip. 104.16 m², me vlerë 6.500.000 lekë.

⁵⁰Këto kontrata janë nënshkruar në të njëjtën periudhë dhe për të njëjtën zonë.

⁵¹<https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/UKM-Nr.3-date-28.12.2016.pdf>

- b. analiza e personit fizik duhet kryer duke llogaritur në vitin 2013 vlerën e tërhequr nga llogaritë e personit fizik, e cila përfaqëson tërheqjen e fitimit të viteve 2012 dhe 2013, ndërsa në vitet 2014 dhe 2015 fitimi *neto* duhet përllogaritur përkatësisht 2.322.834 lekë dhe 2.025.737 lekë;
- c. në të ardhurat nga shitja e automjeteve në vitin 2015 duhen përfshirë shumat 250.000 lekë e investuar në vitin 2001 dhe 283.200 lekë e investuar në vitin 2015.

Vlerësimi i trupit gjykues

109. Në lidhje me sa më sipër është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, për analizën financiare, trupi gjykues thekson se këto pretendime janë trajtuar dhe analizuar më sipër, në pasuritë përkatëse, në përfundim të së cilave ka rezultuar një balancë e përgjithshme negative përgjatë periudhës 2005 – 2016, në masën 3.235.593 lekë, sipas detajimit në tabelën vijuese. Gjithashtu, përpos sa është përshkruar në këtë tabelë, Komisioni mban në konsideratë edhe balancën financiare negative të personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes së tij, në blerjen e apartamentit në Vlorë, në shumën prej, 2 678,889 lekësh.

Analiza financiare për periudhën 2005 – 2016

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	97,420	294,850	625,064	1,037,519	223,244	124,440	3,723,995	51,682	3,944,885	199,013	3,608,040	1,845,473
Automjet Mercedes Benz ***												
Automjet Mercedes Benz ***				492,730								
Apartament banimi dhe garazh në L. ***, Fier												
Apartament banimi L. **, Vlorë (b/sh)												
Automjet BMW seria 7, ***											500,000	
Automjet Mercedes Benz ***											1,927,100	
Automjet me targë ***										280,220		
Automjet në pronësi të babait			200,000									
Ndryshim likuiditeti	97,420	294,850	425,064	544,789	223,244	124,440	3,723,995	51,682	3,944,885	-81,207	1,180,940	1,845,473
TOTAL LIKUËDITETE DEKLARUAR	97,420	392,271	817,334	1,362,124	1,585,367	1,709,807	5,433,802	5,485,484	9,430,369	9,349,162	10,530,102	12,375,575
DETYRIME	0	0	0	0	0	82,535	-25,332	-30,892	-26,310	4,995	-4,725	0
Kredi në RZB për blerje pajisjesh						82,535	-25,332	-30,892	-26,310	4,995	-4,725	
PASURI NETO	97,420	294,850	625,064	1,037,519	223,244	41,905	3,749,326	82,574	3,971,196	194,018	3,612,765	1,845,473
Të ARDHURA dokumentuar	977,398	1,040,895	1,646,662	2,439,102	1,721,791	1,710,747	4,651,204	1,397,188	5,343,536	3,981,135	4,892,431	1,831,110
Te ardhura SR vertetur	780,228	834,522	889,766	912,840	906,879	875,074	943,493	879,337	906,176	1,493,904	1,228,632	1,209,397
Te ardhura nga shitja e automjeteve											1,382,251	
Të ardhura nga interesat bankare	7,286	3,256	3,392	6,068	7,697	20,621	38,244	46,205	21,857	49,266	145,858	2,225
Te ardhura të B/sh nga paga			514,218	249,580	537,889	544,099	541,376	471,646				
Te ardhura të B/sh nga aktiviteti									-	2,104,764	2,437,966	2,930,227
Parapagim nga aktiviteti/Kthim aktivitetit										2,310,739		(2,310,739)
Te ardhura të babait nga pensioni	92,604	98,817	116,826	124,092	134,418	143,304	149,220					
Te ardhura të nënës nga pensioni	97,280	104,300	122,460	130,110	134,908	144,396	156,642					
Te ardhura nga aktiviteti nënës				1,016,412		(16,747)	(243,771)					
Te ardhura nga kthimi i garancise pasurore											300,000	
Dhuratë nga babai							2,766,000					
SHPENZIME	344,601	477,115	632,921	1,379,958	946,757	1,441,554	1,259,232	636,261	862,512	1,441,324	2,113,705	2,029,836
Shpenzime jetese	328,671	328,671	492,354	683,100	683,100	683,100	683,100	423,072	423,072	659,994	672,828	705,276
Shpenzime zhdoganimi automjeti				339,521						132,155	397,079	
Shpenzime mjekësore pranë Spitalit Amerikan												820,300
Shpenzime mobilimi						300,000	300,000			55,900		
Shpenzime shkollimi										40,000	94,000	95,000
Shpenzime udhëtimi	15,930	148,444	140,567	343,513	249,057	137,217	250,757	178,415	408,000	511,402	635,832	378,640
Shpenzime për riparim automjeti											283,200	
Shpenzime për interesa dhe komisione kredie						6,636	14,275	8,715	2,160	7,833	66	
Shpenzime për siguracion automjeti				13,824	14,600	14,600	11,100	26,060	29,280	34,040	30,700	30,620
Shpenzim për garanci pasurore K. B.						300,000						
Cash në banesë					500,000	500,000	3,566,000	3,666,000	3,666,000	3,666,000	3,666,000	5,018,700
Gjendjet në llogaritë bankare	97,420	392,271	817,334	1,362,124	1,085,367	1,209,807	1,867,802	1,819,484	5,764,369	5,683,162	6,864,102	7,356,875
Rezultati i analizës financiare	535,376	268,930	388,677	21,625	551,790	227,288	-357,355	678,352	509,828	2,345,794	-834,039	-2,044,199
DIFERENCA E PA MBULUAR				-3,235,593								

110. Në përfundim, trupi gjykues, lidhur me kriterin e pasurisë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke mos arritur një nivel të besueshëm

në kriterin e pasurisë dhe kësisoj në këtë rast, duhet aplikuar pika 3, e nenit 61, të ligjit nr.84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

111. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë në Komisionin raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Çlirim K. Sino, me të cilin ishte konstatuar papërshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit. Në këtë raport ngrihen dyshime mbi përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të korrupsionit për shkak të funksionit, nëpërmjet favorizimit të palëve kundrejt përfitimeve financiare, si dhe për kontakte të papërshtatshme/jo rastësore me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.
112. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2021, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar pjesërisht, në datën 8.10.2021, me vendimin nr. *** të KDZH-së. Në vijim, DSIK-ja ka përcjellë në Komisionin informacion shtesë lidhur me informacione mbi raste të tjera të ngjashme me ato të bëra me dije më parë. Pasi janë administruar dhe konsultuar dokumentacioni i klasifikuar mbi të cilin ishin arritur konkluzionet e lartpërmendura dhe pasi ka zhvilluar hetime specifike mbi dosjet profesionale që mund të ndërthureshin me informacionet e klasifikuara, si dhe mbi personat me të cilët subjekti kishte pasur kontakte jo rastësore apo marrëdhënie interesi, me qëllim verifikimin e precedentëve të mundshëm penalë në ngarkim të tyre.
113. Komisioni, duke u nisur nga informacioni i dhënë në raportin e DSIK-së, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4, i ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar informacion dhe dokumentacion, si dhe duke analizuar dosjet e procedimeve penale për verifikimin e të dhënave të raportuara, lidhur me disa shtetas të cilat lidhen me kriterin e figurës.

Për këtë shkak, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2021, ku kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2021, ka bërë me dije se: *“Pas verifikimit të kryer në regjistrin e njoftimit të veprave penale në emër të shtetasve: A. dhe/ose I. Sh.; A. dhe/ose I. Sh.; A. I.; A.I.; E. D.; A. B.; S. S. nuk rezulton që në emër të tyre të jetë regjistruar ndonjë procedim penal pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, që mund të përmbushnin kriteret e përcaktuar nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Pas verifikimit të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nuk rezulton që në emër të shtetasve të sipërpërmendur të jetë regjistruar ndonjë veprë penale, ndërkohë, ndaj shtetasit E. D. kanë rezultuar disa të dhëna sipas shkresës përkatëse⁵².*

⁵²Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 12.10.2021, ku rezulton se më 3.4.2005 është regjistruar procedimi penal nr. *** , në ngarkim të shtetasve E. D. etj., dhe më 16.6.2007, në ngarkim të shtetasve E. D., etj. është vendosur dërgimi në gjyq për veprat penale të parashikuara nga nenet 78-25⁵², 333 dhe 334. Në datën 12.11.2010 është regjistruar procedimi penal nr. *** në ngarkim të shtetasit E. D. etj., për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/2/1 dhe 334 të Kodit Penal, i cili është ndarë nga procedimi nr. *** , i vitit 2008 dhe pas përfundimit është vendosur dërgimi në gjyq më 15.11.2010 në ngarkim të shtetasit E. D. për veprat e parashikuara nga nenet 283/a/2⁵² , 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal. Në datën 13.10.2009 është regjistruar procedimi penal me nr. 68, në ngarkim të shtetasit E. D. për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/1-25⁵², 78-25, 278/2, 333 dhe 334 të Kodit Penal, e pas përfundimit të hetimeve në lidhje me këtë procedim është vendosur pushimi i këtij procedimi në datën 13.7.2012.

114. Nga sa më sipër, referuar informacionit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka rezultuar se nuk janë regjistruar vepra penale në emër të shtetasve të lartpërmendur, si dhe nuk rezulton ndonjë rrethanë që të mundësojë evidentimin e ndonjë kontakti të papërshtatshëm me subjektin e rivlerësimit.
115. Ndërkohë që, nisur nga fakti i mungesës së shqyrtimit të ndonjë çështjeje hetimore, në ngarkim të shtetasit E. D., nga subjekti i rivlerësimit – sikurse konfirmohet edhe nga përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier⁵³ – Komisioni konstaton se dyshimet e ngritura mbi një influencim të mundshëm nga persona të tretë, te subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shtetas, nuk mund të konsiderohen të konfirmuara me sa disponohet.
116. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Fier fillimisht me shkresën nr. 6803 prot., datë 4.10.2021, për të informuar dhe për të vënë në dispozicion dosje hetimore përfshirë edhe vendimet përkatëse për shtetasit⁵⁴ dhe, në përgjigje të saj, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 13.10.2021, ka bërë me dije se nuk rezultojnë çështje të cilat të jenë shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit. Kjo Prokurori, në të njëjtën shkresë⁵⁵, veç të tjerash ka vënë në dispozicion edhe disa procedime penale të kërkuara nga Komisioni në kuadër të verifikimit të informacionit, sikurse trajtohen më poshtë.

a) Lidhur me çështjen me të pandehur shtetasin I. V.

117. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal me nr.***, të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit I. V. (alias B. P.), akuzuar për veprat penale “mbajtje pa leje të armës luftarake në ambient të hapur për publikun”, “kallëzim i rremë” dhe “kanosje”, të parashikuara nga nenet 278/5, 305 dhe 84 të Kodit Penal. Në datën 3.6.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 3.6.2015, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe ka vendosur masën e sigurimit “arrest me burg” për të pandehurin, masë sigurimi e cila është ekzekutuar në mungesë të tij. Nga ana e prokurorit janë kryer veprimet hetimore dhe procedurale dhe në datën 30.7.2015 është dërguar në gjykatë kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015, për veprat penale të parashikuara nga nenet 278/5, 84 dhe 305 të Kodit Penal.
118. Lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal në kohën kur është kërkuar gjykimi nga ana e subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se neni 278/5 i Kodit Penal parashikonte se: *“Mbajtja e armëve, i bombave apo minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”*. Me ndryshimin e ligjit nr. 135 të vitit 2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar⁵⁶, në nenin 17 janë parashikuar ndryshime në nenin 278 të Kodit Penal, ku pas paragrafit të parë janë shtuar edhe dy paragrafë të tjerë duke spostuar automatikisht paragrafin e pestë të nenit 278, në paragrafin e shtatë të kësaj dispozite 278/7. Këto

⁵³Referojuni shkresës kthim përgjigje nr. ***, datë 31.5.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵⁴Shtetasit: F. R.; R. K.; L. Sh., Sh. Sh.; S. Sh., A. M., Gj. M., P. T., E. L., personi fizik E. L.; A. K. Ndërsa për shtetasin E.D., referojuni shkresës kthim përgjigjeje nr. ***, datë 31.5.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵⁵Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vënë në dispozicion përveç procedimit penal nr. ***, datë 14.4.2015, edhe procedimin penal nr. ***, datë 15.1.2014, në ngarkim të shtetasit P. T., si dhe procedimin penal nr. ***, datë 14.6.2016, në ngarkim të shtetasit A. K., të cilët janë trajtuar gjerësisht në denoncimin nr. 4, pasi informacioni është kërkuar nga Komisioni në kuadër të rivlerësimit, në këndvështrimin e kriterit profesional, në kuadër të denoncimeve.

⁵⁶Ndryshimet ligjore kanë hyrë në fuqi në datën 14.1.2016.

ndryshime të nenit 278 të Kodit Penal nuk e kanë ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale ndaj të pandehurit, pasi në këtë periudhë ka qenë në fuqi dispozita penale, për të cilën është akuzuar i pandehuri. Më tej, ka qenë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë që me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, ka vendosur shfuqizimin e paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98 të vitit 2014.

119. Nga shqyrtimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier rezulton se kjo gjykatë është shprehur se meqenëse aktualisht, pas paragrafit të parë të nenit 278 janë shtuar edhe dy paragrafë me ligjin nr. 135, datë 5.12.2015 dhe dispozita e mëparshme e nenit 278/2 e Kodit Penal spostohet në paragrafin e katërt të nenit 278/4, e cila parashikon se: *“Mbajtja e armëve, bombave apo minave lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet”*. Më tej, në përfundim të hetimit dhe me dorëzimin e konkluzioneve përfundimtare prokurori ka kërkuar deklarinin fajtor për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje të armës luftarake në ambient të hapur” të parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, dispozita e mëparshme dhe në bazë të kësaj dispozite dhe nenit 49, dënimin e tij me 2 vjet burgim. Deklarimi fajtor i të pandehurit I. V. për kryerjen e veprës penale “kanosje serioze për vrasje” të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dhe të nenit 49 të po këtij Kodi, dënimin e tij me 3 muaj burgim. Deklarimi fajtor i të pandehurit I. V., për kryerjen e veprës penale “kallëzim të rremë” të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim. Në bazë të nenit 55, në bashkim dënimesh, t’i jepet një dënim prej 2 vjet e gjashtë muaj burgim dhe në bazë të nenit 406 të Kodit Penal, sugjerimin gjykatës që në masën e dënimit uljen e dënimit më 1/3 duke e dënuar me 20 muaj burg.

120. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në vendimin nr. ***, datë 10.3.2016, ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit I. V. për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit’”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal në bazë të këtij neni dënimin e tij me 5 vjet burg, vendim i cili ka marrë formë të prerë më 22.3.2016. Nga sa është përshkruar më sipër, nga Komisioni konstatohet se nisur nga fakti që ligji i aplikueshëm në rastin konkret ishte modifikuar (bazuar në nenin 3 të Kodit Penal paragrafi i tretë⁵⁷) – ndonëse ligji i kohës së kryerjes së kësaj veprë penale parashikonte një dënim nga 7 – 15 vjet, konkretisht masa e dënimit për këtë veprë penale është ndryshuar në një marzh dënimi *nga gjobë deri në 7 vjet burg*. Për rrjedhojë, në zbatim të parimit *favor rei*, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për një dënim në masën 2-vjeçare, ka qenë brenda marzheve të parashikuara nga dispozitat përkatëse, ndonëse gjykata e ka dhënë një dënim më të rëndë me 5 vjet burg, duke mbetur kështu në autoritetin diskrecional të gjykatës caktimi i masës konkrete të dënimit. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë shpjegimet bindëse, lidhur me shkaqet e diferencës së dukshme midis dënimit të kërkuar nga subjekti në këtë çështje dhe atij të aplikuar nga gjykata.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

121. Në prapësimet e depozituara lidhur me këtë çështje penale subjekti ka sqaruar se, nga ana e tij i është kërkuar gjykatës që të ketë parasysh edhe rrethana të tjera në bazë të nenit 49, siç kanë qenë ajo shëndetësore sepse, ka rezultuar sipas dokumenteve të administruara në gjykim se, shtetasi I. V. vuante nga sëmundja kronike e diabetit dhe kishte një dëmtim në kafkën e kokës një pjesë e kishte plastike. Gjithashtu, nga ana e prokurorit nuk është mbajtur në

⁵⁷Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

konsideratë rrethana e dorëzimit, sepse kjo rrethane do të çmohej e tillë, vetëm në rastet e dorëzimit sipas parashikimeve të nenit 48, germa “dh” e Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se, lehtësojnë dënimin rrethanat *kur personi paraqitet ne organet kompetente pas kryerjes së veprës penale*. Në rastin konkret, shtetasi I. V. nuk është paraqitur në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale por, është paraqitur vetëm gjatë gjykimit të çështjes.

122. Në lidhje me diferencën e masës së dënimit të dhënë nga gjykata në 5 vjet burgim ndërkohë që prokurori ka kërkuar 2 vjet burgim, kjo diferencë është bërë sepse gjykata ka aplikuar një masë dënimi më të rëndë ndaj shtetasit I. V., duke e rënduar pozitën e tij, por, rëndimi i pozitës së të pandehurit nuk ka qenë shkak për ushtrimin e ankimit nga prokurori, por ky shtetas është pajtuar me qëndrimin e gjykatës, duke mos ushtruar ankim dhe duke marrë vendimi formë të prerë, pa u ankimuar.

Vlerësimi i trupit gjykues

123. Trupi gjykues, nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje penale të vlerësuar në kuadër të figurës, për sa i takon kërkesës drejtuar gjykatës për aplikimin e rrethanave lehtësuese, por edhe mbi marrjen në konsideratë të rrethanës së vetëdorëzimit i gjen shpjegimet e subjektit bindëse, për aq kohë sa provohet se rrethanat konkrete përputhen me situatën faktike të çështjes penale të lartpërmendur, sikurse përshkruhet edhe në vendimin e gjykatës. Ndërsa për sa i përket diferencës së masës së dënimit të dhënë nga gjykata në 5 vjet burgim dhe asaj të kërkuar nga prokurori me 2 vjet burgim, trupi gjykues vlerëson se kjo masë dënimi është kërkuar në zbatim të parimit *favor rei* dhe se si e tillë ka qenë brenda marzhit të masës së dënimit të përcaktuar nga ligji për veprën penale përkatëse, për sa kohë përcaktimi i masës së dënimit mbetet në autoritetin diskrecional të vendimmarrjes së gjykatës.

124. Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar përgjithësisht bindëse, kështu, Komisioni nuk ka evidentuar ndonjë shkelje konkrete apo favorizim të kryer nga subjekti i rivlerësimit qoftë edhe në përcaktimin e masës së dënimit, për sa kohë kjo masë dënimi e kërkuar prej tij është në zbatim të parimit *favor rei*, duke qenë brenda marzhit të masës së dënimit të përcaktuar nga ligji.

b) Lidhur me dosjen penale me të pandehur shtetasin F. R.

125. Komisioni iu ridrejtoja përsëri⁵⁸ Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duke i rikërkuar informacion dhe dokumentacion me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2021, kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2021, veç të tjerash ka vënë në dispozicion edhe dokumentacionin e kërkuar më parë si informacion nga Komisioni, ku nga shqyrtimi i dosjes rezulton si vijon:

126. Në datën 22.5.2014, shtetasi F. R. është marrë i pandehur për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të rendit publik”, duke regjistruar procedimin penal nr. ***, për ndjekjen e të cilit është ngarkuar subjekti i rivlerësimit, i cili pasi është njohur me aktet e procedimit penal datë 23.5.2014, brenda 48 orëve nga arrestimi në flagrancë i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të arrestuarit F. R., duke parashtruar në kërkesën e tij se ndaj të arrestuarit plotësohen kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 24.5.2014, ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur

⁵⁸Në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 4.10.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 13.10.2021, kishte informuar se nuk rezulton çështje e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit me këtë shtetas.

caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Nga shqyrtimi i praktikës ka rezultuar se më tej, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 30.6.2014, ka zëvendësuar prokurorin Çlirim Sino për shkak të transferimit të tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me prokurorin G. M., i cili ka vijuar më tej hetimet e kësaj çështjeje penale⁵⁹.

127. Nga sa më sipër është evidentuar, por edhe nga sa disponohet nga dokumentacioni në dispozicion, rezulton se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo ligjore, për sa i takon veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk konfirmohen dyshimet për veprime hetimore apo shkelje procedurale, që mund të favorizonin personin nën hetim, së paku deri në datën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë i ngarkuar për ndjekjen e kësaj çështjeje penale.

c) Lidhur me procedime penale të mundshme në emër të shtetasit R. K.⁶⁰

128. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2021, ka bërë me dije se për sa i përket vendimit të kërkuar në emër të shtetasit (vendim i datës 28.2.2006) ka sqaruar se nuk ka asnjë vendim apo procedim penal me këtë emër dhe sa nga verifikimi ka rezultuar se në datën 28.2.2006 është dhënë vendimi nr. *** që i përket shtetasit Sh. F., ku Prokuroria është përfaqësuar në gjykim nga prokurori N. Sh. Nga shqyrtimi i praktikës së lartpërmendur ka rezultuar se ky procedim penal nuk është ndjekur nga prokurori Çlirim Sino dhe, për rrjedhojë, me sa disponohet nga Komisioni nuk mund të konfirmohen dyshimet e ngritura lidhur me çështjen në ngarkim të këtij shtetasi.

d) Lidhur me dosjen e procedimit penal ndaj shtetasit E. F.

129. Gjithashtu, Komisioni, pasi u vu në dijeni me shkresën e DSIK-së së datës 10.11.2021, mbi një informacion të ri të klasifikuar u rikrye një tjetër akses në dokumentet e klasifikuara pranë organit ligjzbatues, nga ku u morën të dhëna konkrete lidhur me të cilat u verifikua përputhshmëria ose jo e tyre me rrethana e fakte që rezultojnë në dosjet profesionale.

130. Për të mundësuar këtë vlerësim, Komisioni iu drejtua përsëri Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2021, duke i kërkuar të gjitha aktet dhe vendimet e Gjykatës lidhur me masën/at e sigurisë për shtetasin nën hetim E. F. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2021, vuri në dispozicion dosjen e procedimit penal nr. ***, të vitit 2020, me të hetuar shtetasin E. F., duke informuar gjithashtu se kjo dosje në momentin e dërgimit ka qenë në gjykim në seancë paraprake. Pasi u administrua materiali i procedimit penal rezultoi se prokurori Çlirim Sino, pas regjistrimit të emrit të personave në regjistrin e veprave penale, në ngarkim të shtetasve A. T. dhe E. F. për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” ka kryer disa veprime procedurale, duke marrë edhe vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve më shumë se një herë për një periudhë 3-mujore, nga ku së paku, në vendimin e fundit të marrë prej tij për zgjatjen e afatit. Ai ka argumentuar se hetimet kanë qenë në vijimësi, për sa i takon kryerjes së veprimeve procedurale në ngarkim të personit nën hetim, të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e akuzës dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve sipas parashikimeve të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁹Duke depozituar më pas kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, me të pandehur shtetasin F. R., për veprën penale të parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal pas mbërritjes së akteksptimit, cilësimi i veprës penale është ndryshuar nga neni 236/1 në 236/2, “kundërshtimi i punonjësit të rendit publik, duke ushtruar dhunë”. Gjithashtu, konstatohet se në dosje rezultojnë të jetë një kërkesë për informacion e datës 16.6.2014 drejtuar Komisarit të Policisë Mallakastër nga subjekti i rivlerësimit, në të cilin kërkohet nga prokuroria vënia në dispozicion e akteksptimit të mjekut ligjor sipas vendimit të datës 21.5.2014.

⁶⁰R. K./K.

131. Nga shqyrtimi i dosjes penale ka rezultuar se pas kryerjes së hetimeve subjekti i rivlerësimit ka dërguar në gjykatë kërkesën për vleftësimin e ndalimit të shtetasve dhe caktimin e masës së sigurimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 11.12.2020, ka pranuar kërkesën e prokurorit për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasës A. T. dhe caktimin ndaj saj të masës “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj personit në hetim E. F. “detyrim për paraqitje”^[1], pasi bazuar në aktekspertizën mjeko - ligjore ishte konstatuar se në përmbajtje të materialit të urinës së marrë nga ky i fundit, janë gjetur gjurmë të lëndës narkotike kokainë.
132. Lidhur me masën e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” për shtetasin E. F. subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se kjo masë vlerësimi është e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit personal që duhet marrë në këtë rast, masë e cila është në raport me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikon ligji për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në kërkesën e datës 10.12.2020, “Për vleftësimin e arrestit në flagrancë, dhe caktimin e masës së sigurimit”, subjekti ka marrë në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës penale, faktin që në banesën e tij nuk është gjetur lëndë narkotike, pretendimet e tij duke mohuar se i ka shitur lëndë narkotike shtetasës A. T. dhe se i vetmi dyshim në ngarkim të tij janë pretendimet e kësaj të fundit. Në vijim, organi i Prokurorisë, në datën 20.9.2021, ka marrë vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës shtetasës A. T.”, ndërsa lidhur me personin nën hetim E. F. është shprehur në këtë vendim se për sa kohë nuk provohet me asnjë provë që ky shtetas t’i ketë shitur shtetasës A. F. sasinë e lëndës narkotike, i vetmi dyshim ndaj këtij shtetasi ka qenë deklarimi i tij si person nën hetim i shtetasës A. F. Por, gjatë ballafaqimit² kjo shtetase ka deklaruar se nuk ka qenë shtetasi E. F. i pranishëm në ballafaqim personi që i ka shitur lëndën narkotike. Më tej, në datën 7.10.2021 prokurori, pas zgjatjes së afatit të hetimit, ka dërguar kërkesën për gjyq në ngarkim të shtetasës A. T., si dhe ka vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit E. F.
133. Nga shqyrtimi i fashikullit penal duket se në të nuk rezulton të jetë pjesë e dosjes dokumenti që provon njoftimin e vendimit të datës 9.9.2021, për zgjatjen e afatit të hetimeve njoftuar palëve, bazuar në pikën 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni ka arritur në përfundimin se janë të paqarta, se çfarë veprimesh procedurale dhe hetime të tjera janë kryer nga organi i akuzës, pas zgjatjes së afatit të hetimeve datë 9.9.2021, për sa kohë rezulton nga fashikulli penal se të gjitha veprimet hetimore ishin kryer më herët. Gjithashtu, duken jo të argumentuara prej tij arsyet e zgjatjes së afatit të hetimeve, për sa kohë këto veprime hetimore nuk duket se ishin komplekse për t’i përfunduar brenda afatit të përcaktuar, sikurse parashikon pika 2 e nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale. Nga sa më sipër, përpos paqartësive lidhur me shkaqet e zgjatjes së afateve kohore për hetimin në fjalë, nuk evidentohen shkelje apo problematika konkrete që të ngrenë dyshime lidhur me veprime të subjektit, për favorizim të personave nën hetim, e në përfundim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me shkaqet e zgjatjes së hetimit të këtij procedimi penal.

^[1]Për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vlerësuar se kanë ekzistuar dyshime të arsyeshme të bazuara në prova në lidhje me ekzistencën e veprës penale, duke arritur në përfundimin se personi nën hetim E. F., për të gjitha kushtet dhe kriteret që parashikon ligji ka nevojë të sigurohet dhe se ndaj tij të merret masa e sigurimit, në raport me kushtet dhe rrethanat siç janë moshja, personaliteti, si dhe fakti se nuk ka qenë më parë i dënuar, si dhe gjendjen familjare si i martuar, duke konsideruar të drejtë si masë sigurimi “detyrim paraqitje”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

134. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e dërguara ka shpjeguar se: *“Në lidhje me zgjatjen e afatit hetimor të datës 9.9.2021, në çështjen penale në ngarkim të të pandehurës A. T. i dhe shtetasit E. F. sqaroj se kjo zgjatje afati është bërë në datën 9.9.2021 për faktin se duhej të merrej e pandehur shtetasja siç edhe është marrë dhe duhej që t’i komunikohet akuza dhe të pyetjet si e pandehur duke u njohur gjithashtu, me aktet e procedimit penal. Në vendimin e zgjatjes së afatit hetimor të datës 9.9.2021 ka një ndryshim thelbësor nga vendimi i datës 9.6.2021 për zgjatjen e afatit hetimor sepse në vendimin për zgjatjen e afatit të datës 9.9.2021 është arsytuar se duhet të respektohen të drejtat e palëve sipas parashikimeve të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale i cili parashikon se: ‘I pandehuri njoftohet gjithashtu, se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t’i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklaramë apo të kërkojë të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij’.*
135. *Me aktinjoftimin ‘Për përfundimin e hetimeve paraprake’ e datës 20.9.2021 është njoftuar e pandehura A. T. për përfundimin e hetimeve paraprake në ngarkim të saj duke iu komunikuar akuza përkatëse e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe në datën 26.9.2021 është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore si e pandehur në prani të mbrojtësit dhe po në këtë datë 26.9.2021 i është njoftuar përfundimi i hetimeve sipas shënimit të bërë në faqen e katërt të këtij njoftimi. Në këtë datë (26.9.2021) e pandehura A. T. është njohur me të gjitha aktet e procedimit penal, si dhe me vendimin për zgjatjen e afatit hetimor të datës 9.9.2021, ndaj nuk i është komunikuar me shkresë përcjellëse me shërbimin postar si herën e parë, pra është njohur me aktet në zyrën e oficerit të policisë gjyqësore.*
136. *Referuar pikës 4, të nenit 327, të Kodit të Procedurës Penale, pas datës 26.9.2021, e pandehura kishte 10 ditë kohë për të paraqitur memorie dhe dokumente për shqyrtim dhe se zgjatja e afatit hetimor të datës 9.9.2021 ka qenë një detyrim procedural për të garantuar të drejtat procedurale të të pandehurës pasi një mosrespektim i kësaj të drejte të parashikuar në rregullimet e nenit 327/4 të Kodit të Procedurës Penale do të përbënte shkak për pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e parashikuar nga pika 2, e nenit 331, të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet shprehimisht se kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është e pavlefshme kur nuk respektohen përcaktimet e paragrafëve 2,3 dhe 4 të nenit 327 të këtij Kodi. Pra, si përfundim, sqaroj se vendimi i datës 9.9.2021 për zgjatjen e afatit hetimor të procedimit penal në ngarkim të shtetases ka qenë tërësisht i mbështetur në ligj, madje detyrim ligjor”.*

Vlerësimi i trupit gjykues në lidhje me rivlerësimin e figurës

137. Nisur nga sa më lartpërkthuar, trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer nga Komisioni: (i) nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave në këtë deklaratë nga subjekti i rivlerësimit; (ii) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe pas analizimit në kuadër të figurës së çështjeve të trajtuara si më lartarsytuar; (iii) përpos dyshimeve nuk rezultoi e provuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime që bien në kundërshtim me ligjin procedural dhe material apo ndonjë tjetër shkelje nëpërmjet të cilave të ishin favorizuar palët apo individë të caktuar; (iv) nuk u provua nga Komisioni ndonjë veprim i paplotë apo mosveprim favorizues nga subjekti, në kuadër të kryerjes së profesionit, në ndonjë nga çështjet penale të hetuara prej tij, përkundërt përfitimeve personale, sikurse ishin ngritur dyshime nga organet ligjzbatuese.

138. Gjithashtu, ndonëse nga Komisioni janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore lidhur me *indiciet*, informacionet apo dyshimet e ndryshme, në konkludimin e hetimit administrativ, nuk kanë rezultuar prova konkrete përtej çdo dyshimi të arsyeshëm mbi ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit me individë me precedentë penalë të cilësuar si të përfshirë në gamën e krimit të organizuar, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10191, datë 3.12.2009, në mënyrë të tillë që të provoheshin lidhjet/kontaktet e subjektit për ndikueshmëri në sistemin gjyqësor ose veprime/mosveprime favorizuese nga subjekti, apo në veprime korruptive që mund të provonin papërshtatshmërinë e subjektit ose cenimin e pastërtisë së figurës së magjistratit.
139. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se nuk arrihet të provohen dyshimet e ngritura nga organet ligjzbatuese, për aq kohë sa nuk mund të provohen faktet/rrethanat konkrete të dyshuara, të cilat do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, vetëm nëse do të rezultonin të provuara nga Komisioni. Për rrjedhojë, në këto kushte, nuk mund të aplikohet ndonjë masë penalizuese ndaj subjektit, brenda përcaktimeve ligjore të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e figurës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLP-ja

140. KLP-ja ka përcjellë në Komision shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2021, raportin e përpiluar nga ky institucion për analizimin e aftësive profesionale, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Çlirim Sino. Në raportin e KLP-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së.
141. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit – gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, konkretisht: kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015; vendim pushimi datë 19.5.2015, në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2015; dhe konkluzion përfundimtar datë 24.11.2014, për procedimin penal nr. ***, ku nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti konstatohen këto gjetje:
142. **Dokumenti 1** – “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. 1395 të vitit 2015”, me të pandehur V. D., A. D. dhe K. Dh., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “kultivim i bimëve narkotike kryer në bashkëpunim” dhe “mbajtje pa leje të armës së gjahut”, ku prokurori Çlirim Sino ka marrë vendim për dërgimin e çështjes në gjyq. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2016, i ka deklaruar fajtorë të tre të pandehurit sipas akuzave të ngritura nga prokurori.
143. **Dokumenti 2** – vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 19.5.2015, për procedimin penal nr. *** të vitit 2015, regjistruar për veprën penale “goditje për shkak të detyrës” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 237-25 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasve J. K., Y. K., F. D. dhe A. D. Në përfundim, prokurori, pasi ka vlerësuar se veprimet hetimore ishin të plota, ka vendosur pushimin e çështjes penale, duke argumentuar se nuk është konsumuar

asnjë vepër penale e cila ndiqet me ankim të drejtpërdrejtë apo kryesisht nga prokurori. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale.

144. **Dokumenti 3** – “Konkluzion përfundimtar”. Pas deklarimit të mbyllur të hetimit gjyqësor, në mbështetje të nenit 378 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur konkluzionet përfundimtare, ku ka kërkuar deklarimin fajtor të tyre. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2014, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve sipas konkluzioneve të paraqitura nga prokurori. Konstatohet se nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Apelit Vlorë, kjo e fundit, me çështjen nr. ***, datë 22.6.2015, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 19.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në lidhje me masën e dënimit për të pandehurit⁶¹”.

Nga shorti i hedhur rezulton se u përzgjedhën në mënyrë rastësore pesë dosje, një që i përket llojit të aktit “vendim mosfillimi”, dy dosje që i përkasin llojit të aktit “vendim pushimi” dhe dy dosje që i përkasin llojit të aktit “kërkesë për gjykim”. Gjetjet nga vëzhgimi/shqyrtimi i këtyre 5 (pesë) dosjeve përshkruhen si më poshtë vijon:

145. **Dosja 1** – kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 14.2.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”. Pas administrimit të materialit kallëzues sa më sipër nga ana e prokurorit është vlerësuar se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit. Për sa më lart, prokurori, duke u bazuar në nenin 290.1, germa “ç”, nenet 291 dhe 217, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”. Nga shkresa nr. *** prot., datë 18.1.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se nuk ka pasur ankim për vendimin e mosfillimit.

146. **Dosja 2** – procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 25.4.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, vendim “Për pushimin e procedimit penal”. Pas regjistrimit si procedim penal prokurori ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore dhe në përfundim ka çmuar se, meqenëse del qartë se fakti nuk ekziston dhe ndjekja penale nuk mund të vazhdojë, ky procedim duhet pushuar, duke përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”. Me shkresën nr. ***prot., datë 28.12.2015, vendimi i është njoftuar personave nën hetim⁶². Nga shkresa nr. *** prot., datë 18.1.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se nuk ka pasur ankim për vendimin e pushimit.

147. **Dosja 3** – procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 6.10.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Prokurori Çlirim Sino, në analizën e tij, konkludon se shtetasi H. G. ka konsumuar veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, prokurori, pasi ka vlerësuar se veprimet hetimore ishin të plota, ka vendosur pushimin e çështjes penale. Nga shkresa nr. *** prot., datë 18.1.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se nuk ka pasur ankim për vendimin e pushimit.

148. **Dosja 4** – procedimi penal nr. ***, datë 25.7.2013, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Prokurori, në çmim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen

⁶¹“Dënimin e të pandehurit A. B. me 2 vjet burgim; dënimin e të pandehurit K. G. me 2 vjet burgim; dënimin e të pandehurit I. (E.) Sh. me 2 vjet burgim.

⁶²Konstatohet se nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim pushimi ka kaluar një kohë e gjatë, 1 vit 7 muaj e 22 ditë. Konstatohet se prokurori Çlirim Sino, me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, në datën 14.4.2015 i është ngarkuar drejtimi i hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2014.

“Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Nga konkluzionet konstatohet se prokurori i ka kërkuar gjykatës “Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.N.”, në zbatim të ligjit nr. 22, datë 10.3.2014, “Për dhënie amnistie”. Sa rezulton, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 23.4.2014, ka vendosur “Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. N.” akuzuar për veprën penale “vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal për shkak të zbatimit të ligjit nr. 22, datë 10.3.2014, “Për dhënie amnistie”. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 12.6.2014.

149. **Dosja 5** – procedimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 19.12.2013, për veprën penale “drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, për të cilin është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2013. Prokurori, në çmim të të dhënave të grumbulluara bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Nga sa rezulton, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 3.3.2014, ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit M. M për kryerjen e veprës penale ‘drejtim automjeti në mënyrë të parregullt’”. Me shkresën nr. *** prot., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka bërë me dije se ndaj vendimit nuk ka pasur ankim.

C/2. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

150. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se prokurori Çlirim Sino nuk ka pasur masa disiplinore, si dhe nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe ndaj tij nuk ka pasur materiale hetimore të regjistruara, procedime penale të pushuara apo të pezulluara.
151. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse të Këshillit të Lartë të Prokurorisë u administruan të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe Urdhrit nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve” dhe konkretisht nga viti 2012 deri në vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”. Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020, rezulton se ka tri ankesa, sa më poshtë përshkruhen:
152. **Praktika nr. *** e vitit 2016**, regjistruar pas ankesës së shtetasit S. A., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Në ankesën e tij evidentohet se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier prej 1 viti zhvillohej procesi gjyqësor me të pandehur 5 punonjës të OSHEE-së, akuzuar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”. Ankuesi, i cili është njëri prej të pandehurve, pretendon se prokurori i çështjes Çlirim Sino është shtyrë nga hakmarrja kur ka dërguar para gjykatës të pandehurit. Pretendimin e tij ankuesi e mbështet në faktin se grupi i tyre i punës, në funksion të detyrës, kanë denoncuar një episod të kundërligjshëm në të cilin ka qenë përfshirë shtetasi H. S., xhaxhai i prokurorit. Në këto rrethana ankuesi paraqet kërkesën që të verifikohet praktika e ndjekur nga prokurori për rastin konkret. Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr. ***, prot, datë 2.12.2016, drejtuar shtetasit S. A., ka bërë me dije ndryshimet kushtetuese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar, Komisionit i ka rezultuar se kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. ***, datë 30.9.2015, për të pandehurit S. A. etj.,

është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nga prokurorja E. Sh., në këtë kontekst, nuk vërtetohen pretendimet e ankuesit.

153. **Praktika nr. *** e vitit 2019**, regjistruar pas ankesës së shtetasit B. B. drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ndaj prokurorit Çlirim Sino, duke paraqitur një kërkesë me objekt “zëvendësimin e prokurorit Çlirim Sino me një prokuror tjetër”. Në kërkesën e tij me objekt “zëvendësimin e prokurorit”, shtetasi B. B. pretendon se ekzistonin elementet e cenimit të rëndë të besimit për një hetim të paanshëm dhe objektiv nga ana e prokurorit. Këtë pretendim ky shtetas e mbështet në faktin se ndaj këtij prokurori ka bërë kallëzim penal. Pasi kërkesa është administruar nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton se ajo është arkivuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar ka rezultuar se në datën 21.6.2018 subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për “Mosfillimin e kallëzimit për veprën penale ‘shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor’”, cili është ankimuar nga shtetasi B. B. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka pranuar kërkesën e këtij shtetasi, vendim ky i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë. Me tej, prokurori në datën 28.3.2019 ka regjistruar veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”. Ky shtetas ka kallëzuar subjektin e rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyrë”, për të cilën në datën 2.7.2019 është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”. Ankuesi është njohur me vendimin me shkresën nr. ***, datë 26.7.2019.

154. **Praktika nr. *** e vitit 2018**, regjistruar pas ankesës së shtetasit T. B. drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ndaj prokurorit Çlirim Sino. Ky shtetas në ankesën e tij evidenton se në datën 31.8.2017, në aksin rrugor Lushnjë - Fier, si pasojë e një aksidenti rrugor ka humbur jetën djali i tij E. B. Çështja në fjalë iu ngarkua prokurorit Çlirim Sino. Ankuesi pretendon se si pasojë e hetimeve të paplota, të manipuluar dhe në kundërshtim me ligjin procedural penal nga ana e prokurorit është vendosur pushimi i procedimit penal, duke e zhveshur nga përgjegjësia penale shkaktarin e ngjarjes. Ankuesi rendit një sërë rrethanash mbi të cilat mbështet pretendimet, të tilla si: këqyrja e gabuar e vendit të ngjarjes, duke sjellë për pasojë fshehjen e faktit të ndodhur; marrjen në kundërshtim me ligjin procedural penal të provave; ekspertimi auto - teknik konkluzioni i të cilit bie ndesh me ngjarjen e ndodhur⁶³. Ankesa në fjalë është marrë në shqyrtim nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 16.1.2019, drejtuar këtij shtetasi ka bërë me dije ndryshimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit, në rezultatet e hetimit të dërguara, të japë shpjegime për sa më sipër është përshkruar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

155. Subjekti, në prapësimet e dërguara, ka shpjeguar se: *“Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve i datës 1.12.2017 është i mbështetur në ligj dhe argumentuar në fund të faqes 2 dhe fillim të faqes 3, se duhet të grumbullohen prova të domosdoshme të cilat kanë të bëjnë me rrethanat e aksidentit dhe kohën e saktë kur ka ndodhur. Referuar njoftimit të dhënë në sallën operative që në momentet e para, prokurori ka identifikuar numrat e telefonave celularë të personave që kanë njoftuar për këtë aksident. Më konkretisht, pasi është*

⁶³Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti në datën 1.12.2017, pasi i ka bërë të njohur aktin e ekspertimit auto - teknik trashëgimtarëve të viktimës, ka marrë vendimin për zgjatjen e afateve të hetimeve, me qëllim grumbullimin e të gjitha provave që kanë pasur të bëjnë me rrethanat e aksidentit, si dhe rikryerjen e një akti të ri ekspertimi. Me tej, shtetasi T.B., nëpërmjet një memoje, ka kërkuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier kryerjen e një akteksptertimi, duke propozuar edhe emrat përkatës dhe, ndër të tjera, edhe dorëheqjen e subjektit nga hetimi i çështjes.

identifikuar në kompanitë celulare njëri prej telefonuesve, është thirrur dhe është pyetur shtetasi A. G. nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 14.12.2017, pra, pas zgjatjes së afatit hetimor të datës 1.12.2017, i cili ka dhënë deklaratime në lidhje me orën e aksidentit.

156. Së dyti, vijon subjekti në lidhje me memoriet e shtetasit T. B. për propozimin e emrave të ekspertëve, kërkesa e tij ka qenë e pambështetur në ligj pasi, në nenin 179.3 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar se vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, etj. Së treti, prej shtetasit T. B. është pretenduar se ishte manipuluar vendi i ngjarjes. Prej shtetasit T. B. është pretenduar për një targë për të cilën pretendonte se ishte manipuluar nga policia gjyqësore, por në fakt u provua e kundërta sepse me vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier shtetasi T. B. është dënuar për veprën penale 'kallëzim i rremë', parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal me 4 muaj burgim. Së katërti, ashtu siç është orientuar nga Prokuroria e Përgjithshme Tiranë, ankuesi T. B. me ndryshimet ligjore duhet t'i drejtohej gjykatës, nga ku rezulton se çështja u shqyrtua në gjykatë dhe me vendimin nr. ***, datë 25.9.2018, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2017”.

157. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur si prova të reja: vendimin e datës 1.12.2017, për zgjatjen e afatit hetimor; procesverbalin mbi marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale; vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për deklarimin fajtor të të pandehurit T. B.; vendimin nr. ***, datë 12.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; si dhe vendimin nr. ***, datë 25.9.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Vlerësimi i trupit gjykues

158. Nga analizimi i shpjegimeve të dhëna, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar lidhur me këtë çështje, Komisioni arrin në përfundimin se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe shteruese, për sa kohë edhe kërkesa e tij për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 1.9.2017, pas ankimimit, është gjetur/vlerësuar e drejtë edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 25.9.2018, ka pushuar çështjen penale nr. ***, duke konfirmuar kështu kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal.

Lidhur me disa ankesa të tjera

159. Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., hyrës në KLP me nr. *** prot., datë 1.2.2021, ka bërë me dije se për subjektin e rivlerësimit Çlirim Sino rezulton të jetë regjistruar një procedim penal dhe dy kallëzime të kryera nga shtetasi, si më poshtë vijon:

160. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë në datën 28.9.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 që Kodit Penal, pas kallëzimit të bërë nga shtetasi L. B., babai i V. B. (2-vjeçar)⁶⁴ ka humbur jetën në një aksident rrugor, i cili pretendon se nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve prokurori i çështjes Çlirim Sino ka shpërdoruar detyrën. Pas veprimesh hetimore të realizuara nga ana e prokurorit është vendosur pushimi i çështjes penale. Pas regjistrimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2018, prokurori i çështjes së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, mbështetur në veprimet paraprake, ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Në këto rrethana, prokurori në datën 31.3.2020 i është drejtuar përsëri gjykatës me

⁶⁴Konkretisht, në datën 19.6.2012 në fshatin ***, Fier, një automjet ka aksidentuar të miturin V. B., duke i shkaktuar vdekjen. Me drejtimin e hetimeve në këtë rast ka qenë ngarkuar prokurori Çlirim Sino.

kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2018, sipas germës “b” të nenit 328 dhe nenit 329/a të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. ***, datë 24.6.2020, ka vendosur “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë”. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga pala, në këtë rast, shtetasi L. B.

161. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në datën 20.1.2014, ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** pas kallëzimit të bërë nga shtetasi A. Rr., i cili pretendon se nuk ka përfituar nga ligji i amnistisë për shkak të interpretimit të gabuar ligjor të bërë nga prokurori Çlirim Sino. Pas regjistrimit të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2014, prokurori, mbështetur në aktet procedurale, ka konkluduar se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në këto rrethana, prokurori në datën 15.2.2014 ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”, sipas germës “ç”, të nenit 290/1, të Kodit të Procedurës Penale. Referuar përgjigjes ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ky vendim nuk është ankimuar. Nga sa më sipër, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për të vënë në dispozicion praktikën e plotë të procedimit disiplinor dhe stadin hetimor të kësaj çështjeje, me shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2021. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 7.10.2021, ka bërë me dije se në zbatim të vendimit nr. ***, datë 24.12.2018, prokurori i kësaj prokurorie kreu hetime shtesë dhe në përfundim paraqiti kërkesën për pushim kërkesë që u pranua edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. ***, datë 24.6.2020, i cili ka marrë formë të prerë.
162. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në datën 6.5.2019, ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** pas kallëzimit të bërë nga shtetasi B. B., ankesë e cila është trajtuar edhe më lart. Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokurori Çlirim Sino ka regjistruar procedimin penal duke vijuar hetimin. Kallëzuesi B. B., pasi është njohur me vendimet gjyqësore, në kallëzimin e tij pretendon se prokurori Çlirim Sino nëpërmjet veprimesh, në kundërshtim me ligjin, ka konsumuar veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Sa edhe u përmend lidhur me këtë kallëzim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë regjistroi kallëzimin penal nr. *** të vitit 2019. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprime hetimore, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
163. Mbi bazën e kërkesës për informacion Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2021, ka bërë me dije se për subjektin e rivlerësimit Çlirim Sino rezulton të jenë regjistruar katër kallëzime penale të kryera nga shtetasit, si më poshtë vijon:
164. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 4.4.2018, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, të bërë nga shtetasi K. C., i cili pretendon se prokurori Çlirim Sino ka konsumuar veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kallëzuesi pretendon se prokurori e ka hetuar në mënyrë të kundërligjshme, për pasojë i ka atribuuar një vepër penale për të cilën e ka marrë të pandehur dhe e ka dërguar për gjykim. Shtetasi K. C. kallëzon se gjykata i ka vlerësuar të pavlefshme provat në ngarkim të të pandehurit dhe i ka kthyer aktet prokurorisë. Ndër të tjera, kallëzuesi ka deklaruar se është ndjerë i diskriminuar nga prokurori Çlirim Sino për shkak të bindjeve politike. Sa edhe u përmend lidhur me këtë kallëzim të shtetasit K. C., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë regjistroi kallëzimin penal nr. *** të vitit 2018. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprimet verifikuese, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

165. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 4.1.2018, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, të bërë nga shtetasi K. C., i cili pretendon se prokurori Çlirim Sino ka konsumuar veprën penale “përndjekje”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal. Shtetasi K. C. në kallëzimin e tij pretendon se prej muajit prill të vitit 2017 deri në dhjetor të po këtij viti është thirrur disa herë në prokurori fillimisht për t’u pyetur si deklarues e më pas është marrë i pandehur për veprën penale “falsifikim dokumentesh”. Veprimtaria e prokurorit Çlirim Sino në bindjen e kallëzuesit nuk përbënte vetëm shpërdorimin e detyrës por edhe përndjekjen e shtetasit. Referuar pretendimeve të shtetasit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë regjistroi kallëzimin penal nr. *** të vitit 2018. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprimet verifikuese, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
166. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 29.10.2018 ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, të bërë nga shtetasi K. C., i cili pretendon se prokurori Çlirim Sino ka konsumuar veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ai pretendon se prokurori e ka hetuar në mënyrë të kundërligjshme, për pasojë i ka atribuuar një vepër penale për të cilën e ka marrë të pandehur dhe e ka dërguar për gjykim. Shtetasi K.C. kallëzon se gjykata i ka vlerësuar të pavlefshme provat në ngarkim të të pandehurit dhe i ka kthyer aktet prokurorisë. Ndër të tjera, kallëzuesi pretendon se është ndjerë i diskriminuar nga prokurori Çlirim Sino për shkak edhe të bindjeve politike. Sa dhe u përmend lidhur me këtë kallëzim të shtetasit K. C., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë regjistroi kallëzimin penal nr. *** të vitit 2018. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprimet verifikuese, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
167. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 24.2.2020, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, mbi bazën e materialit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Kallëzimi është depozituar fillimisht në Prokurorinë e Posaçme nga shtetasja D. Y., e cila ka kërkuar ndjekjen penale të dy prokurorëve (një prej tyre subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino), si dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, ka përcjellë për kompetencë materialin kallëzues, duke vlerësuar se mund të ekzistojnë elementet e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Shtetasja D. Y. në kallëzimin e saj ka kërkuar që të verifikohet e gjithë veprimtaria e prokurorit gjatë hetimit paraprak, si dhe vendimet gjyqësore të dhëna për ngjarjen e datës 28.9.2017, ku si pasojë e një aksidenti automobilistik ka humbur jetën shtetasi A.Y.
168. Fillimisht i dyshuar si shkaktar i aksidentit ka qenë shtetasi A. A., por pas kryerjes së ekspertimit auto-teknik prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e hetimeve ndaj këtij shtetasi. Kërkesa për pushim nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila ka urdhëruar organin e akuzës që të kryejë një riekspertim me grup ekspertësh. Në zbatim të vendimit gjyqësor riekspertimi është kryer dhe konkluzioni nuk e ka ndryshuar situatën e provueshmërisë së fajësisë, në këto kushte prokurori ka kërkuar sërish pushimin e hetimeve. Kërkesa për pushim është rrëzuar fillimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, por është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, pas ankimit të kryer nga prokurori. Për sa më lart, shtetasja D. Y. pretendon se prokurorët, në këtë rast Çlirim Sino dhe V. Sh., nuk kanë kryer hetime të plota në drejtim të provueshmërisë së veprës penale në ngarkim të shtetasit. Të tjera pretendime shtetasja ka pasur edhe për aktin e ekspertimit auto-teknik, konkluzioni i të cilit është interpretuar gabim nga prokurori sa i përket shkakut

determinant. Në këto rrethana, prokurori ka disponuar me vendim pushimi, duke u mbështetur në hetime të cilat nuk kanë qenë në respektim të ligjit procedural penal. Sa dhe u përmend lidhur me këtë kallëzim të shtetas, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë regjistroi kallëzimin penal nr. *** të vitit 2020. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprimet verifikuese, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Konkretisht, prokurori argumenton se nga verifikimi i kryer nuk rezultoi që nga ana e të kallëzuarve të jetë kryer veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjin. Në këto rrethana, prokurori ka vendosur në datën 27.2.2020 mosfillimin e procedimit penal, sipas gërmës “ç”, të nenit 290/1, të Kodit të Procedurës Penale.

169. Mbi bazën e kërkesës për informacion Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, me shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2021, bën me dije se ndaj shtetasit Çlirim K. Sino nuk rezultoi të jetë regjistruar procedim penal, konfirmuar kjo nga verifikimi i bërë në regjistrat e njoftimit të veprave penale. Në vijim të informacionit është përcjellë praktika (në formë elektronike) që ka të bëjë me kallëzimin penal nr. *** vitit të 2019, bërë ndaj shtetasit Çlirim Sino, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, për të cilin është vendosur mosfillimi si procedim penal, si dhe një material dërguar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Materiali ka të bëjë me kallëzimin nr. *** të vitit 2020, sa më lartpërkshkruar.
170. Për sa më lart u konstatua, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** të vitit 2019 pas kallëzimit të bërë nga shtetasja L. Z. Kallëzuesja ka dhënë shpjegime të hollësishme në lidhje me një ngjarje ndodhur në vitin 2012 në qytetin e Fierit, ku ka mbetur i vrarë një shtetas dhe është plagosur rëndë një tjetër. Për këtë ngjarje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin përkatës, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit O. T., i biri i kallëzueses L. Z. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë. Lidhur me këtë proces kallëzuesja pretendon se nga ana e prokurorit, si dhe gjyqtarëve janë kryer veprime procedurale me qëllim për të ngarkuar me përgjegjësi penale djalin e saj dhe favorizuar autorin real të veprës penale. Për ngjarjen në fjalë kallëzuesja nuk i referohet subjektit të rivlerësimit Çlirim Sino, por një tjetër prokurori.
171. Në vijim të kallëzimit, shtetasja shpjegon se për autorin e ngjarjes sa më lart ka bërë edhe një kallëzim penal, me hetimin e të cilit ka qenë ngarkuar prokurori Çlirim Sino. Objekt ka qenë falsifikimi i disa dokumenteve për përfitim të një pasurie. Prokurori Çlirim Sino, sipas kallëzueses, pavarësisht faktit se e ka dërguar për gjykim çështjen për veprën penale “mashttrim”, neni 143 i Kodit Penal në përfundim e ka favorizuar të pandehurin për sa i përket masës së dënimit të kërkuar. Këtë veprim prokurori, në vlerësimin e kallëzueses, e ka bërë pasi ka miqësi me të pandehurin. Në funksion të kallëzimit të shtetas L. Z., prokurori ka kryer veprime hetimore, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori argumenton se nga aktet e kallëzimit, përveç hamendësimeve të kallëzues, nuk disponohet asnjë e dhënë konkrete për ndonjë veprim me natyrë korruptive nga prokurorët apo gjyqtarët. Në përfundim, ndjekja penale për këtë kallëzim penal nuk mundet të fillojë, pasi pretendimet e paraqitura në kallëzim nuk përmbajnë elemente të ndonjë veprë penale. Në këto rrethana, në datën 25.4.2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, bazuar në gërmën “ç”, të pikës 1, të nenit 290 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale.

C/3. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

172. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në

përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike dhe nga organet ligjzbatuese, si dhe ka analizuar disa dosje profesionale të administruara për këtë qëllim.

Lidhur me konfliktin e interesit

173. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit me personat e lidhur në një marrëdhënie interesi⁶⁵ me subjektin e rivlerësimit, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2021, ka bërë me dije se në lidhje me shtetasit apo personat juridikë të listuar në shkresë nuk ka rezultuar asnjë çështje penale e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino.

DENONCIME NGA PUBLIKU

174. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku 16 denoncime, prej të cilave 5 i përkasin të njëjtës denoncuese. Të gjitha denoncimet janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar si më poshtë vijon:

175. **Denoncim nr. *** prot., datë 29.12.2017**, i shtetasit A. Rr., i cili ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi, ndër të tjera edhe prokurorin Çlirim Sino. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar⁶⁶ konstatohet se subjekti në vitin 2010 ka ushtruar ndjekjen penale kundër shtetasit A. Rr., në procedimin penal nr. *** të vitit 2010, akuzuar për veprën penale “vjedhje dhe pengim të ekzekutimit të vendimi gjyqësor”, për të cilin ka kërkuar vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, e cila, me vendimin datë 25.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është vlerësuar e ligjshme. Nga analizimi i materialit kallëzues vërehet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 16.5.2013, ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të shtetasit, vendim i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 4.12.2013, vetëm për sa i takon masës së dënimit të tij me gjobë. Nga sa më sipër, nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit të denoncimit në fjalë dhe, për rrjedhojë, nuk janë konstatuar fakte apo rrethana, sipas parashikimeve të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

176. **Denoncim nr. *** prot., datë 18.5.2018**, i shtetasit L. B. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga denoncuesi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka depozituar kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, datë 16.4.2009, në ngarkim të të pandehurit L. B., për kryerjen e veprës penale “kallëzim i rremë”, duke kërkuar dënimin e tij me 6 muaj burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 7.1.2010, ka vendosur “Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit L. B., për veprën penale të sipërcituar”. Prokurori Çlirim Sino ka apeluar vendimin e Gjykatës së Faktit Fier dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 19.5.2011, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit dhe dënimin e tij me 6 muaj burg”. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, pasi ky denoncim është marrë në shqyrtim disa herë nga Komisioni dhe, për rrjedhojë, nuk janë konstatuar fakte apo rrethana,

⁶⁵Shoqëria “***”; shtetasit O. M., P. N., K. T., B. B., Y. A., E. M., E. M., shoqëria “***” sh.p.k., shtetasi Ll. Ll., shoqëria “***”, shtetasit G. B., I. K., D. G., A. N., M. M., A. M., S. B., A. M., E. G., H. M., M. F., P. Z., S. B., L. F., V. F., E. F., V. T., E. F., G. F., Xh. F., R. F., V. F., B. F., A. F., L. Gj., B. L., D. B., shoqëria “***”, shoqëria “***” sh.p.k.

⁶⁶Referuar kallëzimit që shtetasi A. Rr. ka depozituar për subjektin e rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyre”, si dhe kallëzimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit për “shpifje për shkak të detyrës”, materiale të përshkruara edhe në rubrikën e të dhënave arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime.

sipas parashikimeve të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

177. **Denoncim nr. *** prot., datë 18.10.2018**, i shtetases A. D., e cila pretendon se prokurori Çlirim Sino nuk ka kryer hetimet e duhura dhe ka marrë një vendim të padrejtë për mosfillimin e procedimit penal, por nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier rezulton se në datën 30.8.2017 denoncuesja ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier ndaj administratorit të Njësisë Administrative *** të Bashkisë Fier, duke pretenduar se ka kryer veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori i çështjes Çlirim Sino, me vendimin e datës 13.9.2017, bazuar edhe në nenet 290/1, germa “ç”, dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal nr. 1498 të vitit 2017”. Ky vendim është ankimuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 17.5.2018, ka rrëzuar ankimin e kësaj shtetaseje. Më tej, denoncuesja e ka ankimuar vendimin në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 30.7.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Nga tërësia e veprimeve procedurale të kryera nga prokurori i çështjes nuk konstatohen veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit apo vendime të marra në kundërshtim me ligjin dhe/apo me shkelje procedurale, siç pretendohet në denoncimin në fjalë. Për rrjedhojë, denoncimi në fjalë nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

178. **Denoncimet: nr. *** prot., datë 23.1.2019; nr. *** prot., datë 11.4.2018, nr. *** prot., datë 23.4.2019; nr. *** prot., datë 13.9.2019; nr. *** prot., datë 12.4.2018; nr. *** prot., datë 23.1.2019, të shtetases L. Z.⁶⁷**. Nga shqyrtimi i denoncimeve të depozituara nga kjo shtetase ka rezultuar se prokurori Çlirim Sino në datën 21.1.2015 ka marrë vendimin për “Mosfillimin e kallëzimit penal nr. ***, datë 20.1.2015”. Nga dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 26.12.2017, ka paraqitur kërkesën për “Për pezullimin e gjykimit” të prokurorit Çlirim Sino, ku ky i fundit i ka kërkuar gjykatës pezullimin e gjykimit me një afat 1-vjeçar, me argumentin se janë ezauruar të gjitha procedurat e kërkimit të shtetasit A. K., sipas nenit 352/1 të Kodit të Procedurës Penale. Një tjetër element në denoncimin⁶⁸ e shtetases është se ajo pretendon se prokurori Çlirim Sino është lidhur me persona të krimit dhe se është i paguar prej tyre, duke përmendur edhe emra të cilët janë të lidhur me krimin dhe botës së drogës. Në dy denoncimet e saj ajo trajton të njëjtat problematika, pasi këta subjekte kanë abuzuar duke shpërdoruar detyrën. Komisionit, nga shqyrtim i dokumentacionit, i rezultoi se është marrë vendimi i mosfillimit për kallëzimin e bërë nga denoncuesja nga prokurori i çështjes, pasi vepra në fjalë ndiqet nga vetë kallëzuesi në gjykatë dhe nuk ka elemente të veprës penale që ndiqet nga prokurori. Nga informacioni i disponuar⁶⁹, dhe konkretisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** të vitit 2019, pas kallëzimit të bërë nga kjo shtetase, i cili është përshkruar hollësisht në kapitullin III

⁶⁷Denoncuesja, ndër të tjera, ankohet edhe për subjektin e rivlerësimit Çlirim Sino, me detyrë prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke parashtruar se vendimet janë dhënë në kundërshtim me Kodin Penal dhe se gjyqtarët dhe prokurorët e denoncuar kanë shkelur etikën në gjykimin e çështjes, ku djali i saj O. T. ka qenë i pandehur dhe është gjykuar dhe dënuar për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga germa “dh” e nenit 79, të Kodit Penal.

⁶⁸Denoncim nr. *** prot., datë 11.4.2018, ku denoncuesja përmend emrat e disa shtetasve të përmendur në denoncim, për të cilën Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2021, iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, çështje të cilat janë trajtuar gjerësisht.

⁶⁹Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 13.10.2021, ka vënë në dispozicion procedimin penal nr. ***, datë 14.6.2016, në ngarkim të shtetasit A. K., së bashku me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 15.11.2016.

“Të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime”. Për rrjedhojë, denoncimi në fjalë nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

179. **Denoncim/ankesë nr. *** prot., datë 2.8.2018**, i shtetases D. Y., e cila ankohet për dy prokurorët V. Sh. dhe Çlirim Sino, për të cilin shprehet se ky i fundit, jo vetëm që nuk bëri hetime të rregullta sipas detyrave që i la gjykata, por duke shkelur procedurat nuk ka bërë një hetim të njëanshëm dhe ka pushuar çështjen në ngarkim të personit nën hetim A. A. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 26.7.2018, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës për kthimin e akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2017, për vazhdimin e hetimeve, sipas disponimit në pjesën arsytuese të vendimit. Urdhërohet Prokuroria të përfundojë hetimet brenda një afati prej 1 muaji”. Në analizë të vendimit, gjykata ka vlerësuar se: *“Në rastin konkret nuk ndodhemi përpara rastit të parashikuar nga neni 328, pika ‘dh’ e Kodit të Procedurës Penale, pasi përfundimi i arritur nga organi i prokurorisë është mbështetur mbi një aktekspertimi jo të qartë, si dhe nuk është kryer një hetim i plotë në lidhje me faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shkaktimin e aksidentit”*. Nga shqyrtimin faqes zyrtare konstatohet se Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 25.9.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 26.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke pranuar kërkesën dhe duke vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të personit nën hetim A. A., regjistruar me nr. ***.
180. Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit Vlorë⁷⁰ është shprehur: *“Çmon se nga ana e prokurorisë është ezauruar plotësisht detyra e saj për të përcaktuar shkaku determinant të aksidentit, referuar detyrave të lëna më parë prej gjykatës që ka prishur vendimin e mosfillimit të procedimit penal...”*. Kjo detyrë e lënë nga gjykata është përmbushur përmes ripërsëritjes së aktekspertimit dhe në përfundim vendosi “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.3.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”. Nga sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka ezauruar të gjitha veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier – sikurse është konfirmuar edhe nga vendimi nr. ***, datë 25.9.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Rrjedhimisht, nuk konstatohen mangësi apo shkelje në veprimet hetimore të subjektit për këtë çështje, për sa kohë janë vlerësuar të plota dhe të rregullta si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ashtu edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë.
181. **Denoncim nr. ***, datë 4.10.2019**, i shtetases N. P. Xh. Kjo shtetase ka depozituar formularin e denoncimit për subjektin e rivlerësimit, por në të nuk është përshkruar ndonjë shkelje procedurale e kryer nga subjekti. Ajo ka bashkëlidhur një *memo* të vitit 2019 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier konstatohet se prokurori Çlirim Sino ka dërguar për gjykim çështjen penale ndaj denoncueses së akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve”, vepër për të cilën denoncuesja, me vendimin nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është dënuar me 2 vjet dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, vënien në provë të saj për 4 muaj. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, çështje e cila është ende në përpunim, kjo sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjithashtu, vetë denoncuesja ka paraqitur një kërkesë për “Pezullimin e ekzekutimit të vendimit” dhe ditën e zhvillimit të seancës në të cilin ka qenë prezent subjekti i rivlerësimit⁷¹ denoncuesja nuk është paraqitur. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. *** (***) datë 2.3.2020), ka

⁷⁰Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 25.9.2018, është shprehur në lidhje me veprimet e kryera nga prokuroria, duke i konsideruar ato të plota dhe shteruese dhe duke pranuar kërkesën për pushimin e procedimit penal.

⁷¹Prokurori Çlirim Sino ka kërkuar pushimin e gjykimit dhe deklarimin të papranueshëm të kërkesës.

vendosur deklarimin të papranueshëm të kërkesës së denoncueses, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 2.2.2021. Për sa më lart, denoncimet në fjalë nuk rezultojnë të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar ndonjë shkelje ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën konkrete të përshkruara apo pasoja ligjore, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

182. **Denoncim nr. ***prot., datë 5.3.2019 dhe denoncim nr. ***prot., datë 22.6.2022**, i shtetasve M. M. dhe Q. A. Këta shtetas denoncojnë subjektin e rivlerësimit Çlirim Sino, duke pretenduar se aktekspertimi nr. ***, datë 24.5.2019, i hartuar nga dy ekspertët ka qenë në kundërshtim me vendimin e marrë nga organi i Prokurorisë. Rezultatet e aktekspertimit janë shfrytëzuar nga prokurori për të paraqitur kërkesën për pushimin e procedimit penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo gjykatë, pas shqyrtimit të provave, me vendimin nr.***, datë 17.10.2019, nuk e pranoi kërkesën për pushimin e procedimit penal të prokurorit Ç. S., pasi, ndër të tjera, ka konstatuar se: “...përfundimi i arritur nga organi i Prokurorisë nuk është mbështetur mbi një hetim të plotë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se në lidhje me rastin konkret duhet të kryhet aktekspertimi grafik teknik i dokumenteve të dyshuara nga një grup ekspertësh”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.***, datë 23.2.2021. Më tej, edhe pse u hartua një akt tjetër ekspertimi por me të njëjtët ekspertë, përsëri prokurori ka kërkuar pushimin e procedimit penal, kërkesë kjo e cila është rrëzuar përsëri nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 15.2.2021, me argumentimin se: “...pasi përfundimi i arritur nga organi i Prokurorisë nuk është mbështetur mbi një hetim të plotë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se në lidhje me rastin konkret duhet të kryhet aktekspertimi grafik teknik i dokumenteve të dyshuara me një grup tjetër ekspertësh”. Nga sa më sipër, Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegimet lidhur me sa më sipër është përshkruar në denoncim, si dhe mbi moskryerjen e detyrave të urdhëruara nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës mbi vijimësinë e mëtejshme të çështjes në fjalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

183. Subjekti i rivlerësimit, përveç dokumentacionit⁷² të depozituar së bashku me prapësimet lidhur me këtë denoncim, ka shpjeguar se: “Në lidhje me argumentin e përdorur nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier në vendimin nr. ***, datë 17.10.2019, se përfundimi i arritur nga organi i Prokurorisë nuk është i mbështetur në një hetim të plotë, ka të bëjë me konstatimin e aktekspertimit të përpiluar nga ekspertët V. K. dhe D. Ç., ku nga ana e organit procedues ishte caktuar vetëm eksperti V. K., por prej Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, për shkak të kompleksitetit të çështjes, është përfshirë edhe eksperti D. Ç. Prej prokurorit aktekspertimi i ekspertëve V. K. dhe D. Ç. ishte një provë e marrë në përputhje me ligjin dhe se asnjë prej ekspertëve nuk kishte papajtueshmëri me detyrën e ekspertit, papajtueshmëri e parashikuar në nenin 180 të Kodit të Procedurës Penale.

184. Në rastin konkret, megjithëse nga gjykata është kërkuar verifikimi i vendimeve të gjyqtarit S.Xh. për periudhën '92 – 93', kjo përpjekje është bërë nga ana e prokurorit më parë, dhe me konkretisht me shkresën nr. *** prot./Ç. S., datë 17.5.2018, i jemi drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për të na konfirmuar nëse në arkivën e kësaj gjykate kishte vendime

⁷²Subjekti ka depozituar: shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2018, të Prokurorisë së Rrethit Fier drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier drejtuar Prokurorisë së Rrethit Fier; kërkesën për pushimin e çështjes penalen nr. ***, datë 20.10.2021; vendimin nr. *** prot., datë 12.5.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*gjqësore të shtetasve S. Xh. etj. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier kishte konfirmuar se për vitet 1991 - 1993 pranë kësaj gjykate nuk rezulton asnjë vendim apo dosje gjyqësore, pasi ato janë djegur në janar të vitit 1997. Gjithashtu, edhe për sa i përket vendimit nr. ***, datë 15.2.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ai është marrë me kushtet e papajtueshmërisë së ekspertëve V. K. dhe D. C., duke urdhëruar përsëritjen e aktit të ekspertimit me grup tjetër ekspertësh, vendim i cili nuk është apeluar nga prokurori me qëllim kryerjen sa me shpejt të aktit të ekspertimit dhe shqyrtimi në apel të mos shkaktonte zvarritje.*

185. *Qëndrimi i gjykatës në vendimin nr. ***, datë 15.2.2021, i cili ka konstatuar papajtueshmërinë e detyrës së ekspertëve V. K. dhe D. C., për mendimin tim nuk është i drejtë, pasi në nenin 180 të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar rastet e papajtueshmërisë me detyrën e ekspertit. Siç rezulton nga parashikimet ligjore të nenit 180 të Kodit të Procedurës Penale, ekspertët e Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, V. K. dhe D. C., nuk ndodheshin në asnjë prej kushteve të papajtueshmërisë me detyrën e ekspertit. Në vijim të hetimeve është kryer aktekspertimi grafik sipas urdhërimeve të gjykatës dhe në përfundim është konkluduar nga prokurori se nuk provohet fakti penal dhe me kërkesën e datës 20.10.2021 i është kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier pushimi i çështjes dhe se në vijim çështja është në gjykim në këtë gjykatë".* Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit bën me dije Komisionin se ndaj tij kanë paraqitur ankim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shtetasit M. M. dhe Q. A. ILD-ja, me vendimin nr. *** prot., datë 12.5.2021, ka vendosur arkivimin e ankesës së këtyre shtetasve, pasi nuk janë konstatuar shkelje ligjore, duke vijuar se kjo çështje penale është ende në gjykim.

Vlerësimi i trupit gjykues

186. Në vlerësim të rrethanave, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, por edhe nga analizimi i vendimit të gjykatës, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore për sa i takon kërkimit të të dhënave dhe dokumenteve, si dhe vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier të vitit 1992, referuar dokumentacionit të depozituar në prapësime. Ndërsa, për sa i takon vendimit nr. *** prot., datë 12.5.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me të cilin Komisioni është njohur për herë të parë vetëm pas depozitimit të kopjes së këtij së tij nga subjekti së bashku me prapësimet, nga ku ka rezultuar se ankesa e këtyre shtetasve është arkivuar nga ky institucion, me argumentimin se nuk plotësonte kriteret e parashikuara në ligjin nr. 96/2016. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se – ndonëse janë kryer veprime hetimore në padijeni të stadi të çështjes, përderisa ndodhemi në kushtet ku ende për këtë çështje nuk ka një vendim përfundimtar, për sa kohë çështja është ende në gjykim (si dhe për sa kohë ankesa e shtetasve është arkivuar nga ILD-ja, pasi nuk janë konstatuar shkelje ligjore, nënkupton mungesën e ndonjë shkeljeve nga subjekti) – kjo çështje nuk mund të jetë objekt vlerësimi përfundimtar në aspektin profesional, në kuptim të nenit E të Kushtetutës, për sa kohë është ende në shqyrtim.

187. **Denoncim nr. *** prot., datë 11.6.2021**, nga shtetasi L. L., përfaqësuar nga av. K. C. Në kërkesën e depozituar ky shtetas ankohet për faktin se prokurori i çështjes Çlirim Sino deri në datën 20.4.2021⁷³ nuk ka marrë dhe nuk ka kryer asnjë veprim procedural, nuk e ka thirrur për të dhënë dëshminë e tij si person i afërt apo person që ka dijeni në vdekjen e gruas së tij dhe në kërkesën e datës 10.6.2021 ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit me një tjetër dhe për këtë qëllim ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

⁷³Shtetasi L. L. është bashkëshorti i të ndjerës E. L. e cila ndërroi jetë në ngjarjen e datës 10.4.2021 në maternitetin e Fierit. Ai pretendon se që nga ky moment ka depozituar një kallëzimin penal dhe se deri në këto momente që ka kaluar një kohë e konsiderueshme dhe prokurori nuk ka marrë asnjë masë.

Lushnjë, duke e akuzuar për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”. Nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegimet për sa më lartpërshtuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

188. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur prapësimeve, ka vënë në dispozicion dokumentacionin⁷⁴ përkatës. Ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Kam trajtuar që në momentet e para me profesionalizëm çdo pretendim të ngritur nga pala e dëmtuar, pasi që në momentet e para kur ka ndodhur kjo ngjarje si prokuror i gatshëm kam mbajtur kontakte të pandërprera me oficerin e policisë gjyqësore, ku ky i fundit ka ndërmarrë të gjitha masat që në momentet e para për kryerjen me kujdes dhe shpejtësi të çdo veprimi hetimor të domosdoshëm për identifikimin e çdo rrethane, e cila do të sqaronte rrethanat e mjekimit nga ana e personelit mjekësor ndaj viktimës E. L. Pretendimet e kallëzuesit L. L. nuk janë të vërteta dhe rrëzohen me aktet e fashikullit të procedimit penal nr. ***, datë 14.4.2021, ku në aktet e këtij fashikulli rezulton se në datën 10.4.2021 kallëzuesi L. L. është pyetur në lidhje me rrethanat e vdekjes se bashkëshortes së tij E. L. nga oficeri i policisë gjyqësore. Menjëherë dhe pa vonesë, po në atë datë kur kam regjistruar procedimin penal nr. ***, është urdhëruar oficeri i policisë gjyqësore me urdhrin e datës 14.4.2021, për kryerjen e veprimeve hetimore në funksion të procedimit penal dhe në pikën 1 të këtij urdhri, kam urdhëruar ripyetjen e shtetasit L. L. për çdo pretendim dhe dijeni shtesë që kishte për çështjen.*
189. Në vijimësi të pretendimeve të kallëzuesit L. L., i përfaqësuar nga mbrojtësi av. K. C., me deklaratën e datës 4.6.2021 i kam kërkuar Drejtuesit të Prokurorisë pranimin e deklaratës për heqjen dorë dhe zëvendësimin tim me një tjetër prokuror me qëllim eliminimin e çdo lloj pretendimi më të vogël që mund të kishte bashkëshorti i viktimës, deklaratë e cila u pranua nga Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin e datës 7.6.2021 dhe në vijim kjo çështje i ra me short elektronik një tjetër prokurori. Pasi janë kryer veprimet hetimore nga prokurori, me kërkesën e datës 17.5.2022, i është kërkuar gjykatës pushimi i çështjes, me argumentin se nuk ekzistojnë elementet e figurës së veprës penale ‘mjekim i pakujdesshëm’, të parashikuara nga neni 96 i Kodit Penal dhe çështja është për shqyrtim në gjykatë.
190. Me tej, ka rezultuar se ka paraqitur ankim pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë mbrojtësi i tij av. K. C. dhe pasi është shqyrtuar ankesa me vendimin nr. ***, datë 12.7.2021, është vendosur arkivimi i ankesës së shtetasit K. C. Për sa i përket kallëzimit të bërë nga shtetasi L. L. për veprat penale ‘shpërdorim detyre’ dhe ‘veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës’, të parashikuara nga nenet 248 dhe 301 të Kodit Penal, ju vë në dijeni se me vendimin e datës 8.3.2022, të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë është vendosur mosfillimi i hetimeve, vendim i cili i është komunikuar në datën 23.3.2022”.

Vlerësimi i trupit gjykues

191. Trupi gjykues, nisur nga shpjegimet shteruese të subjektit, por edhe nga shqyrtimi i praktikës dhe analizimi i vendimit nr. ***, datë 12.7.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i cili ka vendosur arkivimin e ankesës në fjalë, vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

⁷⁴Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka paraqitur edhe urdhrin e datës 14.4.2021 për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni L. L.; urdher për kryerjen e veprimeve hetimore datë 14.4.2021; deklaratë për heqjen dorë nga procedimi penal nr. ***, datë 4.6.2021; vendim i datës 7.6.2021, për pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit; kërkesë e datës 17.5.2022, për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2021; vendim nr. *** prot., datë 12.7.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe vendimi për mosfillimin e hetimeve datë 8.3.2022, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

gjenden bindëse – për së paku deri në momentin kur ka qenë i ngarkuar për hetimin e këtij procedimi penal, pasi nga ana e tij janë ndërmarrë hapat hetimore procedurale për regjistrimin e veprës penale, urdhërimit e kryerjes së veprimeve hetimore dhe marrjen bashkëshortit të së ndjerës, në cilësinë e personit që ka dijeni për ngjarjen.

192. **Denoncim nr. *** prot., datë 25.7.2018**, i shtetasit B. B. Lidhur me këtë denoncim rezulton të jetë edhe praktika nr. *** e vitit 2019, regjistruar pas ankesës së shtetasit B. B. drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ndaj prokurorit Çlirim Sino. Shtetasi ka paraqitur një kërkesë me objekt zëvendësimin e prokurorit Çlirim Sino me një prokuror tjetër, duke pretenduar se ekzistonin elementet e cenimit të rëndë të besimit për një hetim të paanshëm dhe objektiv nga ana e prokurorit. Këtë pretendim shtetasi e mbështet në faktin se ndaj këtij prokurori ka bërë kallëzim penal. Pasi kërkesa është administruar nga Sektori i Marrëdhënive me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ajo është arkivuar. Ndërkohë, në kërkesën e tij, ky shtetas kërkon zëvendësimin e prokurorit Çlirim Sino nga çështja penale nr. *** e viti 2018, duke pretenduar se ekzistojnë shkaqe të forta dhe të provuara njëanshmërie nga ana e këtij të fundit, i cili ka marrë vendimin për mosfillimin e kallëzimit, pasi nuk ka kryer asnjë hetim minimal lidhur me ngjarjen. Gjithashtu, ai pretendon se ka pasur njohje direkte me të, pasi rreth vitit 2017 së bashku men bashkëshorten e tij kanë qenë në bisedime për blerjen e një apartamenti në qytetin e Vlorës. Ai gjithashtu përmend si shkak edhe qëndrime të ndryshme që ka mbajtur vëllai i tij i cili bënë pjesë në Avokaturën e Shtetit dhe xhaxhait të prokurorit, një çështje ku ky i fundit ka qenë palë e paditur.
193. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka rezultuar se denoncuesi ka kundërshtuar vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2018, ku kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 1.10.2018, ndër të tjera, ka vendosur edhe “Regjistrimin e procedimit penal për veprën penale ‘shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor’ e në funksion të procedimit penal, administrimin e tabelave fotografike të vendit të ngjarjes, të pyetet shtetasi B. B., për rrethanat e ngjarjes, me çfarë shpejtësie ka qenë duke lëvizur në momentin e ngjarjes, a ka parë dhe respektuar tabelat provizore sinjalizuese për punimet në rrugë, aksi Fier-Lushnjë, në cilën segment të rrugës është goditur me autobusin e tij, të verifikohet dhe të identifikohet në se ka drejtues mjetesh që kanë udhëtuar në atë aks rrugor në momentin e ngjarjes, që kanë parë momentin e përplasjes, të verifikohet nga enti pronar i rrugës nëse kryheshin punime në momentin e ngjarjes, të kryhet aktekspertimi auto-teknik me grup ekspertësh të cilët të ndërtojnë vendin e ngjarjes, gjendjen teknike të automjetit, vlerësimin e dëmit të konstatuar...”. Rezulton se pas ankimit, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 20-11-2018, duke u shprehur se: *“Përfundimi i organit të akuzës në vendimin objekt ankimi se fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale pasi nuk ekzistojnë elementet e saj, gjendet nga Gjykata e Apelit Vlorë i pabazuar në ligj dhe në provat e administruara në gjykim dhe, për pasojë, konkludohet se ky vendim duhet të priset dhe hetimet të zhvillohen në drejtimin e orientuar nga gjykata e shkallës së parë, pasi për veprën penale ‘shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor’, prokuroria nuk mund të procedojë me vendim mosfillimi, pa përcaktuar në mënyrë determinante mënyrën se si ka ndodhur aksidenti dhe shkakun determinant të tij”*.
194. Nga sa më sipër, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime për sa i takon moskryerjes së detyrave të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit – të cilat kanë të bëjnë më përcaktimin e shkakut determinant të ndodhjes së aksidentit – duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës për vijimësinë e procedimit penal në fjalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

195. Subjekti i rivlerësimit, përveç dokumentacionit⁷⁵ të vënë në dispozicion me prapësimet, ka shpjeguar se nuk ka mbajtur asnjë qëndrim të njëanshëm në rastin konkret ku përmendet xhaxhai i tij H. S., pasi nuk gëzon marrëdhënie të mira me të. Për sa i përket vendimit të mosfillimit për këtë procedim penal, ky vendim është mbështetur në prova dhe akte procedurale me fuqi provuese, siç është procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe aktekspertimi auto-teknik nr. ***, datë 11.6.2018, i ekspertit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, nga ku rezultonte se drejtuesi i automjetit B. B. nuk ka marrë masa të reduktive shpejtësinë në rrugë që ka kufizim shpejtësie për shkak të punimeve, duhet të qarkullojë në të djathtë të karexhatës edhe kur rruga është e lirë, si dhe kapërcen sinjalin horizontal, shkelje këto janë që janë edhe shkaku determinant i aksidentit.
196. Ashtu sikurse ka rezultuar nga aktekspertimi auto-teknik nr. ***, datë 11.6.2018, ekzistonte lidhja shkakësore midis veprimeve të drejtuesit të automjetit tip BMW, B. B., dhe ardhjes së pasojës së dëmtimit të vetë drejtuesit nga kjo shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor. Mbi bazën e këtij aktekspertimi auto-teknik me dhe fuqi provuese, me vendimin e datës 21.6.2018 është vendosur mosfillimi i kallëzimit penal nr. *** të vitit 2018, me argumentin se fakti nuk përbën veprë penale. Kundër vendimit ushtroi ankim shtetasi B. B. pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, e cila, me vendimin nr. ***, datë 1.10.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit B. B., duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 20.11.2018, vendosi lënien në fuqi të vendimit datë 1.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Vendimi është administruar në sekretarinë e prokurorisë në datën 21.3.2019 dhe me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 28.3.2019, është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. *** për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal. Në vijim të hetimeve është kryer një akt i ri ekspertimi me grup ekspertësh, nga ku rezulton se në bazë të aktekspertimit auto-teknik nr. ***, datë 15.11.2019, shkaku i aksidentit ishin shkeljet e konstatuara nga Enti Pronar i Rrugës gjatë kryerjes së punimeve në këtë segment rrugor.
197. Në këto rrethana, në vijimësi të hetimeve, janë kryer veprime hetimore për identifikimin e rrethanave të kryerjes së punimeve dhe me urdhrin e datës 30.9.2020, për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga ajo e “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal në atë të “shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Për shkak të korrespondencës për identifikimin e personave përgjegjës për shkeljet e rregullave të mbrojtjes në punë, pas administrimit të dokumentacionit nga shoqëria “****” sh.p.k. janë administruar një sërë kërkesash, memoriesh dhe provash dhe me vendimin e datës 25.5.2022 është vendosur përsëri kryerja e ekspertimit teknik me grup ekspertësh, duke i vënë në dispozicion grupit të ekspertëve të gjithë dokumentacionin e grumbulluar të paraqitur edhe nga kjo shoqëri e cila po kryente punimet në rrugë dhe ka pretenduar se aksidenti ka ndodhur për shkak të parakalimit të gabuar të drejtuesit të automjetit tip BMW. Aktualisht hetimet janë në vijimësi në pritje të aktit të riekspertimit teknik.

⁷⁵Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar edhe dokumentacionin: aktekspertimi auto-teknik nr. ***, datë 11.6.2018; vendimi i mosfillimit të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2018, datë 21.6.2018; vendimi nr. ***, datë 1.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 28.3.2019; aktekspertimi auto-teknik nr. ***, datë 15.11.2019; urdhër për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale datë 30.9.2021 dhe vendimin për kryerjen e ekspertimit auto-teknik datë 25.5.2022.

Vlerësimi i trupit gjykues

198. Nga shqyrtimi i vendimit të disponuar, por edhe nga shpjegimet e paraqitura në prapësimet e paraqitura, Komisioni arrin në përfundimin se rezultati i arritur dhe i njoftuar subjektit nuk ndryshon, për sa kohë, ashtu sikurse ka rezultuar edhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit nuk ka konstatuar dhe evidentuar qartësisht shkakun determinant të ndodhjes së aksidentit rrugor për të cilat nga gjykata ishte urdhëruar kryerja e veprimeve të tjera hetimore, në përfundim të të cilave kanë ndryshuar cilësimin e veprës penale. Nga sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se, për sa kohë hetimet lidhur me këtë çështje janë ende në vijimësi, në zbatim të dispozitave të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, çmon se vlerësimi përfundimtar i aftësive profesionale të mos shtrihet ndaj kësaj çështjeje.
199. **Denoncim nr. *** prot., datë 2.8.2021**, i shtetasit O. X., i cili ka depozituar një fashikull të madh në të cilën denoncon disa subjekte rivlerësimi, si dhe ka vënë në dispozicion edhe një padi penale ndaj disa subjekteve, ndërmjet tyre edhe subjekti i rivlerësimit, drejtuar Gjykatës së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar në datën 1.8.2021. Nga dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar organin e akuzës me objekt “verifikim dhe zbatim i masës së sigurimit”, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 3.10.2020, të formës së prerë, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të masës së sigurimit “arrest me burg”, të dhënë më parë, ndërsa hetimet e mëtejshme për këtë procedim janë ndjekur nga prokurori Petrit Vukaj. Për sa më sipër, në lidhje me këtë pretendim, denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova dhe/ose *indicie* specifike për ndonjë shkelje të subjektit të rivlerësimit.
200. **Denoncim nr. *** prot., datë 25.5.2018**, i shtetasit M. H. Denoncuesi në kërkesë-ankesën e tij kërkon verifikimin mbi procedimin penal nr. ***, datë 14.7.2017, për të cilin subjekti ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal. Ky shtetas nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Komisionit i ka rezultuar se kjo gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 24.10.2017, ka vendosur “Kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2017, duke qenë se hetimet janë të paplota dhe se hetimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje për një afat dymujor, që nga momenti që vendimi merr formë të prerë, duhet të kryhen këto veprime: të kryhet akti i ekspertimit me grup ekspertësh mbi bazën e akteve të fashikullit të prokurorit, të cilët të përcaktojnë gjendjen teknike të automjeteve; të vlerësojnë dëmin konkret të automjetit dhe biçikletës; të përcaktohet mekanizmi i ngjarjes nëse ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i automjetit; sa ka qenë shpejtësia e lejuar në vendin e ngjarjes dhe vlerësuar me raportin me shpejtësinë me të cilin ka lëvizur drejtuesi *a do të ndodhte përplasja nëse ai do të lëvizte me shpejtësinë e lejuar, nëse ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, cilat janë ato, cili është shkak determinant i përplasjes dhe dëmtimit të rëndë të shtetasit; të pyetet shtetasi R. H. i pranishëm në momentin e ngjarjes*”.
201. Ky vendim është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.***, datë 16.1.2018, e cila, ndër të tjera, ka çmuar se: “... *ndryshe nga sa pretendohet në ankimin e organit të akuzës, vetëm pas kryerjes nga ana e prokurorisë të detyrave të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe të tjerave që mund të rezultojnë të nevojshme pas kryerjes së tyre, mund të arrihet në një konkluzion të drejtë dhe të bazuar për mënyrën e përfundimit të këtij procedimi penal. Pretendimi i organit të akuzës dhe personit të interesuar se nuk është më e nevojshme kryerja e ndonjë veprimi hetimor, pasi del qartë se shtetasi nuk ka përgjegjësi penale, bazuar në konkluzionet e aktit të ekspertimit, sipas të*

cilit ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga vetë i dëmtuari është i pabazuar në prova, për sa kohë nga ana e organit të akuzës nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në funksion të këtij procedimi penal, për të përcaktuar shkakun determinant në ardhjen e pasojës dhe ndikimin që ka pasur shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (tejkalimi i shpejtësisë nga ana e drejtuesit të mjetit) në ardhjen e pasojës. Janë këto veprime hetimore ato që do të përcaktojnë drejt nëse janë konsumuar veprime të kundërligjshme nga ana e të kallëzuarit, kualifikimin e tyre ligjor dhe përgjegjësinë penale në rastin konkret”.

202. Nga analizimi i praktikës së administruar, përpos vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për kryerjen e aktekspertimit mjeko - ligjor, duke përcaktuar dëmtimet përkatëse dhe shkallën e tyre; është kryer aktekspertimi auto - teknik për të përcaktuar shpejtësinë e automjetit në momentin e ngjarjes; është vlerësuar gjithmonë sipas aktekspertimit se nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i automjetit; është përcaktuar shkak i aksidentit, që ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga biçiklisti, rrethanë kjo që sipas subjektit nuk përbënte vepër penale. Gjithashtu, lidhur me pyetjen e një dëshmitari të urdhëruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas të cilës subjekti e ka konsideruar irelevante pyetjen e tij, për sa kohë aktekspertimi ka dhënë qartazi shpjegime dhe se nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, për të cilin ka kërkuar edhe rrëzimin e kërkesës. Nga sa më lart, Komisionit i ka rezultuar se nga krahasimi i veprimeve hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit ka një diferencë midis atyre të urdhëruara nga gjykata, për sa kohë ishin të ndërmarra në pjesën më të madhe nga subjekti i rivlerësimit, duke i kërkuar të japë shpjegime, për sa i takon moskryerjes së të gjitha veprimeve hetimore në funksion të këtij procedimi penal, për të përcaktuar shkakun determinant në ardhjen e pasojës dhe ndikimin që ka pasur shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës lidhur me vijimësinë e procedimit penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

203. Referuar dokumentacionit⁷⁶, por edhe shpjegimeve të subjektit, ai ka sqaruar se për sa i përket diferencës së veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata, ato janë kryer në një kohë relativisht të shkurtër, pasi vendimi nr. ***, datë 24.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 27.12.2017. Pas administrimit të vendimit ka filluar kryerja e veprimeve procedurale të urdhëruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, brenda një kohe të shkurtër dhe në datën 5.4.2018 është kërkuar pushimi i çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 19.6.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017 në ngarkim të shtetasit K. Gj. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 2.10.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 19.6.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.

Vlerësimi i trupit gjykues

204. Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet dhe pasi analizoi dokumentacionin e depozituar, arriti në përfundimin se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime bindëse lidhur me çka është kërkuar, kjo për sa i takon ndryshimit të veprimeve hetimore të ndërmarra prej tij dhe ato të

⁷⁶Bashkëlidhur dokumentacionit subjekti ka paraqitur: aktekspertimin auto-teknik datë 27.6.2017; aktekspertimin auto-teknik datë 2.4.2018; vendimin nr. ***, datë 24.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin nr. ***, datë 27.12.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimin nr. ***, datë 19.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 2.10.2018.

urdhëruara nga gjykata. Megjithatë, nisur nga fakti se Gjukata e Apelit Vlorë ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal të çështjes në fjalë – pas kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara – trupi gjykues vlerëson se kjo çështje, pavarësisht se vendimi i Gjukatës së Apelit Vlorë ka mbështetur kërkesën e tij për pushimin e procedimit penal, që e lehtëson disi pozitën e subjektit, qëndron konstatimi i moskryerjes së të gjitha veprimeve hetimore prej tij, ndonëse pa prodhuar pasoja konkrete lidhur me konkludimin e çështjes. Gjithsesi, parë ky si një shkak i vetëm, nuk vlerësohet i mjaftueshëm për të çuar subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale.

205. **Denoncim nr. *** prot., datë 12.11.2021**, i shtetases E. D., e cila në denoncimin e saj pretendon se subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino nuk ka bërë asnjë kërkim, duke dalë në konkluzionin që kallëzimi i ngritur prej saj nuk përbën vepër penale, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar, por edhe nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Gjukatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka rezultuar se kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 9.4.2019, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 11.6.2019, të Gjukatës së Apelit Vlorë, ka rrëzuar kërkesën e denoncueses, duke lënë në fuqi vendimin e datës 4.2.2019, të Prokurorisë pranë Gjukatës së Rrethit Gjyqësor Fier për “Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 17.1.2019, me argumentin se fakti nuk parashikohet si vepër penale”. Lidhur me pretendimin e denoncueses se nga ana e prokurorisë nuk është kryer asnjë kërkim, ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka kërkuar informacion pranë Bashkisë ***, e cila ka dhënë informacion në lidhje me ankesat e kallëzueses/denoncueses.
206. Më tej, gjatë shqyrtimit të ankimit të denoncueses e cila ka parashtruar të njëjtat shkaqe edhe në Gjukatën e Apelit Vlorë, kjo e fundit ka vlerësuar se kërkesat e denoncueses nuk kanë natyrë penale, por janë mosmarrëveshje me natyrë civile. Gjithashtu, Gjukata e Apelit Vlorë ka çmuar se Prokuroria ka kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me kallëzimin dhe me të drejtë është konstatuar se nuk ka nevojë për veprime të tjera për të vërtetuar që fakti nuk përbën vepër penale. Kjo çështje është rekursuar nga denoncuesja në Gjukatën e Lartë dhe aktualisht është në status studimi, regjistruar me nr. ***, datë 5.12.2019.
207. Nisur nga sa më sipër, Komisioni nuk ka konstatuar shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, për aq kohë sa vendimi për mosfillimin e kallëzimit penal prej tij është pranuar nga Gjukata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe është lënë në fuqi nga vendimi i Gjukatës së Apelit Vlorë.

LIDHUR ME DISA FAKTE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA

208. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me disa artikuj të publikuar në median *online*. Në kuadër të kryerjes së një hetimi gjithëpërfshirës janë administruar dhe analizuar të dhënat dhe dokumentacioni përkatës i kërkuar mbi artikujt e publikuar në median *online* në portalet mediatike, si më poshtë vijon:
209. **Denoncime online në portalet:** <https://domino.al/2021/09/17/vrasja-e-sabrina-bengajt-familjaret-denoncojne-ne-spak-gjyqtarin-dhe-prokurorin/https://www.reporter.al/31-vjecari-vret-bashkeshorten-2-muaj-pasi-gjykata-e-liroi-me-pretekstin-e-problemeve-mendore>.
210. Nga sa më sipër, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjukatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila, me shkresën nr. *** prot., vuri në dispozicion dosjen e plotë, ku nga shqyrtimi i së cilës konstatohet se fillimisht gjykata, me vendimin nr. ***, datë 22.9.2020, për këtë shtetas ka vendosur masën e sigurimit “arrest me burg”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion është konstatuar se prokurori ka depozituar në gjykatë kërkesën për pushimin e

çështjes penale në ngarkim të personit nën hetim E. M. (B.) për veprat penale “dhunë në familje”, “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe caktimin e masës mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion ndaj personit nën hetim”.

211. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore të caktimit të masës së sigurimit “arrest me burg” dhe është marrë vendimi për kryerjen e aktekspertimit psikiatriko-ligjor nr.***⁷⁷, datë 20.11.2020, nga ku ka rezultuar se: *“Ky shtetas vuan nga një sëmundje psikike të paktën prej 2 vjetësh sipas dokumentacionit përkatës shoqëruar, e cila ka qenë prezente edhe në kohën e kryerjes së veprës dhe që ka prishur ekuilibrin mendor. Shtetasi E. B. vuan nga çrregullimi psikotik i paspecifikuar. Sëmundja ka ndikuar në kryerjen e veprës penale, shtetasi nuk ka qenë në gjendje të gjykojë realitetin, të kuptojë dhe të kontrollojë veprimet e tij apo pasojat e tyre. Shtetasi E. B. nuk është i përgjegjshëm para ligjit për veprën e kryer, pasi ka qenë nën ndikimin e çrregullimit të mendimit. Nëse sëmundja e tij nuk trajtohet dhe nuk ndiqet rregullisht nga specialisti psikiatër, sjellja e tij është e paparashikueshme dhe me pasoja”*. Më tej ka rezultuar se është kryer një tjetër aktekspertimi psikiatriko-ligjor (shitesë) ***⁷⁸, datë 4.12.2020, në të cilin është arritur në përfundimin se: *“Shtetasi E. B. prezanton risk të lartë për sjellje të paparashikueshme dhe me pasoja. Në këto kushte për shtetasin rekomandohet masa mjekësore ‘mjekim i detyruar në institucion mjekësor’”*⁷⁸.
212. Nisur nga sa është vlerësuar në aktin shitesë të ekspertimit, prokurori në datën 15.12.2020 ka çmuar se ka qenë i domosdoshëm ndryshimi i masës së sigurimit “arrest me burg”, pasi kjo masë siguri nuk i përgjigjet rrethanave të çështjes, pasi shtetasi vuan nga një sëmundje mendore, për të cilën duhet të kurohet sistematikisht dhe në kushte spitalore sepse prezanton risk të lartë për sjellje të paparashikueshme dhe me pasoja, duke kërkuar në gjykatë në datën 15.12.2020 zëvendësimin e masës “arrest me burg” me masën e sigurimit “shtrim i përkohshëm në spitalin psikiatrik, Qendra Spitalore e Burgjeve, Spitali i Burgut Tiranë”, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. ***⁷⁸, datë 18.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit dhe duke urdhëruar edhe transferimin e shtetasit E. B. në Institucionin Mjekësor pranë Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, Z., Krujë.
213. Në datën 24.12.2020 prokurori ka depozituar në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit dhe caktimin e masës mjekësore “mjekim i detyruar në institucion mjekësor”, duke argumentuar se bazuar në nenin 17.1 të Kodit Penal është parashikuar se: *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuro-psikike që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe, për pasojë, nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe të kuptojë se kryen një veprë penale”*. Gjykata, pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorit, me vendimin nr. ***⁷⁸, datë 1.3.2021, ka vendosur “Pranimin e kërkesave të prokurorit, caktimin e masës mjekësore ndaj personit nën hetim ‘mjekim i detyruar në një institucion mjekësor’, të parashikuar nga neni 46 i Kodit Penal” dhe “Pushimin e çështjes penale nr. ***⁷⁸, datë 21.9.2020, ndaj personit nën

⁷⁷Aktekspertimi nga ekspertët mjeko-ligjorë A. K. dhe I. A.

⁷⁸Sipas vendimit nr. ***⁷⁸, datë 1.3.2021, të gjykatës, të dhënë nga gjyqtari P. S., gjendja e fakti të sa më sipër është provuar nga deklaratimet e shtetasve S. B. etj., të datës 20.9.2020, të cilët kanë deklaruar se janë dakord me prokurorin për sa i përket kërkesës për pushim të veprës penale dhe se nuk janë dakord për sa i përket masës së shtrimit në institucion psikiatrik, duke kërkuar mjekim ambulator, si dhe kryerjen e një aktit tjetër të ekspertimit ku mjekët të përcaktojnë se cila është diagnoza konkrete. Kërkojmë nga IML të caktohet një ekspert i cili të përcaktojë mjekimin e tij.

hetim për veprat penale etj...”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 3.4.2021, pasi nuk është ankimuar nga palët sipas shënimit⁷⁹.

214. Në vijim, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2021, iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila vuri në dispozicion praktikën e plotë dhe materialet përkatëse të lirimit të shtetasit, nga ku ka rezultuar se pas hedhjes së shortit për shpërndarjen e çështjeve penale, me anë të procesverbalit të datës 27.4.2021, kjo çështje i ka kaluar prokurorit D. T. Në datën 5.5.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, bazuar në kërkesën e shtetasit E. B., ka vendosur caktimin si ekspertë në kryerjen e aktekspertimit për ekzaminimin e gjendjes shëndetësore ekspertë pranë IML-së Tiranë dhe me vendimin e datës 26.7.2021, Gjykata Rrethit Gjyqësor Fier, ka vlerësuar kërkesat dhe ka zëvendësuar masën mjekësore “mjekim i detyruar në institucion mjekësor” me masën “mjekim i detyruar ambulator” në kujdesin e babait të tij, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 31.8.2021.
215. Nga sa më lart përshkruar, Komisioni konstaton se nuk ka qenë subjekti i rivlerësimit i cili ka kërkuar zëvendësimin e masës mjekësore nga mjekim i detyruar në mjekim të detyruar ambulator nën kujdesin e të afërmit. Nga sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se deri në datën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë i ngarkuar për kryerjen e veprimeve hetimore, për këtë çështje nuk janë konstatuar mangësi profesionale që lidhen me veprimet procedurale të ndërmarra prej tij, megjithatë i ka kërkuar shpjegime lidhur me sa është përshkruar më sipër.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

216. Lidhur me këtë fakt të njohur publikisht, subjekti ka shpjeguar se: *“Vlerësoj se kam ushtruar për çështjen në fjalë drejt ndjekjen penale, duke cilësuar drejt në përputhje me ligjin material veprat penale në ngarkim të shtetasit E. B. (M.), të parashikuara nga nenet 278/1, 236/2 dhe 230-a të Kodit Penal. Pasi është regjistruar procedimi penal, atij i është caktuar masa e sigurimit personal ‘arrest në burg’, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Në vijimësi të hetimeve është vendosur kryerja e ekspertimit psikiatrik për shkak të problemeve mendore që kishte shfaqur dy vitet e fundit. Prej ekspertëve psikiatër është konkluduar se shtetasi kishte probleme të shëndetit mendor dhe ishte i papërgjegjshëm para ligjit për veprat penale të kryera, papërgjegjshmëri e cila e përjashtonte shtetasin nga përgjegjësia penale dhe dënimi njëkohësisht. Për shkak të kësaj papërgjegjshmërie dhe rrezikut që paraqiste shtetasi menjëherë dhe pa vonesë ju është kërkuar ekspertëve përcaktimi i mënyrës së mjekimit të tij, të cilët konkluduan se duhej të mjekohej në mënyrë të detyruar në një institucion mjekësor, për shkak të shkallës së riskut që ai paraqiste.*
217. *Për shkak të problemeve të shëndetit mendor prej prokurorit ju kërkua në fazën e hetimeve paraprake gjykatës ndryshimi i masës së sigurimit nga ajo e arrestit në burg në masën mjekësore shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik, jo vetëm si një detyrim ligjor i parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, neni 239 i këtij Kodi, por, edhe sipas vendimit nr. ***, datë 19.12.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dërguar nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2018, ku rekomandohej se për të gjithë personat me probleme të shëndetit mendor duhej të shtroheshin në spitale dhe/apo institucione mjekësore. Pasi shtetasit E. B. i është caktuar masa e sigurimit shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i është kërkuar gjykatës pushimi i procedimit penal ndaj tij për shkak të papërgjegjshmërisë, e cila e përjashtonte nga përgjegjësia penale dhe dënimi dhe njëkohësisht i është kërkuar caktimi i*

⁷⁹Me urdhrin nr. ***, datë 21.4.2021, është kryer ekzekutimi i i vendimit nr. ***, datë 1.3.2021, për shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik (IEVP –Z. Krujë) nga prokurori D. T.

masës mjekësore shtrim i detyruar në një institucion mjekësor, kërkesë e cila u pranua dhe u vendos nga gjykata. Pasi vendimi ka marrë formë të prerë, prej shtetasit E. B. i përfaqësuar nga mbrojtësi i tij K. C., ju kërkua gjykatës ndryshimi i masës mjekësore nga ajo e mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor në atë të mjekimit ambulator. Për shkak se çështja objekt gjykimi ishte kërkesë që shqyrtohej në fazën e ekzekutimit, në këtë fazë gjykimi, prokuroria është përfaqësuar nga prokurori D. T.”.

Vlerësimi i trupit gjykues

218. Trupi gjykues, nisur nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, i vlerëson ato bindëse, për sa kohë provohet se deri në datën kur subjekti ka kryer veprimet hetimore për këtë çështje nuk janë konstatuar mangësi profesionale që lidhen me veprimet procedurale të ndërmarra prej tij, çmon se edhe në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij.
219. **Denoncimi online në portalin:** <https://360grade.al/235723/humben-femijen-5-vite-me-pare-gjykata-vendos-rihapjen-e-ceshtjes-per-te-miturin/>
220. Nga shqyrtimi i fashikujve që i përkasin kallëzimit penal të ngritur nga babai i viktimës L. B. për subjektin e rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyre”, si dhe kallëzimit penal nr.*** për veprën penale “kanosje e gjyqtarit”, të trajtuara në rubrikën “Të dhëna arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime” ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 1.7.2012, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, në ngarkim të drejtuesit të automjetit për të cilin ishte vendosur masa e sigurimit “arrest me burg”. Subjekti i rivlerësimit, ngarkuar për hetimin e kësaj çështjeje, në datën 1.7.2012 ka marrë vendimin për kryerjen e aktekspertimit auto - teknik nga ku kishte rezultuar se *nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i automjetit*. Pas vënies në dispozicion të aktekspertimit për të cilin është njohur në datën 2.7.2012, në seancën gjyqësore të datës 3.7.2012 subjekti ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier heqjen dorë nga kërkesa për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 3.7.2012, ka vendosur “Pranimin e ligjshëm të kërkesës për arrestimin në flagrancë dhe mospranimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit ‘arrest me burg’ ndaj drejtuesit të automjetit, për shkak të heqjes dorë nga pala kërkuese”.
221. Nisur nga fakti se në aktekspertim nuk ishin trajtuar mënyrat dhe rregullat që duhet të zbatonte drejtuesi i automjetit, prokurori kërkoi një tjetër aktekspertim auto - teknik nga Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Fier, e cila, me aktin e datës 20.7.2012, vlerësoi se *nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i automjetit*, po ashtu u procedua edhe me një grup tjetër ekspertësh, të cilët me aktekspertimin auto-teknik të datës 21.9.2012 vlerësuan se nuk kishte shkelje të rregullave të qarkullimit të cilët, gjithashtu, hartuan skicën fotografike dhe arsyetuan se *drejtuesi i automjetit nuk mund ta shmangte aksidentin*. Referuar aktekspertimeve në datën 25.9.2012, ndër të tjera, prokurori ka arsyetuar se mungesa e lidhjes shkakësore e përjashton nga përgjegjësia drejtuesin e automjetit, pasi fakti nuk plotësonte elementet e figurës penale, duke marrë vendimin për “Pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2012”, nga ku ka rezultuar se i është njoftuar vendimi i datës 25.9.2012, për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2012 edhe palëve të interesuara J.M.⁸⁰ dhe L. B.⁸¹.

⁸⁰Njoftuar me shkresën nr. ***, datë 5.10.2012, vendimi i pushimit të datës 25.9.2012, për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2012.

222. Pasi prindërit e fëmijës janë njohur me vendimin dhe duke mos qenë dakord kanë depozituar ankim në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë⁸² me vendimin e datës 27.7.2016, ka vendosur “Shfuqizimin e vendimit të datës 25.9.2012, për pushimin e çështjes penale nr. ***”, e cila në pjesën e shqyrtimit të bazueshmërisë së ankimit ka vlerësuar se: “Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. *** është marrë në kushtet kur nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore të domosdoshme për të sqaruar dinamikën e plotë të ngjarjes, pasi:

a) Në fazën e hetimeve paraprake të procedimit penal, prokurori dhe policia gjyqësore kanë për detyrë të kryejnë të gjitha veprimet e domosdoshme për të sqaruar dinamikën e plotë të ngjarjes.

b) Ky detyrim nga ana e organit procedues në hetimet paraprake nuk rezulton të jetë përmbushur plotësisht.

c) Në vendimin e pushimit të këtij procedimi dhe duke konsideruar kategorike përfundimet e aktit të ekspertimit auto teknik, prokurori ka arritur në përfundimin se nuk ekziston fakti penal që lidhet me veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, ndërkohë që një sërë elementesh që nuk janë trajtuar gjatë hetimeve paraprake apo analizuar në aktet e ekspertimit auto-teknik dhe vendimin e pushimit, e vënë seriozisht në dyshim një përfundim të tillë.

d) Kështu, në procesverbalin e këqyrjes së vendim të ngjarjes dhe skicën e saj, nuk përcaktohet saktësisht vendndodhja e fëmijës 2-vjeçar, viktimës V. B.

dh) Në aktet e ekspertimit auto-teknik konstatohen kontradikta në shpjegimin e dinamikës dhe kinematikës së aksidentit rrugor, si dhe të trajektoreve e pjesëmarrësve në këtë aksident deri në pozicionin përfundimtar.

e) Nuk është sqaruar pika e goditjes midis automjetit dhe fëmijës 2-vjeçar shtetasit V. B.

ë) Nuk është sqaruar përshquarja reciproke e tyre në raport me kushtet e ambientit ku ka ndodhur aksidenti rrugor.

f) Në përcaktimin e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor, duke mos u sqaruar elementët teknik kryesor, ai i dëmtimeve të viktimës, janë arritur konkluzione të paplota.

g) Nuk është përlllogaritur nëse aksidenti rrugor mund të shmangej.

h) Kryerja e një akti ekspertimi auto-teknik me grup ekspertësh, por edhe veprime të tjera hetimore që mund të diktojë ecuria e hetimeve paraprake, nuk mund të paragjykojnë zgjidhjen përfundimtare të këtij procedimi, por ato do të lejojnë prokurorin të mbërrijë në përfundime më të bazuara, si për sa i përket faktit penal, ashtu edhe të përgjegjësive penale të mundshme”.

Pas njohjes me vendimin e shfuqizimit të Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, në datën 3.11.2016 subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga ekspertët t’iu jepet përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

a) Cila është sjellja e drejtuesit të mjetit me targë *** , në raport me rregullat e qarkullimit rrugor; cila është vendndodhja e viktimës, fëmijës V. B.?

b) Cila është përshquarja reciproke në raport me kushtet e ambientit ku ka ndodhur aksidenti?

c) A mund të shmangej aksidenti nga ana e drejtuesit të automjetit?

d) A konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i mjetit furgon dhe, nëse po, cilat rregulla janë shkelur?

⁸¹Njoftuar me shkresën nr. ***, datë 25.9.2012, të shtetasit L. B., për pushimin çështjes penale nr. *** të vitit 2012. Gjithashtu ka rezultuar se janë njoftuar palët me shkresën nr. ***, datë 26.1.2017, për pushimin e çështjes penale të sipërcituar.

⁸²Prokuroria e Përgjithshme Tiranë ka dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 25.8.2016, vendimin e shfuqizimit të pushimit të procedimit penal.

223. Referuar aktekspertimeve auto-teknike me ekspertë të tjerë, të cilët dhanë qëndrime të ndryshme, subjekti i rivlerësimit në datën 12.1.2017⁸³ vendosi përsëri “Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2012”. Nga dokumentacioni i disponuar nuk rezulton që të jetë ankimuar vendimi i pushimit të procedimit penal nga prindërit e fëmijës. Më tej kanë qenë prindërit e viktimës të cilët kanë vijuar me ankesat, si dhe me letra e kërcënime në drejtim të subjektit të rivlerësimit, nga ku për shtetasin L. B. është regjistruar edhe kallëzimi penal “kanosje e gjyqtarit”, për të cilin është deklaruar edhe fajtor sipas vendimit nr. ***, datë 29.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar shpjegime bindëse subjektit, pasi vendimi për pushimin e procedimit penal nr. *** ka qenë i pabazuar dhe jo në përputhje me faktet – sikurse është konsideruar e vlerësuar edhe nga Prokuroria e Përgjithshme në vendimin e shfuqizimit pushimit të procedimit penal nr.***.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

224. Në lidhje me këtë çështje, subjekti ka sqaruar se ka ushtruar me përpikëri maksimale funksionin e prokurorit në procedimin penal nr. *** të vitit 2012 në lidhje me aksidentin e datës 19.6.2012, ku në fshatin K. të Fierit, si pasojë e aksidentit me automjet, humbi jetën më pas në spital fëmija V. B. Oficeri i policisë gjyqësore ka vendosur kryerjen e ekspertimit auto-teknik që në momentet e para dhe referuar aktekspertimit auto-teknik datë 1.7.2012 të ekspertit ing. L. H. i Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor Fier është konkluduar se nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i automjetit J. M., por shkak i aksidentit ishin lëvizjet e fëmijës V. B. Bazuar në aktekspertimin auto-teknik, datë 1.7.2012, administruar në datën 2.7.2012, prokurori ka tërhequr në seancë gjyqësore kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se nuk plotësoheshin kriteret ligjore të parashikuara në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, pasi ky dyshim kishte rënë me aktekspertimin auto-teknik.

225. Subjekti ka vijuar më tej shpjegimet e tij: *“Për shkak se në cilësinë e prokurorit nuk bindesha në argumentet e ekspertit për aktekspertimin auto-teknik të datës 1.7.2012, mora përsipër hetimet, duke vendosur kryerjen e një akti të ri ekspertimi me vendimin e datës 16.7.2012, duke caktuar me detyrën e ekspertit z. M. P., ekspert pranë Njësisë Rajonale të Policisë Rrugore Fier. Prej ekspertit M. P. është përpiluar aktekspertimi auto-teknik i datës 20.7.2012, administruar në datën 24.7.2012, ku sipas këtij akti eksperti kishte konkluduar se nuk konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit të automjetit. Përsëri nuk jam bindur përsëri në konkluzionet e ekspertit dhe me vendimin e datës 14.9.2012 kam vendosur përsëri kryerjen e një akti tjetër ekspertimi auto-teknik, por këtë herë me grup ekspertësh, duke caktuar ekspertet ing. A. S. dhe ing. Sh. Xh. Sqaroj se, referuar vendit ku ka ndodhur aksidenti, prej meje prokurorit ju është kërkuar ekspertëve të përcaktohej sjellja e drejtuesit të automjetit në çastin e aksidentit, për faktin se aksidenti kishte ndodhur në rrugë fshati ku automjeti kishte qenë i parkuar dhe nuk ishte përfshirë ende në fluksin e lëvizjes së automjeteve.*

226. *Vlen të përmendet fakti se me procesverbalin e datës 1.9.2012, për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, është pyetur prej oficerit të policisë gjyqësore babai i fëmijës V. B., shtetasi L. B., i cili, në fund të deklarimeve, në këtë procesverbal ka deklaruar se: ‘Në lidhje me këtë aksident dua të deklaroj se nuk dëshiroj që shoferi i furgonit të ndiqet penalisht pasi kemi folur familjarisht për aksident’. Ky deklaram i dhënë përpara oficerit të*

⁸³Me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, hyrë në fuqi më 1.8.2017, ndryshuar neni 24, “Funksionet e prokurorit”.

*policisë gjyqësore nga shtetasi L. B. në lidhje me mosndjekjen penale të shoferit të furgonit, nuk është marrë në konsideratë nga ana ime si prokuror, por kam insistuar në zbardhjen e shkaqeve të aksidentit, duke vendosur kryerjen e një ekspertimi të ri me grup ekspertësh, siç edhe u parashtrua më sipër. Në zbatim të vendimit të prokurorit, prej ekspertëve u përpilua aktekspertimi auto-teknik, sipas të cilit nuk konstatoheshin shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i automjetit, i cili në vlerësimin tim ishte i plotë, pasi trajtonte në mënyrë shkencore rrethanat e aksidentit dhe me vendimin e datës 25.9.2012 u vendos pushimi i çështjes, vendim i cili me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., të datës 5.10.2012, ju komunikuan drejtuesit të automjetit dhe shtetasit L. B., babai i fëmijës, duke i njohur me të drejtën e ankimit.*

227. *Rezulton se në vitin 2015, me kërkesën e datës 24.6.2012, tre vjet pas vendimit të pushimit, shtetasi L. B. ka kërkuar kopje të akteve të procedimit penal, akte të cilat i janë dhënë këtij shtetasi. Pasi ka marrë aktet e çështjes penale, shtetasi L. B. ka paraqitur ankim në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë dhe me vendimin e datës 27.7.2016, prokurori pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me tagrin e prokurorit me të lartë, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 25.9.2012, për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2012, duke urdhëruar kryerjen e një akti të ri ekspertimi me grup ekspertësh të cilët t'u përgjigjeshin pyetjeve të caktuara në këtë vendim shfuqizimi. Pasi është shfuqizuar vendimi i pushimi, është kryer një akt i ri ekspertimi me grup ekspertësh. Pas kryerjes së aktit të ri të ekspertimit, ekspertët konkluduan përsëri se nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit të automjetit J. M., por, aksidenti ka ndodhur për shkak të veprimeve të pavullnetshme të fëmijës së mitur.*

228. *Meqenëse, drejtuesi i automjetit përjashtojë përsëri nga përgjegjësia penale, me vendimin e datës 12.1.2017 është vendosur pushimi i çështjes dhe me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 26.1.2017 iu komunikua vendimi i pushimit drejtuesit të automjetit dhe shtetasit L.B., duke i bërë të njohur me të drejtën e tyre të ankimit në gjykatë brenda afatit ligjor. Rezultoi se pas vendimit të pushimit të datës 12.1.2017 shtetasi L. B. nuk iu drejtua gjykatës për ta kundërshtuar vendimin e pushimit apo Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ende nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, por filloi të më kanosë mua prokurorin dhe familjen time, shkak për të cilin jam ndjerë i rrezikuar ku kam bërë kallëzim penal, si dhe kam venë në dijeni Drejtorinë Vendore të Policisë Fier për marrjen e masave për mbrojtjen time fizike dhe të familjes sime, për të cilat kam pasur korrespondencë dhe ia kam bashkëngjitur kallëzimit penal që kam bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë.*

229. *Prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, shtetasi L. B. u dërgua për gjykim për veprën penale 'kanosje e gjyqtarit', të parashikuar nga neni 317 i Kodit Penal dhe në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 29.5.2019, Gjykata e Shkallës së Parë Lushnjë e dënon shtetasin L. B. për veprën penale 'fyerje e gjyqtarit' dhe në bazë të nenit 317 të Kodit Penal e dënon me një muaj burgim, duke urdhëruar pezullimin e dënimit me afat prove prej 2 vjetësh. Kundër këtij vendimi ushtroi ankim prokurori dhe me vendimin nr. ***, datë 4.5.2021, Gjykata e Apelit Vlorë vendosi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 29.5.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, duke e deklaruar fajtor shtetasin Luftar Buzi për veprën penale 'kanosje e gjyqtarit', të parashikuar nga neni 317 i Kodit Penal dhe e dënon me tre muaj burgim, duke urdhëruar pezullimin e dënimit me afat prove prej 6 muaj. Në vlerësimin tim personal, por edhe si prokuror, mendoj se në këtë procedim penal kam bërë maksimumin për sqarimin e plotë të rrethanave të aksidentit për të konkluduar plotësisht nëse kishte përgjegjësi penale drejtuesi i automjetit. Siç rezulton nga dinamika e veprimeve*

hetimore në këtë procedim penal, kam pasur një rol aktiv në kryerjen e riekspertimeve auto-teknike, duke ngarkuar fillimisht ekspert të institucioneve shtetërore për të eliminuar çdolloj paragjykimi për njëanshmëri në kryerjen e veprimeve hetimore sepse eksperti i parë i cili ka kryer aktekspertimin ka qenë eksperti pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe eksperti tjetër i cili ka kryer aktekspertimin auto-teknik ka qenë i Njesisë Rajonale të Policisë Rrugore Fier dhe pas ezaurimit të ekspertëve shtetërorë, kam ngarkuar ekspertët privatë.

230. *Si rrallë herë, në këtë procedim penal janë kryer katër aktekspertime auto-teknike dhe asnjë prej këtyre akteve në asnjë moment nuk e ka gjetur me shkëlje drejtuesin e automjetit, pra, prej prokurorit janë bërë përpjekjet maksimale për të përcaktuar nëse drejtuesi i automjetit kishte shkëlje dhe përgjegjësi penale njëkohësisht. Në të gjitha rastet vendimi i pushimit ka qenë i mbështetur në ligj dhe në prova, pasi është mbështetur në prova shkencore si aktekspertimet auto-teknike, të cilat në rastet e aksidenteve rrugore kanë një rëndësi të veçantë për sa i përket fuqisë provuese të tyre si provë, duke prevaluar mbi provat e tjera. Në lidhje me vendimin e shfuqizimit të prokurorit me të lartë në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, mendoj se referuar ligjit të kohës kur është marrë ky vendim ka qenë tagri i tij procedural për të shfuqizuar një akt të një prokurori më të ulët të parashikuar në nenin 24.5 të Kodit të Procedurës Penale para ndryshime ligjore me nr. 35/2017, përfshirë faktin se prokuroria në atë kohë ka qenë e centralizuar dhe ashtu e ka menduar në vlerësimin e tij individual”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

231. Nga sa më lart, Komisioni vlerëson se lidhur me numrin e ekspertizave në funksion të zgjidhjes së çështjes, shpjegimet e subjektit janë bindëse, ndërsa lidhur me mangësitë e konstatuara në procedimin penal, ashtu sikurse është konfirmuar edhe nga vendimi datë 27.6.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm, vlerëson se nga ana e tij veprimet hetimore nuk janë kryer të plota. Për rrjedhojë, Komisioni vëren se mosveprimet hetimore të lartpërmendura përbëjnë mangësi profesionale të subjektit, sikurse janë specifikuar edhe nga vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka miratuar shfuqizimin e vendimit të pushimit *de quo*.
232. Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson se, ndonëse janë konstatuar disa mangësi të subjektit lidhur me moskryerjen në kohë të disa veprimeve hetimore, këto mangësi çmohen të pamjaftueshme për të konkluduar në papërshtatshmëri profesionale të subjektit, duke mos qenë ky rasti për aplikimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino:

- a. Në lidhje me kriterin e pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- b. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së

dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Gjithashtu, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

- c. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, ndonëse kanë rezultuar disa hetime të paplota e të pakryera nga subjekti i rivlerësimit Çlirim Sino, vlerëson se ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Çlirim Sino, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 6.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli